

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHITJE TË SHQIPES STANDARDE
RRETH DISA TERMAVE NGA FUSHA
E EKONOMISË DHE E TEKNIKËS
(V)**

Recensues

Prof. Dr. Abdullah Zymberi

Prof. Dr. Begzad Baliu

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHITJE TË SHQIPES STANDARDE
RRETH DISA TERMAVE NGA FUSHA
E EKONOMISË DHE E TEKNIKËS
(V)**

Prishtinë, 2016

Përmbajtja

P a r a t h ë n i e	7
1. Persiatje rreth përkthimit, përkatësisht zbatimit të dygjuhësisë në ndërmarrjet tona industriale	9
2. Çështje të terminologjisë në ndërmarrje industriale metalpërpunuese	16
3.Kuptimi leksikor i disa termave të njëjësive të organizimit të punës në ndërmarrje në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhës serbokroate	22
4. Rreth kristalizimit të kuptimit të fjalës.....	29
pajisje si term teknik.....	29
Pasqyra e barasvlerësve terminologjikë	31
Përfundim	41
Shkurtesat e burimeve mbështetës të konsultuara:	43
5. Fjala fillesë si barasvlerës i plotë i fjalës navoj të serbokroatishtes në fushën e terminologjisë teknike (mekanike-teknologjike).....	44
6.Rreth terminologjisë kompjuterike në shqipe.....	46
R e z y m e.....	57
7. Doli me humbje jo punoi me humbje	59
8. Rreth përcaktimit të fushave kuptimore të termave fabrikë dhe uzinë në shqipe	61
9. Për aktivizimin e fjalës veçane / veçania	67
10. Trajta servir si një rast i vetmuar	73
11. Termat punishte dhe kantier në raport me kuptimin leksikor të termave radilište dhe gradilište të gjuhës serbokroate.....	76
12. Autofiçinë apo autoservis?	80
14.Rreth termit kamionetë	85
15. Rreth shumëkuptimësisë së antonimeve kyçje /shkyçje në raport me barasvlerësit e gjuhës serbokroate	89
16. Edhe një herë rreth përdorimit të fjalës <i>kyç kyçje</i> te ne	96
17. Rreth specifikës së barasvlerësisë së termave stabiliment / postrojenje	99
18. Përhollesi rreth përdorimit të termit repart në raport me barasvlerësin pogon të serbokroarishtes.....	104
19. Rreth përdorimit të termit ndërresë	111
20. Rrëth aktivizimit të fjalë-termit organikë te ne	114
21. Rreth shprehjes "për kokë banori"	117

22. Ndërkombëtarja "Dyqan" Si term-koncept i zëvendësueshëm në shqipe.....	120
23. Për aktivizimin e fjalës herë/hera në vend të fjalës së huaj turë/tura	122
24. Rreth barasvlerësit sklop (podsklop) të serbokroatishës në shqipe.....	125
25. Rreth specifikës së përdorimit të termit <i>afarizëm</i> te ne	128
P ë r f u n d i m	136
Literatura e konsultuar (shkurtime dhe titujt e plotë):.....	137
26. "Përkthimi i automjetit", sizhargon i paqëndrueshëm terminologjik	139
27. Fjalorat e hajrullah goranit - kontribut madhor për terminologjinë ekonomike	142
28. Rreth pranisë së emërtimeve të huazuara të mjeteve teknike në burimet e shqipes letrare.....	149
Të dhëna bio-bibliografike për autorin.....	Error! Bookmark not defined.

Parathënie

Në këtë përmbledhje janë përfshirë 28 punime (artikuj dhe trajtesa) që kanë përmbajtje nga fusha e terminologjisë ekonomike dhe të asaj teknike.

Një pjesë e tyre më parë është botuar në mjetet e caktuara informative, atëherë edhe kur ishte aktuale njohja me probleme të tilla, por megjithatë ruajnë aktualitetin edhe sot e kësaj dite, pasi që nevoja, qoftë për njohjen e problemeve të tilla, qoftë lidhur me zgjidhjen e tyre, nuk ka pushuar gjithandej e gjithkëndej.

Gjithsesi mendoj se qëndrimet, gjykimet dhe propozimet rreth zgjidhjeve të caktuara të shprehura në këta artikuj e trajtesa kanë mbetur me interes edhe sot e kësaj dite, sidomos kur është fjala te harmonizimi i termave të caktuar, qoftë brenda ndërmarrjeve të caktuara te ne, qoftë në mbarë truallin shqipfolës e më gjerë, prandaj shkrimet e kësaj përmbledhjeje le të shërbejnë si nxitje për një ndërmarrje të tillë përcaktimi e harmonizimi, duke filluar nga qelizat më të vogla nga fusha ekonomike, ateljet, dyqanet, marketet a punëtoritë përkatëse, për të vazhduar me supermarketet e e ndërmarrjet përkatëse deri tek organizmat më të lartë shtetërorë e ndërkombëtarë, të ciklat gjithsesi edhe në kohën ton ë duhet të shënohen parësorisht shqip.

Sigurisht do të isha i lumtur nëse çështjet e trajtuara në këto punime do të rishqyrtoheshin e do të zgjidheshin si duhet duke mos mbetur pa u vërejtur edhe kontributi im, së paku si nismëtar, edhe në qoftë i shprehur në periudhën e caktuar si dëshirë.

Në të vërtetë, sot gjuha shqipe, te ne, edhe pse nuk ballafaqohet më me ndikimin e gjuhës serbishte, sa me ndikimin e gjuhëve të tjera, prania e asaj gjuhe dhe ngjashmëria e problemeve të trajtruara në këtë vepër nuk mund të mohohet.

Porosi e këtyre punimeve del objektivi që çdo emërtim shqip, qoftë i formëzuara, i krijuar ose i huazuar duhet të krahasohet jo vetëm me një barasvlerës të ndomnjë gjuhe ndikuese, siç ishte serbishtja te ne, por me më

shumë gjuhë, siç u përpoqëm ta bëjmë ne jo, në pak punime. Mbase është mirë që disa terma teknikë të huazuar fillimisht në Shqipëri nga italishtja, greqishtja apo frëngjishtja të rishikohen, ashtu si dhe huazimet e pak mëvonshëm nga ruseshtja, gjermanishtja, po edhe nga anglishtja.

Fundi i fundit këto punime nëse, sipas bindjes së dikujt, aktualisht nuk paraqesin aq interes, këto së pakupërveç se ruajnë vlerë dokumentuese, mund të shërbejnë si mënyrë-metodë pune dhe njëherazi shtzojnë kërkesën për zgjidhjen e çështjeve të hapura në mbarë trojet shqipfolëse, apo jo?

1. PERSIATJE RRETH PËRKTHIMIT, PËRKATËSISHT ZBATIMIT TË DYGJUHËSISË NË NDËRMARRJET TONA INDUSTRIALE

Në bazë të Kushtetutës së KSAK-ut (1974) dhe të Ligjit mbi realizimin e barazisë së gjuhëve dhe të shkrimeve në KSAK (1977) ashtu si në të gjitha sferat e jetës dhe të punës edhe në ndërmarrjet tona industriale u ndërmorën masa në të mirë të zbatimit dhe të përdorimit të dygjuhësisë, përkatësisht implementimit edhe të gjuhës shqipe. Për këtë qëllim krahas masave të tjera u angazhuan edhe faktorët kompetentë në ndërmarrje për të siguruar kuadro të nevojshëm për këtë punë. Si rrjedhojë edhe u punësuan edhe përkthyes, kështu që sot pothuajse çdo ndërmarrje ka përkthyesin a përkthyesit e vet. Gjithashtu, përveç vendit të punës së kuadrit përkthyes, me aktet normative, përkatësisht organizmat (sistematizimin e punëve dhe të detyrave) janë paraparë edhe vendet e punës, në të cilat sipas nevojës parashihet edhe njohja e domosdoshme e dygjuhësisë, përkatësisht zbatimi i saj, por gjithsesi përkthyesi ndihmon zbatimin e dygjuhësisë, por kuptohet që kurrsesi tërë pesha lidhur me këtë nuk duhet të bjerë në përkthimin e materialit, sepse "përkthimi nuk është alternativë për barazinë e plotë të gjuhëve". (Rilindja, më 19. V. 1982). Secili hartues materialin duhet ta përgatisë në gjuhën e vet, të cilën e njih më mirë. Me një fjalë, materiali duhet të hartohet edhe në gjuhën shqipe, përkatësisht në gjuhën e kombit a të kombësisë përkatëse, çka nuk praktikohet më parë.

Në këtë drejtim, varësisht nga mjedisi shoqëror dhe aftësia e kudrove, janë arritur rezultate të konsiderueshme edhe në zbatimin e gjuhës shqipe, por ka raste që të arriturat e tilla nuk janë nën nivelin e kërkuar, sidomos sa i përket cilësisë së gjuhës së teksteve. Bashkëpunimi ndërmjet kuadrove është i domosdoshëm për ngritjen e kësaj cilësie dhe në këtë fushë ndihmesa e lektor-përkthyesit nuk duhet të mungojë dhe as të mohohet.

Këtu nuk e kam ndërmend të ndalem në shqyrtimin e shkaqeve subjektive dhe objektive lidhur me këtë çështje, madje as të cek kush e cili

duhet të kryejë më me përkushtim punën e vet, apo për faktin se si e sa po shfrytëzohet, respektohet apo edhe nënvlerësohet puna e përkthyesit dhe e kuadrove të tjerë të ngarkuar në zbatimin e dygjuhësisë, në krahasim me punët e detyrat e tjera, por kam për qëllim të paraqes natyrën e punës së përkthimit, problemet dhe çështjet e kësaj natyre, në mënyrë që të kuptohet drejt kjo problematikë dhe të bëhet mobilizimi i të gjithë kuadrove dhe i faktorëve të tjerë për zbatimin sa më me kusekuencë të dygjuhësisë te ne. Pra kam për synim të vë në pah çështjen e terminologjisë tekniko-shkencore profesionale në gjuhën shqipe si dhe të persias për rrugën më të sukseshme që duhet ndjekur për të arritur në zgjidhjen e problemeve të tilla jo të lehta.

Duke u bazuar në përvojën personale, lëndën për përkthim që oftohet në një ndërmarrjeje industriale, sipas aspektit dhe natyrës që paraqitet mund ta merendojmë në këto tri grupe:

- së pari, materiale të natyrës aktuale administrativo politike;
- së dyti, materiale të natyrës juridiko-ekonomike-informative dhe
- së treti, materiale të natyrës shkencore, teknike - profesionale.

Në grupin e parë përfshihen: procesverbalet e organeve qeverisëse, përkatësisht të organeve dhe të organizatave vetëqeverisëse shoqërore-politike të ndërmarrjes, të tubimit të punonjësve, të komisioneve të ndryshme etj. Këtu do të radhitej edhe përkthimi simultant në mbledhje, vetëm për hir të aktualitetit apo të shpejtësisë së kryejes së punës a të mesazhit përkatës që shpreh në momentin e caktuar. Materiali i këtij grupi karakterizohet përgjithësisht nga stili jo aq i diferencuar zyrtar, po kjo në të shumtën e rasteve varet nga natyra e lëndës dhe ngritja profesionale e arsimore e subjektit referues. Ka raste kur hartuesi a referuesi mendon serbisht e flet shqip dhe anasjelltas, prandaj në situata të tilla përkthyesi gjithsesi duhet të intervenojë në të mirë të qartësisë së mesazhit.

Në grupin e dytë përfshihen: aktet e përgjithshme nënligjore (vetëqeverisëse), marrëveshjet, rregulloret, pastaj vendimet, aktvendimet, konkluzionet, raportet e rëndomta, raportet afariste (të veprimësisë), kontratat e dokumentet e tjera me karakter afatgjatë si dhe materiali për mjetet e informimit (zëdhënies) - artikujt, njoftimet si dhe shkresat e letrat drejtuar organeve shtetërore si dhe atyre shoqërore-politike etj. Materiali i këtij grupi karakterizohet nga stili zyrtar - informativ i diferencuar.

Në grupin e tretë merendiam materialin që cilësohet si dokumentacion teknik profesional, siç është përshkrimi (formulimi) i proceseve teknologjike, vizatimet teknike, elaboratet, punimet kërkimore-shkencore etj. Materiali i tillë karakterizohet nga stili tekniko-shkencor, ku kërkohet precizitet i rreptë shkencor në shprehje e terminologji, ngase kemi të bëjmë me "gjuhën teknike" të një stili të veçantë me shprehje e interpretim të tillë, ku sipas rregullit nuk lejohet as më e vogla dykuptimësi, sepse nga teksti dhe të dhënat në të varet puna praktike me shumë përgjegjësi morale e materiale, përkatësisht sipas vizatimit teknik a dokumentit përkatës bëhet edhe harxhimi e përpunimi i lëndës së parë, së këtejmi varet edhe procesi teknologjik i prodhimit.

Sidoqoftë, materialet që u përfshinë në grupin e parë, sipas rregullit, i përgatisin (edhe i përkthejnë) referentët e kuadrot e caktuar, kurse lektor-përkthyesi vetëm mund të bëjë korrigjimet e nevojshme dhe nuk duhet "të humbasë kohën" për përkthimin e materialeve të tilla të karakterit joafatgjatë.

Lidhur me përkthimin e materialit të grupit të dytë lektor-përkthyesi veç fjalorëve adekuatë duhet të konsultojë kuadrot profesionistë, varësisht nga objekti që trajtohet: juristë, ekonomistë e kuadro të tjerë të profesionit a të profilit përkatës, në mënyrë që tekstet e kësaj natyre të dalin pa gabime dhe kështu të jepet ndihmesë jo e vogël edhe për përhapjen, zbatimin dhe ngulitjen e normës letrare (shqipe) në masë, ndër punonjës e punëtorë nga prodhimi i drejtpërdrejtë.

Ndërsa, për materialin e dy grupeve të para kishim të bënim pakashumë me material të gatuar e të kapshëm dhe deri diku të njohur, në materialin e grupit të tretë kemi të bëjmë me lëndë më pak të njohur, sepse mund të ndodhë b.f. që një proces pune, sipas specifikëd që ka, të kryhet vetën në një ndërmarrje të caktuar dhe askund tjetër, prandaj për përkthimin e lëndës së kësaj natyre lektor-përkthyesi jo vetëm se duhet të konsultojë, por edhe patjetër duhet të bashkëpunojë me kuadro profilesh të caktuara, me ekspertë tekniko-shkencorë e me ekspertë e specialistë të fushave të caktuara tekniko-teknologjike e shkencore, në mënyrë që përkthimi i tekstit profesional të jetë në nivelin e kërkuar. Pikërisht në këtë aspekt ndjehet mungesë e kuadrit të aftë, të përkthyesve të specializuar në gjuhën tonë, por

edhe përgjithësisht edhe të ekspertëve "zot të zanatit" të vet, të cilët duhet ta krahasojnë materrialin edhe me tekstet përkatëse të gjuhëve të huaja të zhvilluara.

Pasi ceka shkurtimisht natyrën e lëndës që paraqitet për përkthim në ndërmarrje industriale metalpërpunuese, më poshtë do të prek edhe çështjen e terminologjisë adekuate tekniko-shkencore që paraqitet në gjuhën tonë si vështirësi dhe që ka lidhje me aplikimin e dygjuhësisë joformale edhe në njësitë më të vogla organizuese të punës, në repartet e nënrepartet e punës prodhuese.

Ç'është e vërteta, në kohën tonë po vërehet mungesa e shumë termave teknikë, por njëherësh hetohet edhe një begatim a "ekspansion" i terminologjisë tekniko-shkencore, qofshin këta si terma të huazuar bashkë me sendet e mjetet apo si koncepte të reja, qofshin si "kalkëzime" të shqipëruara apo edhe farkëtime të rastësishme e krijime të mirëfillta, marrë nga tradita ose të përfutuara mbi bazë të proceseve të punës në mbështetje të ligjshmërisë fjalëformuese të gjuhës sonë. Gjithashtu ndodh që për ndonjë koncept a send të ekzitojë emërtimi përkatës, por pasi që nuk është i njohur nga të tjerë, andaj nga imponimi i rastit, po krijohen emërtime të reja, po për atë koncept apo gjësend, mbase duke u shtuar kështu pa nevojë format e caktuara dysore sinonimike.

Një problematikë e tillë është prezente sidomos në ndërmarrjet tona industriale, prandaj është e natyrshme dhe e arsyeshme që të kërkohet nga shoqëria (organet shoqërore e shtetërore) që me anë të ndonjë institucioni të specializuar të bëjnë me kompetencë përcjelljen e zhvillimit a të ecurive të tillë dhe në këtë vazhdë japin ndihmesën e domosdoshme.

Me sa dimë përpjekje të tillë të organizuar, qoftë edhe sa i përket trajtimit të çështjes në forma të ndryshme si ndonjë këshillim, simpozium, konferencë, konsultim të gjerë ose të specifikuar etj. që veç përcjelljes, konstatimit rreth ecurisë së terminologjisë tekniko-shkencore dhe ndihmës që duhet ofruar mbi këtë bazë, me sa dime, ende nuk ka ndërmarrë ndonjë institucion a organizëm shoqëror shtetëror te ne.. Megjithatë, një përpjekje e tillë ka qenë e pranishme në Fakultetin teknik të Prishtinës, por rezultatet kanë mbetur në kuadër të ndonjë individi apo të ndonjë grupi ekspertësh, nuk dimë që është publikuar gjë dhe si ndihmesë të jetë shpërndarë nergut me qëllim njoftimi e konsultimi ose edhe harmonizimi të terminologjisë

përkatëse, prandaj mund të konstatohet që për këto çështje mungon një paraqitje studimore sistemore e publikuar, pa e mohuar vlerën e ndonjë artikulli të veçantë në ndonjë revistë profesionale, që përkthyesit nuk e kanë lehtë ta shtijnë në dorë e ta konsultojnë.

S'do mend se zhvillimi ynë ekonomiko-shoqëror tashmë shtron detyra të reja edhe në lëmin e terminologjisë tekniko-shkencore e teknologjike, pra edhe për ngritjes e cilësisë së përkthyesve dhe kuadrove të tjerë, sidomos në ndërmarrje industriale. Gjithsesi në mjedise të tilla shtrohet detyrë e ngutshme që së paku të evidentohen të gjitha problemet e caktuara nga kjo fushë si dhe zgjidhjet eventuale të rastësishme, edhe në qofshin improvizime, të cilat imponohen nga kohë-hapësira përkatëse ose që përftohen gjatë procesit të punës dhe kështu nga lënda e grumbulluar në këtë mënyrë së paku për nevoja interne duhet të hartohen fjalorë doracakë të termave dhe të shprehjeve "problemore" dhe të tjera, punë kjo me të cilën duhet njohur e njoftuar opinioni, e në veçanti organet përgjegjëse institucionale të institucioneve shtetërore..

Lidhur me këtë besoj se një punë të tillë tashmë e kanë bërë jo vetëm përkthyesit me përvojë, por edhe shumë kuadro të tjerë si kryepunëtorë, punëdrejtues, inxhinierë, mësues, arsimtarë a profesorë, por mbase për arsye se mungojnë paskushtet dhe mundësitë për publikimin e tyre ato nuk janë të njohura publikisht, prandaj organizimi i një konsulte mbi këtë temë së paku në shkallë kosove e më gjerë është e domosdoshme.

E shoh të arsyeshme dhe të nevojshme të cek një punë a përvojë të filluar mirë dhe të të bërë në uzinën "Amortizatorët" të Prishtinës, ku është lëshuar në diskutim si projekt një **Fjalor pune** (*Poslovni rečnik*), d.m.th. fjalor doracak kryesisht i terminologjisë tekniko - shkencore shqip - serbokroarisht e anasjelltas për nevojat e kësaj uzine" dhe këtë rast janë ftuar të japin ndihmesën e tyre, i gjithë kuadri që mund të premtojë, por edhe punëtorët nga prodhimi i drejtpërdrejtë si dhe punonjës e kuadro të tjerë që të japin vërejtjet dhe kontributin e tyre lidhur me plotësimin e materialit të këtij Fjalorit, sipas këtyre nënfushave semantike:

1. emërtimet (titullimi) e ndërmarrjes, përkatësisht format organizuese nga projekti e realizimi në kuadër të ndërmarrjes;
2. emërtesat (nomenklatura) e profesioneve;

3. termat teknikë:

a) emërtimet e mjeteve të punës, veglave, përdorëseve etj.

b) emërtimet e pjesëve të mjeteve të punës, veglave, të përdorëseve etj.;

4. emërtimet e proceseve teknologjike dhe

5. terma të tjerë me interes.

Gjithsesi kërkohet që termat e shqipes të krahasohen me ekuivalencat përkatëse të gjuhës serbokroate ose dhe anasjelltas apo mundësisht edhe të ndonjë gjuhë tjetër të zhvilluar më me përvojë ekonomo-teknikisht.

Ky konspekt, nëse mund ta quaj kështu, mund të shërbejë si model a skicë orientuese edhe për ndërmarrjet e tjera në mënyrë që të ndihmohet zgjimi i interesit masiv të punonjësve (në radhë të parë i ekspertëve) për ndihmuar zgjidhjen e çështjeve të kësaj natyre, zgjidhje kjo tejet e domosdoshme për praktikën tonë, por edhe për shkencën tonë terminologjike në përgjithësi.

Puna e tillë e inicuar duhet përkrahur dhe nxitur në çdo ndërmarrje e nëse është bërë diçka kësisoji, për çka ne nuk dyshojmë, lypset të bëhet grumbullimi i materialit si dhe të fillohet me harminizimin a gjithsesi edhe për vlerësimin i të "mbërrimeve" të tilla.

Në rrethanat që po kalojmë ka qenë dhe është shumë me vend të përkrahët propozimi për formimin e një organi të posaçëm në kuadër të institucioneve shkencore - hulumtuese apo një siorganizëm aktiv në kuadër të organizatave politiko-shoqërore e shtetërore të Kosovës, në mënyrë që problemet e tilla, siç u tha të regjistrohen, të grumbullohen, të shqyrtohen dhe fundja të vlerësohen me kompetencë dhe kështu të zgjidhen e të sendërtohen çështje jo pak të rëndësishme në kuadër të zbatimit të dygjuhësisë të ne, sepse zgjidhja e tyre del me interes, siç u tha, jo vetëm shkencor, gjuhësor e shoqëror, por edhe me interes politik e kombëtar e ndërkombëtar.

Ekzistimi i një siorganizme a organi të tillë në kuadër të institucioneve të Kosovës që do të kishte degët e veta në komuna e ndërmarrje anembanë vendit (ku do të përfshiheshin edhe përkthyesit e kuadro të tjerë) është një domosdo e jetës dhe e zhvillimit tonë, kur kemi parasysh nevojën për kristalizimin, harmonizimin si dhe në raste jo të rralla edhe farkëtimin e termave të rinj përkatës në fusha të ndryshme të shkencës, të ekonomisë e veçanërisht të degëve të industrisë. Një ndërmarrje e tillë arsyetohet aq më tepër nga vetë fakti, se tash është kohë kur Kosova po përjeton një zhvillim

më të madh se që e kishte më përpara. Kjo rritje shihet në të gjitha fushat e jetës e të punës, sidomos në industri dhe se kjo kohë lypset shfrytëzuar në mënyrë sa më racionale edhe në fushën e stabilizimit edhe të terminologjisë tekniko – shkencore në kuadër të gjuhës letrare zyrtare shqipe.

Çështë e vërteta, duke ndihmuar konsolidimin e terminologjisë, sigurisht, ndihmohet ose bëhet i mundshëm edhe zbatimi i dygjuhësisë në ndërmarrjet tona industriale: në kombinatet, uzinat e fabrikat tona, përkatësisht atje ku derdhet munda e djersa e punëtorit në vendin e punës, fundja ky është edhe një detyrim moral e kushtetutar ndaj klasës sonë punëtoare në rritje, e cila dita ditës po korr suksesese si në prodhimtari ashtu edhe në të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën e çështjes që u trajtua në këtë paraqitje është e nevojshme t'u bëhet thirrje për mobilizim të gjitha forcave intelektuale të shoqërisë sonë si: linguistë, ekonomistë, juristë, inxhinierë e specilistë të të gjitha profileve përkatëse, madje edhe të atyre më të specializuara si dhe dashamirëve të gjuhës e të kulturës si dhe punëtorëve të tjerë që të angazhohen dhe të japin ndihmesën e tyre për zgjidhjen e problemeve të terminologjisë tekniko-shkencore e teknologjike në kolektivat tanë punonjës në të gjitha organizatat e punës së bashkuar e sidomos ne degët e reja të ndërmarrjeve të industrisë metalpërpunuese.

Kjo situatë duhet shfrytëzuar, aq më tepër, pasi që për këtë tashmë janë krijuar parakushtet e domosdoshme, siç është edhe "klima e politike për përdorimin e barabartë e të lirë të gjuhës dhe të shkrimit përkatës në të gjitha lëmënjtë dhe situatat" (Rilindja, më 25. V. 1982), pra edhe në organizatat e punës së bashkuar, në fabrikat, uzinat dhe kombinatet tona, ngase si të vihet puna mbarë njëherë në prodhim ajo mbase mbarë do të shkojë edhe më tutje edhe në sferën gjuhësore në të gjitha fushat e administratës dhe të punës prodhuese e arsimuese.

(Prishtinë, gusht 1982)

2. ÇËSHITJE TË TERMINOLOGJISË NË NDËRMARRJET INDUSTRIALE METALPËRPUNUESE

(me theks në uzinën "Amortizatorët" - Prishtinë)

(kumtesë)

Problematika e terminologjisë në ndërmarrjet tona industriale në përgjithësi dhe në ato metalpërpunuese në veçanti është shumë e gjerë, e shumëllojshme dhe e ndërlikuar. Prandaj unë këtu do të përqipem si në një formë skice të paraqes disa nga çështjet e kësaj natyre që më kanë rënë në sy gjatë punës në Uzinën e Amortizatorëve të Prishtinës, siç janë:

- emërtimet (titullimi) i njësive të organizimit teknik të ndërmarrjes,
- emërtimet e profesioneve, ato të mjeteve a të pjesëve të mjeteve të punës si dhe
- emërtimet e proceseve teknologjike e të tjera me interes,

Dhe të gjitha këto, duke i shqyrtuar në raport me përgjegjësit (ekuivalencat) e tyre të gjuhës serbokroate, sepse ato bashkëtojnë në kolektivat tanë punonjës, madje çështja e përkthimit të tyre është çështje e hapur në përditshmërinë tonë.

Si material kryesor mbështetës për këtë trajtesë më ka shërbyer "*Fjalori doracak i terminologjisë afariste-teknike-teknologjike përpiluar për nevojat e uzinës "Amortizatorët" - Prishtinë.*

1

Që në fillim po cek se për emërtimin e ndërmarrjeve industriale në gjuhën shqipe kemi termat **fabrikë** dhe **uzinë** (serb. fabrika ose tvornica, zavod), ndërsa në të vërtetë në Kosovë asnjë ndërmarrje nuk e kemi zyrtarisht të "pagëzuar" si uzinë. Ma merr mendja, siç e kanë edhe shumë gjuhë të tjera, edhe ne duhet ta aplikojmë diferencimin ekzistues që është i pranishëm në gjuhën tonë, kështu që **uzinë uzina** të emërtohen kryesisht ndërmarrjet metalpërpunuese, ndërsa me emërtimin **fabrikë fabrika** ato të degëve të tjera të industrisë, përkatësisht të ekonomisë (të bujqësisë, të blegtorisë, të veshëmbathjes, të ndërtimtarisë etj.).

Si njësi e organizimit të brendshëm të ndërmarrjes problem paraqet edhe termi **repart**, përkatësisht **pogon** të serbokroatishtes. Kemi të bëjmë me të njëjtin nocion, por rrezja e kuptimit si dhe sferat e përdorimit ndryshojnë. Madje në gjuhën serbokroate del edhe termi "**odeljenje**", pothuajse po me kuptimin e termit **repart**, përkatësisht me kuptim edhe më të ngushtë, ngase *odeljenje* në krahasim me kuptimin e termit **pogon** tregon një njësi organizuese për dy shkallë më të vogël.

Në këtë vazhdë më duket se duhet bërë harmonizimi edhe i termave të tjerë që janë të ngjashëm, si p.sh. punëtori, punishtë, ofiçinë, dyqan, kantier. Për këtë po bëj një krahasim me përgjegjëset në gjuhën serbokroate, me të cilat përkufizimi i kuptimeve është përafërsisht i njëjtë: P.sh.: punëtori - radionica, punishtë (punishte) - radilište(!), ofiçinë - servis (remont) (mehaničarska radnja), dyqan (punëtori private) - duçan (radiona, radnja) dhe kantier (vend-punishte a shesh ndërtimesh) - gradilište.

Çështje të përcaktimit të kuptimeve paraqesin edhe termat vijë dhe linjë (skr. linija). Termi i tillë **vijë**, përkatësisht **linjë** paraqitet në njësitë punonjëse a repartet e montimit e të tjera, ku zakonisht montohen a përpunohen pjesët e ndonjë vegje a aparati, p.sh. *linja a vija e presave, linja a vija e shiritit të montazhit* etj. (skr. *linija presa, linija montazne trake*).

Preferohet që termi **linjë** të përdoret vetëm në fushën teknologjike e në fushat e tjera termi **vijë**, si vija ajrore etj.

Për termin **smena** të gjuhës serbokroate në gjuhën shqipe dalin katër trajta: *turn, ndërrojë, ndërrim* dhe *ndërresë*. Si duket trajta **ndërresë** duhet të dalë më e parapëlqyeshme.

Gjithashtu emërtimet që tregojnë një vend-punishtë a lokal pune, të vogël a të madhe, të formuara me prapashtesën -TORE, tërheqin vëmendjen, p.sh.: vetëm në një ndërmarrje ndeshëm këto emërtime:

vegëltore (alatnica), ngjyrëtove (farbara), ngrohtore (kotlana), derdhëtove (livnica), kalitore (kalionica), farkëtove (kovačnica, shiritore (trakara), tertore (sušara), vrojtore a "vend-roje" (osmatračnica), lajtore (perionica).

Krijimet e tilla si terma praktikë gjuhësorë e tekniko-ekonomik nuk janë pa interes, por duhet konstatuar dhe kërkuar përligjësinë e gjedhes së tillë në mbarë shqipen.

Dihet se emërtimet e reja të profesioneve të shumtën sot po lindin e krijohen së bashku me proceset e punës që po i kryejnë personat e caktuar dhese emërtimet e tilla po përvetësohen fare lehtë, ngase edhe për kah kuptimi po përputhen me përgjegjëset e tyre në gjuhën serbokroate, por sa janë të qëlluara krijimet e tilla duhet të vlerësohen.

Në të vërtetë, shumë farkëtime të tilla si më të kapshme po ua zënë vendin emërtimeve ekzistuese nga gjuhët e huaja, p. sh.:

lyrës (lubrifikues),- mazač; (zjarr)ndezës (fokist) - žarilac, ložaç; zhbirues (perforator) - bushač; metalgrirës a zdrugues (rendist a pjalist) - rendisač; mekanik-bravëpunues (mekanik axhustator) - mašinbavar; drynar (bravar, axhustator) - bravar; metalgdhendës (tajar, tornitor) - metalostrugar (tokar); qostërues a grihës (retifikator) - brusač (metalobrusač); pikës (saldues, saldator) - varioc, zavarivač; derdhës (fondator)- livac; shkrirës (gizëtar), topioničar; metalgërryes e metalbrejtës (frezator) - glodač, metaloglodač; petëzues (laminator) - valjač etj.

Një prirje e tillë është e qëlluar, por zgjidhja për ndonjërin emërtim mund të jetë e diskutueshme. Për që kemi shumë emërtesa të tilla të pakristalizuara mjafton të përmend vetëm termin **domar** të serbokroatishtes që në shqipe po përkthehet: *domar, shtëpijak, shpianik, kujdestar, ekonom(at), nikoqir* e ndryshe, që, për mendimin tim, asnjëri nuk është i qëlluar. Më së miri një koncepti të tillë i përgjigjet emërtimi **mirëmbajtës i objektit** (i ndërtesës, i shkollës etj.) si dhe për emërtimin **putar** (cestar), jo: *rojtës a rojtar rruge, rrugës, rrugtar, rrugor* etj., po më së miri më duket se duhet të jetë emërtimi **mirëmbajtës rruge**, ngase me të vërtetë personat e tillë mirëmbajnë objektin, përkatësisht rrugën.

Shtrohet detyrë e ngutshme që të bëhet harmonizimi i terminologjisë së tillë në shkallë kosove, por edhe në shkallë kombëtare.

3

Nga fusha e terminologjisë së emërtimit të veglave (*aparateve teknike*) do të veçoja me qëllim prirjen që emërtimet e tilla të bëhen me prapashtesën -OR (-ORE), përkatësisht -SOR, p.sh.:

zbulor (detektor), baraspeshor (stabilizator), vizor (lenjir), vargor (lanac), përftor (gjenerator), njuhësor (brojač), pasqyror (reflektor) etj.

Krijimet e tilla janë zhvillim i brendshëm i shqipes, ndonëse përkojnë me shumë terma ndërkombtarë që tashmë në gjuhën tonë merren si pjesë e fjalorit tonë themelor dhe konsiderohen si emra të parrë, si p.sh.: *motor, amortizator, radiator, televizor etj.*

Ja edhe disa shembuj të emërtimeve të veglave ose të pjesëve të aparateve, të cilat kanë zënë e po përdoren. P.sh.:

kufizor (graničnik), ngarkor-shkarkor (utovarač-istovarač), udhëzues e udhëzor (vodjica), degëzor e degëzues (raçva), shpejtues e shpejtor (ubrivač, eskalator), shpues (a shpuese) e shpuesor për trapano (bušilica) etj.

Një prirje e tillë, edhe pse mbi bazë të kalkëzimit, duket pothuajse dukuri fare e natyrshme e shqipes, apo jo?!

4

Vendin kryesor si emërtime të procesve teknologjike e zënë emrat e veprimit, por një përhapje të kufizuar e kanë edhe emërtimet që tregojnë cilësi a veçori, të krijuara me prapashtesën -I, -(Ë)SI, -SHMËRI, si:

dredhëti (vijugavost, krivudavost), grathëti (rapavost), mysëti (ispupčenost), shtangëti (čvrstoća) etj; athtësi (zakiselost), gërmuqësi (savijenost, sagnutost), ashpërsi (hrapavost, neravnost), nxënësi a zënësi (kapacitet, zauzetost), nyjtësi (zglobost); djegshmëri (zagorljivost), lagshmëri (kvašljivost), prodhueshmëri (proizvodnost), përcvjellshmëri (provodljivost) etj.

Ja edhe disa formime me prapashtesën -JE që tregojnë rezultatin e veprimit përkatës:

bluarje (drobljenje, meljenje), llokoçitje (promučkanje), shpërndarje (raspodela), ndarje (podela, izdvajanje), cikosje a pikëlosje (šarenje tačkicama) etj.

Mirëpo si emra veprimi vendin e parë për nga numri e zënë emërtimet që dalin në mbështetje të foljeve më -Oj dhe -Ej, emra këta prejfoljorë që formohen me prapashtesën -IM, p.sh.

afrim materiali (dotur materijala), fajkim a lëmim (poliranje), merendim (slaganje, poredjivanje), xhungim (izbočenje; frenim

(koçenje), qostërim a grihim (brušenje), gërshanim a gërshërim (striganje) etj.

Në mënyrë të veçantë tërheqin vëmendjen emërtimet më produktive si terma tekniko-shkencorë që dalin nga foljet -O- me zgjerim: -TO-, -RO-(-NO-), -LLO- (LO-) e sidomos -SO- dhe -ZO- që marrin prapashtesën më -IM si:

zbardhëllim a zbardhërim (belenje), hangërtim (habanje), hapërim (koraçenje); shtjellësim a filetim (izrada navoja), përvetësim (osvajanje, usvajanje), lyrësim (podmazivanje), çlyrësim (odmaščivanje, prapësim (povlačenje, odstupanje), kalbëzim (truljenje) punësim (upošljavanje mašina), gjilpanëzim, gjipërëzim a injektim (ubrizgavanje), degëzim (raçvanje), avullzim (isparanje, vaporizacija), dhëmbëzim a ingranazhim (ozubljabjavanje), finjëzim (izlučivanje), procedjivanje), gëlqerëzim (kalcifikacija), gojëzim (ožljebljivanje), (për)tokëzim (uzemljenje), kromëzim (kromiranje), shpluhurëzim (odprašivanje), çndryshkëzim (bajcovanje), çhirëzim (odpepeljavanje) etj.

* * *

Shembujt që u dhanë në këtë kumtesë (edhe pse në mënyrë fragmentare) u zgjodhën me qëllim për të vënë në pah edhe termin (përkthimin) adekuat në gjuhën serbokroate, ngase edhe në këtë pikëpamje mund të ketë çështje të diskutueshme, por më e rëndësishmja, që desha ta vë në pah këtu, është të shtruarit e vetë problemit si dhe prirja e formimit të fjalëve të "gjuhës teknike", mbi bazë të brumit të shqipës, pra sipas formimit të brendshëm të saj.

Siç po shihet trajta e mirëfilltë duke marrë prapashtesën gjegjëse merr edhe kuptimin e sforcuar, qoftë si proces teknologjik, qoftë si emërtim profesioni ose si emërtim mjeti a të veglës së punës.

Lidhur me këtë sa për ilustrim po i shënoj nja katër - pesë raste që mund të shërbejnë si model se si duket ecuria e vargut të tillë fjalëformues:

1. dridh (me dridhë) / dridhës / dridhëtoj / dridhëtor / dridhëtim;
2. lyej (me lye) / lyrës / lyrësi / lyrësoj / lyrësor / lyrësim;
3. degëzgj (me degëzue) / degëzues / degëzor / degëzim;

4. zbuloj (me zbulue) / zbulor / zbulues / zbuluesor / zbulim, zbulimsi;
5. zbardh (me zbardhë) / zbardhoj / zbardhim / zbardhues /zbardhor /
- 6) zbardhëlloj (me zbardhëllue) / zbardhëllim / zbardhëtore etj.

Disa nga fjalët e prejardhura që formohen në këtë mënyrë mund të mos jenë të përdorshme në stilin neutral sot, por ka mundësi të përdoren po të paraqitet nevoja më vonë. Një mundësi e tillë potenciale e gjuhës sonë që e jep vet struktura fjalëformuerse duhet ta njihet dhe të shfrytëzohet.

Hulumtimi më i hollësishëm dhe më i thelluar në këtë drejtim do të na shpjerë në "gjuhën teknike" jo me kuptimin abstrakt, por me një kuptimësi të natyrshme, duke pasur parasysh deri edhe stilin e proceseve më të ndërlikuara shkencore e profesionale. Të kujtojmë këtë rast vetëm procesin e krijimit të termit **pyetesor** nga fusha e gjuhësisë si barasvlerës(zëvendësues të termit (fjalë ndërkombëtare) **kuestionar**.

Krahaso:

pyes (me pyetë) / pyetës / pyetësor

(që është vegël (mjet) e pyetësit, ndërsa emërtimi procesit mund të emërtohet: **pyetësim** (që nënkupton trajtën foljore *pyetësoj*, e cila shfaqet normalisht nga modeli i vijëzuar).

Natyrisht për të gjitha pikat që u paraqiten këtu nevojitet punë më e thelluar cilësore, por unë do ta quaja sukses faktin nëse arrij të zgjoj vëmendjen e studiuesve dhe të kuadrove përkatës, qoftë në ndërmarrje prodhimi, qoftë në organizata të tjera dhe sidomos të institucioneve që të bëjnë punë të organizuar për zgjidhjen e këtyre problemeve me interes praktik, shoqëror dhe shkencor e gjuhësor, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

3. KUPTIMI LEKSIKOR I DISA TERMAVE TË NJËSIVE TË ORGANIZIMIT TË PUNËS NË NDËRMARRJE NË RAPORT ME BARASVLERËSIT PËRKATËS TË GJUHËS SERBOKROATE

(kumtesë)

Studimi i kuptimit leksikor të termave (edhe të atyre të organizimit të punës në ndërmarrje prodhimi) paraqitet si një fushë e hapur kërkimore me interes shoqëror e shkencor, sidomos në trevat si jona, ku zbatimi i dygjuhësisë, përkatësisht zotërimi dhe përdorimi i dy gjuhëve në të njëjtën kohë, është nevojë dhe obligim, kur aplikimi i tillë madje "garantohet" dhe "sigurohet" edhe me aktin më të lartë ligjor (Shih: nenin 4 dhe 5 të Kushtetutës së KSAK-ut).

Vlen të theksohet se për shkencën kosovare mbi gjuhën shtrohet detyrë imediate që jo vetëm të përcjellë dhe të zgjidhë çështjet që shtron vetë zhvillimi normal i gjuhës, krahas zhvillimit të shoqërisë, por patjetër duhet të rreket në radhë të parë të bëjë konstatimin e gjendjes ekzistuese të terminologjisë në fusha të caktuara të shkencave ekonomike, shoqërore e teknike, e krijuar kjo, qoftë si rezultat i ndikimit të gjuhës serbokroate, qoftë të ndikimeve të gjuhëve të tjera në situata të caktuara ekonomike e shoqërore dhe njëherazi të bëjë kristalizimin, përkatësisht vlerësimin e gjendjes së tillë dhe njëkohësisht t'i qaset edhe harmonizimit të termave të pranuar në gjuhën letrare që për arsye të ndryshme ende nuk janë përfshirë në burimet e fushave të caktuara shkencore e shoqërore në mbarë truallin e shqipes dhe të ndikojë për vënien në jetë të terminologjisë së tillë.

Pikërisht në kontekst të këtij problemi kompleks, në këtë kumtesë, edhe pse në mënyrë të kufizuar, do të trajtohet kuptimi leksikor i disa termave të njësive të organizimit të punës në ndërmarrjet tona, siç janë termat:

fabrike, uzinë, stabiliment, repart, oficinë, punëtori, punishtë dhe kantier.

1) Termi **fabrikë** si ndërkombëtarizëm pothuajse në të gjitha gjuhët (edhe në shqipe e serbokroatishte) ka kuptimin "*ndërmarrje industriale ku përpunohet lënda e parë me anë makinash*", mirëpo pasi që ndërmarrjet e tilla morën hov zhvillimi duke u ndarë në shumë degë e degëzime të ekonomisë, lindi nevoja edhe për terma të rinj. Kështu ndodhi edhe në gjuhën shqipe, e cila për këtë koncept mori termin **uzinë** nga frëngjishtja usine (yzin).

Çështë e vërteta, secila gjuhë ka bërë diferencime të tilla, sipas mënyrës së vet. P. sh.:

gjerm. Fabrik / Werk(s);
angl. works / factory;
it. fabrico / stabilimento;
rus. fabrika / zavod;
skr. fabrika / zavod(!);
fr. fabrique / usine dhe
shq. fabrikë / uzinë.

Nga kjo pasqyrëz vihet re ngjashmëria në shqip e frëngjisht në njërën anë dhe në serbokroatisht e rusisht, në anën tjetër, mirëpo mbulimi i nocioneve nuk bëhet njësoj në asnjë gjuhë as në këto që i citova, madje ka edhe terma të tjerë, por për të mos vajtur larg po i kthehem kuptimit leksikor të termit **uzinë** në gjuhën shqip.

2) Në të vërtetë, termi **uzinë** në gjuhën tonë ka kuptim më të gjerë se në gjuhën frënge(!). Me këtë term në gjuhën tonë emërtohet "*një ndërmarrje e madhe industriale e mekanizuar ku prodhohen mjete e makineri ose ku përpunohet lënda e parë*". Po të analizohet më hollësisht kuptimi i këtij termi në krahasim me kuptimin leksikor të termit **fabrikë**, si "*ndërmarrje industriale me disa reparte të lidhura ndërmjet tyre, ku përpunohet lënda e parë me anë makinash dhe përgatiten prodhime të gatshme për t'u përdorur ose nxirren prodhime gjysmë të gatshme për t'u përpunuar më tej*" del se me fjalë-termi **uzinë** emërtohen **ndërmarrjet industriale metalpërpunuese**, sidomos ato **që prodhojnë vegla e makineri**, ndërsa me **fabrikë** ato ndërmarrje industriale të degëve të tjera të ekonomisë, si p.sh. *të blegtorisë, të veshëmbathjes, të ushqimit, të ndërtimitarisë* etj.

Në gjuhën serbokroate termi fabrika (kroatisht: tvornica) përgjithësisht përfshin pothuaj kuptimin edhe të termit *fabrikë* dhe atij *uzinë* të gjuhës sonë, siç u cekën më sipër dhe shi për këtë shkak ne në Kosovë nuk i kemi të emërtuar zyrtarisht asnjë ndërmarrje si uzinë, por që të gjitha i kemi të emërtuara si **fabrika**, edhe pse në stilet e ndryshme funksionale fjala **uzinë** përdoret pothuajse normalisht. Është e nevojshme të theksohet se në gjuhën serbokroate për të mbuluar kuptimin e termit *uzinë*, siç u cek në gjuhën shqipe, pos termit *fabrika* dalin edhe terma të tjerë si **zavod**, **industrija**, **mašinogradnja**, **postrojenje** etj., por këtu do të cek vetëm kuptimin e termit **zavod** si p.sh. **Zavodi R R - Nish** (tash EI), **Titovi zavodi Litostroj** - Ljubjana, **Metalni zavod - Skopje** si dhe tash e gjithë ditën **Zavodi Crvena Zastava - Kragujevac** etj. Po shtoj edhe këtë fakt lidhur me këtë se ky term (zavod) gjithnjë e më tepër po kalon në shtresën jo aktive të leksikut, sidomos pas aplikimit të LPB, kur **zavod** (si ent) është konstituar si **SIZ (BVI)** p.sh. **Zavod (tash) SIZ** za zapošljavanje - Enti (tash) **BVI** për punësim etj. Pra termi **zavod** i serbokroatishtes, kur ka të bëjë me emërtimin e ndërmarrjeve metalpërpunuese pa ngurrim duhet të përkthehet në gjuhën shqipe me termin **uzinë** e jo *stabiliment* apo ndryshe.

3) Termi **stabiliment** në gjuhën shqipe ka kuptimin "*një ose disa ndërtesa të pajisura me mjetet e duhura për të punuar a për të prodhuar diçka*". Kristalizimi i përdorimit të kesaj fjalë në gjuhën tonë është i nevojshëm, sidomos te ne në Kosovë, kur vërehet se ky term po përdoret edhe atje ku nuk është i nevojshëm, jashtë domenit kuptimor të huazuar, madje së andejmi pos del edhe i dëmshëm sa i përket qartësisë së paraqitjes së nocionit të caktuar, sepse nuk duhet të përdoret si ekuivalent për termin **zavod** të serbokroatishtes, siç u cek më lartë, madje nuk duhet të përdoret as si barasvlerës për termin **uredjaj**, siç po përdoret në emërtimin e profesioneve në shkolla.

Pra është gabim të përdoret emërtimi: *elektroteknik i TV stabilimenteve*, për **elektrotehničar TV uredjaja**, në vend të barasvlerësit adekuat: **elektroteknik i TV- pajisjeve**. Ç'është e vërteta, termi **stabiliment** mund të përdoret vetëm si barasvlerës i termit **postrojenje** të gjuhës serbokroate në disa raste të caktuara, kur kemi të bëjmë vetëm me **nocion ngrehine**. Kjo duhet të mbahet mend.

4) Termi **repart**, që në gjuhën shqipe hyri nga italishtja *riparto* (ndarje, veçim) me kuptimin "*ndarje në një ndërmarrje ... sipas llojit të*

punës ose të prodhimit" në gjuhën serbokroate ka si barasvlerës termin **pogon** (odeljenje fabrike za pojedine poslove (RSHKJ), pothuajse me të njëjtin kuptim, por është e domosdoshme të ceket pikërisht raporti i ndryshimeve në mes të këtyre dy termave barasvlerës. Ndërsa në gjuhën shqipe termi **repart** ka kuptimin e parë kryesor "**ndarje në një ndërmarrje**" në gjuhën serbokroate kuptimi i parë i fjalës **pogon** është: pajisje, motor apo "*forcë e cila lëviz një gjë*" ose "*burimi i një force a energjie*", madje edhe si term teknik ka kuptimin e vendit të prodhimit të energjisë, përkatësisht kështu quhet makina përkatëse ose vendi ku janë instaluar makinat, ashtu si e ka kuptimin në njëfarë dore edhe reparti.

Në të vërtetë, në gjuhën serbokroate të gjithë motorët quhen **pogonske mašine**, për t'i dalluar nga makinat e tjera që quhen **radne mašine** (*radilice*), kështu që në strukturën polisemike termi *pogon si barasvlerës i termit repart del në shkallën e tretë*. Këtë fakt po e nënvizoj me qëllim sepse duke i pasur përherë në ndërdije këto dy fjalë si barasvlerës është interpretuar gabim (përkthyer keq) termi i profesionit a i veprimtarisë shkollore, më saktë termat: **pogonski tehničar** ose **pogonski elektromehaničar** janë përkthyer gabim: "*teknik reparti(!)* apo *elektromekanik reparti(!)* e që duhet të jetë ndryshe, sepse kuptimi i fjalës *pogon* (*pogonski*) në këto raste nuk ka të bëjë fare me repartin, si "ndarje a pjesë të ndërmarrjes apo si një ndërmarrje e vogël" etj., por ka të bëjë pikërisht me profesionin që punëtori i tillë do ta ushtrojë si **teknik i makinave me ngasje elektrike** apo **elektromekanik i makinave (motorave) me ngasje a me rendtimet elektromotorike** apo **elektronik i motorave të tjerë**, varësisht nga *burimi energjetik*.

Pra një lëshim (gabim) i tillë patjetër duhet korrigjuar te ne.

5) Lidhur me termin **punishte punishtja** (*më drejt punishtë punishta*) na tërheq vëmendjen jo vetëm kuptimi leksikor në gjuhën shqipe "një ndërmarrje e vogël për prodhimin e sendeve për përdorim të gjerë ose një fabrikë e vogël a një repart pune pranë një uzine a kombinati", sepse në Kosovë nuk po përdoret me këtë kuptim, por këtu paraqet pengesë edhe vështirësia e gjetjes së ekuivalentit adekuat në gjuhën serbokroate. Sipas përkufizimit që u dha kemi të bëjmë me një "**pogon**", me kuptim të gjerë apo me një "**mala fabrika**" ose "**malo preduzeqe** za *prozvodnju robe široke potrošnje*" e nuk kemi të bëjmë me një **radilište** e aq më pak me një **gradilište**, siç na rekomandohet sipas fjalorëve përkatës normativë serbokroatisht - shqip e anasjelltas të botuar në Prishtinë, si dhe nga

shkrimet e ndonjë gjuhëtari me emër ose me diplomë, por i pasprovuar në këtë punë, aspak njohës i kësaj çështjeje.

Sipas përkufizimit të dhënë më afër termit **punishtë** i qëndron a mund të qëndrojë termi **radionica** në gjuhën serbokroate. Krahaso: **punishtë metalike - radionica metala** etj. sesa radilište a gradilište, për të cilat në shqipe kemi termin **kantier**, të cilin do ta marrim në shqyrtim pasi të paraqesim kuptimin e termit **oficinë**, përkatësisht **punëtori**.

6) Termi **oficinë** (it. officina) në gjuhën shqipe ka kuptimin leksikor "repart i veçantë në një ndërmarrje a institucion, me pajisjet e nevojshme, ku bëhen punime të ndryshme mekanike" që në gjuhën serbokroate kemi termin adekuat "**mehaničarka radionica**" apo **radionica, radnja**.

7) Dy fjalë edhe rreth konceptit të termit **punëtori** që në serbishte ka barasvlerësin **radionica**. Me termin **radionica** (kroatisht: *delaonica*) sipas RSHKJ kuptohet "*lokali ku punohet a riparohet një send*" (prostoriya gde se nešto izradjuje ili popravlja) që në Kosovë praktikohet, siç u tha termi **punëtori** dhe mund të thuhet, pra, se ky term konsiderohet si barasvlerës i plotë i termit **radionica**.

Kështu termi **punëtori**, si repart pune, është përfshirë edhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) me kuptimin "*repart pune në një ndërmarrje prodhimi*" dhe për këtë koncept referohet sinonimi **punishte**. Në të vërtetë, kur kemi parasysh përdorimin e kësaj fjale në Kosovë si ekuivalent për termat gjegjëse të gjuhëve të huaja si në *Fjalorin rusisht - shqip*, atë anglisht - shqip të Mann-it etj. ky term duhet t'i referohet fjalës **oficinë** dhe fare pjesërisht termit **punishtë**. Po të aplikoheshin disa kushte jashtëgjuhësore ma merr mendja se termi **punëtori** në mbarë shqipen duhet të zgjerohet kuptimin, dhe në mos e zëvendësoftë plotësisht termin **oficinë**, gjithsesi do t'ia ngushtonte sferën e përdorimit. Me një fjalë do të mbetej termi *oficinë* për të emërtuar mbase vetëm punëtoritë e riparim-shërbimeve. Dhe për të pasur një ide më të qartë lidhur me këtë po jap ca shembuj në gjuhë të huaja të nxjerra nga fjalorët përkatës:

- gjerm. Reparaturwerkstatt;
- anl. repair shop;
- fr. atelier de reparations;
- rus. masterskaja (remont);
- skr. radionica za opravku (remontna radionica);

it. officina di riparazioni;
shq. ofiçinë (*punëtori riparim - shërbimi*).

8) U cek më sipër se te ne (në Kosovë), referohet që termi **gradilište** dhe *radilište* të përkthehen në shqipe me termin **punishte**, për çka u shprehën se **është shumë pa vend**, ngase sipas konceptit që mbulon termi **punishtë** nuk del as afër në sinonimi me termin **kantier**. Nëse duhet pëdorur termi **punishte** për ndonjë repart pune *si punëtori*, atëherë, siç u cek paksa më sipër, propozojmë të përdoret jo me –e fundore po me –Ë fundore, **punishtë punishta** (jo *punishte punishtja*) ngase si duket pikërisht kjo fundore që del e ngjashme me fundoret e termave të serbishtes *radilishte gradilishte*, ka ndikuar që disa “*intektualë*” te ne, ta identifikojnë barsvlerësinë e tillë, edhe pse siç u tha assesi nuk përkojnë: punishte me gradilishte.

9) Termi **kantier** me kuptimin “*vend a shesh zakonisht i rrethuar (...) ku punohet për ndërtimin e një (...) objekti*” që përputhet pjesërisht me kuptimin e termit **radilište** të gjuhës serbokroate, sidomos të pjesës “*mesto gde se nešto izradjuje*”(vendi ku diçka punohet) dhe plotësisht me termin **gradilište**, *mesto gde se nešto gradi, podizhe* (vendi ku diçka ndërtohet, ngrihet). Siç po shihet këto nocione (radilishte e gradilishte, assesi nuk mund të zëvendësohen me termin **punishtë**. Për nocionet e tilla në shqipe përdoret termi **kantier** huazuar nga gjuha italiane **cantiere** që në serbokroatishte përkthehet me trajtat **radilište**, fr. **chanier**, kurse **gradilište** në frëngjishte ka si barsvlerës: **chantier de contruction**, rus **strojka**, anglisht **site** (sajt), pra në vend të termit **kantier** shpeshherë dalin togfjalëshat sinonimikë si **shesh-ndërtimi**, **vend ndërtimi** si dhe *vend-punishtë(!)* që në kontekste të caktuara zëvendësojnë pothuaj me sukses konceptin përkatës, por kurrsesi termi **kantier** nuk mund të zëvendësohet me termin *punishte*, sipas gjendjes së sotme të kuptimeve që shprehin këto fjalë, kur kemi parasysh përkufizimin e dhënë përkatës për këto fjalë në FGJSSH (1980).

Sido që të jetë, lënda e paraqitur këtu edhe pse fragmentarisht, duhet pasur në kosideratë. Na merr mendja se nuk prishë punë, edhe pse termat e caktuar pothuajse veç e veç janë trajtuar gjetiu, po përsërisim edhe këtu se me këtë që trajtuam më sipër patëm për qëllim të vëmë theksin në ndërlikueshmërinë e temës në shqyrtim dhe njëherazi të tërtheqim jo vetëm

vëmendjen, por edhe vërejtjen faktorëve në Kosovë, që si imperativ dite duhet me dalë e vërteta sheshit, sepse në këtë fushë nuk e kemi terminologjinë e njëzuar në gjuhën tone dhe për t'ia dalë me sukses kësaj detyre na nevojitet një punë e organizuar sistemore nga institucionet përkatëse duke angazhuar edhe kuadrot e profileve të ndryshme të ndërmarrjeve a institucioneve përkatëse, të cilët edhe e njohin ose duhet ta njohin këtë problematikë. Me fjalë të tjera, pa zgjidhjen e duhur të kësaj problematike, nuk mund të bëhet as harmonizimi i terminologjisë në gjuhët përkatëse, sidomos të shqipes te ne e më gjerë.

Në fund sa për të cytur kërshtërinë tuaj po cek se do të ishte mirë të hulumtohet lidhur me problemet e natyrës së tillë në trevat e gjuhëve të tjera sesi qëndrojnë apo si janë zgjidhur çështjet e caktuara, si p.sh. në gjuhën gjermane (kam parasysh ndryshimet në sistemet shoqërore ekonomike në RDGJ dhe RFGJ, pastaj në truallin gjuhësor ku flitet frëngjishtja, anglishtja, italishtja, rusishtja etj. si dhe në gjuhë të tjera dhe se një lëndë e tillë do të na ndihmonte gjithsesi edhe sa i përket metodologjisë së punës rreth zgjidhjes së problemeve tona, siç u përmenden këtu.

4. RRETH KRISTALIZIMIT TË KUPTIMIT TË FJALËS PAJISJE SI TERM TEKNIK

Një ndër çështjet fare pak të studiuara te ne është edhe çështja e emërtimit të mjeteve teknike a të veglave të punës me karakter të përgjithshëm dhe të veçantë, në raport me barasvlerësit adekuatë të gjuhëve të tjera e sidomos të gjuhës serbokroate, e cila, siç dihet, edhe në këtë fushë ka ndikim të konsiderueshëm, sidomos në organizatat tona prodhuese.

Ç'është e vërteta, me problemin e emërtimit të mjeteve teknike ne jemi duke u ballafaquar që moti, qoftë në shkolla, qoftë në punën e bashkuar, por edhe në jetën e përditshme. gjithsesi edhe nga pikëpamja teorike - praktike nuk jemi aq pa përvojë në këtë drejtim. Të kujtojmë me respekt punën e mësuesve të lëndëve profesionale të teknikës e të shkencave natyrore - matematikore, përkthimet e librave me përmbajtje teknike - teknologjike, por edhe hartimin e doracakëve (qofshin edhe të përfunduar jo si duhet) të natyrës teknike dhe të teksteve të ndryshme, e thenë me një fjalë, kurrkush nuk mund ta mohojë "gjuhën teknike" që përdoret në të gjitha sferat e jetës e të punës ndër ne e më gjerë, por ma merr mendja se për disa çështje pikërisht rreth terminologjisë teknike - shkencore ende jemi duke ecur në fazën drejt konsolidimit(!).

Është e vërtetë se te ne ende nuk e ka parë dritën e shtypit asnjë fjalor i mirëfilltë tekniko - teknologjik i hartuar nga kuadrot tanë. Edhe nëse ekziston ndonjë material i sistemuar i natyrës së tillë në duart e ekspertëve të lëndëve të caktuara e të tjera ai është ende ka mbetur pa ndikim në përmasa të gjera.

Vlen të theksohet se edhe në fjalorët përkatës te ne lënda me përmbajtje teknike është e regjistruar nganjëherë vetëm si grumbullim fjalësh (sinonimesh) pa ndonjë kriter përparësie rreth stileve të përdorimit, kështu që nevojtarin e vë në gjendje të palakmueshme lidhur me gjetjen e barasvlerësit përkatës.

Botimi i "Fjalorit terminologjik serbokroatisht - shqip" (1961) dhe sidomos ribotimi i fjalorëve të terminologjisë tekniko - shkencore (1 - 15) me shtojcën e barasvlerësve në gjuhën serbokroate, ishte gjithsesi një ndërmarrje me shumë vlerë. Fjalorët në fjalë edhe sot e kësaj dite shërbejnë si mbështetje themeltare, mirëpo lënda e tyre është tejet modeste dhe nuk mjafton as për së afërmi për të kënaqur nevojat që dalin aktualisht në këtë plan.

Krahas botimit a ribotimit të fjalorëve përkatës të përshtatur e të përpunuar nga gjuhët e huaja shtrohet detyrë që të bëhet konsolidimi i termave të caktuar duke i kristalizuar termat e përbashkët tashmë të pranuar të gjuhës sonë, madje duke i cilësuar edhe termat specifike që kanë të bëjnë vetëm me ndonjë degë të caktuar të shkencave teknike. Njëherazi shtrohet detyrë për vlerësimin e ndonjë termi, i cili ashtu është "lancuar" ndër ne kuturu nga nevojat e "ngutshme" por pa mbështetje. Dihet se për shkak të kushteve dhe rrethanave të caktuara shpeshherë te ne ka qenë e pamundshme njohja dhe harmonizimi i terminologjisë së tillë, jo vetëm për arsye të dinamikës së zhvillimit dhe të specifikave të proceseve të caktuara teknologjike, por edhe për shkak të mungesës së njohurive profesionale, kështu që nga farkëtuesit e caktuar të paautorizuar të termave të kësaj natyre ka ndodhur që ndër ne "*të marrë udhë*" edhe ndonjë trajtë jo e logjikshme dhe gjithsesi e paqëndrueshme. Por për të mos humbur në pyllin e problemeve të tilla të përgjithshme, po i kthehem temës që e morëm në shqyrtim.

Ne më tepër të shtyrë nga dëshira që duke paraqitur çështje të diskutueshme, së paku të japim sadopak edhe idenë rreth mënyrës se si duhet bërë zgjidhja e problemeve të tilla konkretisht, pikërisht në këtë trajtesë morëm për objekt shqyrtimi "*kristalizimin e kuptimit të fjalës pajisje si term teknik*" duke e nxjerrë në shesh njëherit edhe një varg çështjesh lidhur me këtë, të cilat kërkojnë zgjidhje e miratim.

Fjala **pajisje** është emër prejfoljor, i dalë nga folja **pajis**, por edhe folja **pajis** (**me pajisë**) doli nga emri, përkatësisht tema fjalëformuese **paj(ë)**-. Fjalën **pajë** e ndeshim të regjistruar që në *Fjalorin e "Bashkimit"* (1908) si brasvlerës për fjalën **dóte** të italishtes. Kristoforidhi nuk e ka këtë fjalë në fjalorin e tij. Me fjalën **pajë** kuptohet: "*ç'merr vajza nga prindërit kur martohet*" (FGJSH (1954, f.367) përkatësisht "*plaçkat dhe pasuria që merrte vajza a nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndërrit ku martohet*" (FGJSSH f.1328). Kështu pra nga fjala **pajë** doli folja *pajis* (**me pajisë**), përkatësisht emri **pajisje**. Po njëherësh po nga fjala **pajë** doli edhe folja

paralele **pajoj (me pajue)**, përkatësisht emri **pajim/pajime** (FGJSSH f. 1328).

Këtë fakt e cekta sa për të kujtuar se si është bërë zgjerimi i kuptimit të fjalë-termave të caktuara: pajisje e pajim. Në të vërtetë, siç do të shohim më poshtë, këto trajta duke kaluar edhe në fusha kuptimore krejt të ndryshme nga kuptimi fillestar që ka të bëjë me fjalën **pajë**, u specifikuan si terma teknikë, madje edhe pse nga e njëjta rrënjë : (**paj/**) fjalët **pajisje** edhe ajo **pajim** kanë kaluar si terma teknikë me kuptime të diferencuara.

Pikërisht një diferencim i tillë do të dalë më i qartë kur të shihet fusha kuptimore që mbulon secili nga këta terma në kuadër të disa emërtimeve të kësaj natyre që mund të paraqitet si strukturë ose si një model që ecuria e tilla mund të shfrytëzohet edhe për raste të tjera brenda sistemit të shqipes.

Pa humbur kohë më poshtë po japim në shtatë gjuhë pasqyrën e brasvlerësve të përafërt, të hartuar sipas fjalorëve përkatës dhe në mbështetje të konsultimit të ekspertëve tanë të gjuhëve të caktuara, me qëllim që së paku barsvlerësia në gjuhën shqipe si strukture dhe në atë serbokroate të jetë mundësisht sa më e qëlluar, edhe pse secila gjuhë ka veçoritë e caktuara që mund të përputhen, por edhe të ndryshojnë nga gjuhët e tjera.

Pasqyra e barsvlerësve terminologjikë

Gjuha	1	2	3	4	5
1. serbokr.	sprava (orudje)	pribor	oprema	uredjaj	postrojenje
2. gjerm.	Apparat (Vorrishment)	Zubehör	Austrüstung	Einruhshtung	Anlage
3. angl.	apparatur (device)	acesory (fitings)	equipmment (outfit)	appliance (installation)	plant (installation)
4. fr.	appareil (instrument)	accesoire	écuipement	dispositif	installation (installation)
5. it.	instrumenti	accesori	equipaggiamento	attrazzatura	impianto (installazione)
6. rus.	instrument orudje	pribor (nabor)	oshashqenje snabzhenie	ustroistvo obor	oborúдование
7. shq.	vegël	veglëri	pajim/e	pajisje makineri,	instalim impian) stabiliment!!!\

Si në gjuhë të tjera ashtu edhe në gjuhën shqipe fjalën e caktuar mund ta gjejmë të shtrirë edhe për kuptimin e kolonave të tjera d.m.th. si barsvlerës të disa fjalëve, madje në stile të ndryshme edhe mund të qëndrojë, por një liri a veçori e tillë e "stilit të lirë bisedor" nuk është e lejueshme nga aspekti i terminologjisë së disiplinave të caktuara shkencore e ekonomike, ku shtrohet si nevojë e domosdoshme për përcaktime të qarta të fjalëve të caktuara si terma.

Është dukuri, pothuajse normale që ndonjëra nga fjalët të ketë shtrirje më të gjerë se të tjerat në të folmen e përditshme të zakonshme, siç është rasti me fjalën pajisje në gjuhën shqipe, *oborúdovanie* në rusishte, mbase edhe *installation* në frëngjishte si dhe *oprema* në serbokroatishte etj.

Në të vërtetë për të gjithë termat e shënuar të gjuhës shqipe sipas pasqyrës së mësipërme, në gjuhën serbokroate, sipas fjalorëve përkatës, dalin disa barsvlerës, si p.sh.:

1. **vegël** - pribor, uredjaj, instrument (FTTSH 4 1969), uredjaj, naprava (FTTSH 5 1969), sredstvo, orudje; pribor (FSHSK 1976), orudje, aparat, pribor, sprava, instrument, oprema, sredstvo (FSHSK 1981), orudje, alat (FTSHESHS 1985)

2. **veglëri** - uredjaj, aparatura (FTTSH 4 1969), uredjaj, naprava (FTTSH 9 1970), postrojenje, sprava (FTTSH 13 1973), uredjaj, aparatura (FSHS 1976), uredjaj, aparatura (FSHS 1981), pribor, postrojenje, uredjaj (FTSHESHS 1985)

3. **pajim** (pajime) - uredjaj (FTTSH 6 1969), oprema /pajime industriale - industrijska oprema, pajime teknike - tehnicka oprema, pajimet e kalit - konjska oprema (FSHS 1981), oprema (FTSHESHS 1985).

4. **pajisje** - instalacija, uredjaj, postrojenje (FTTSH 12 1969), uredjaj (FTTSH 9 1970) oprema, probor (FTTSH 13 1973), opremanje, oprema, oprava/pajisje hidrosanitare- hidrosanitarna oprema, pajisje për prodhim pambuku hidrofil - oprema za proizvodnju medicinskog pamuka/... (FSHS 1981), opremanje, opremeljanost (FTSHESHS 1985).

5. **instalim** - instalacija (FTTSH 7 1969), instalacija, postrojenje (FSSH 1976), instalacija, postavljanje, uvodjenje, ustoličenje /srtačno izvodjenje vodovodnih, električnih i drugih postrojenja/ (FSSH 1981), postrojenje (FTSHESH 1985)

Për të qenë paraqitja sa më e plotë po i jap barasvlerësit e anasjellë përgjegjes në gjuhën shqipe për termat e gjuhës serbokroate në shqyrtim, gjithashtu sipas fjalorëve përkatës:

a) **sprava** - vegël, aparat (FSSH 1947), vegël, aparat (FSSH 1953), vegla (FTSH 1961) vegël, veglëri (FTTSH 13 1973), aparat, makinë, vegël, instrument, pajisje, (FSH 1974), aparat, instrument (FTSHESHs 1986).

b) **pribor** - veglëri, mbledhje veglash (FSSH 1947), veglari, veglëri, mbledhje veglash (FSSH 1953), vegël (FTTSH 2 1959), aparat, garniturë (FTSSH 1961), pajisje (FTTSH 13 1973), veglëri, veglat e punës, garniturë (veglash), instalim (FSSH 1974), veglat, almise (FTSHESH 1986).

c) **oprema** - gatitje, pajisje (FSSH 1947), përgatitje, veshje /ratna oprema - tesha ushtërie (...) (FSKSH 1950), pajisje, takëm, përgatitje, orendi (FSSH 1953), pajë, prikë (FTSSH 1961), pajisje (FTESH 1973), (opremanje) pajisje, furnizim, gatitje, pajë, pajim, veglat, veglat e pajisje (FSSH 1974), pajisje, pajim (FTJSSH 1979), pajisje, furnizim (FTSHESH 1986)

ç) **uredjaj** - instalim, instalacion (FSSH 1953), instalim (FTSSH 1961, pajim, rregullim, instalim (uredjenje) rregullim, organizim, sistemim, pajisje (FSH 1974), veglëri (FTSHESH 1986).

d) **postrojenje** - instalim (FSSH 1947), instalim (FSSH 1953), instalim, ngrehinë, fabrikë (FSSH 1974), ??, instalim, pajisje (FTSHESH 1986).

Nga paraqitja e mësipërme mund të nxirren konstatime të ndryshme, por për këtë rast po i cekim vetëm këto:

1. Fjala **pajisje** gjendet e shtrirë si barasvlerës për të gjitha emërtimet e gjuhës serbokroate në shqyrtim.

2. Fjala **vegël** gjithashtu ndeshet si barasvlerës për të gjitha emërtimet në fjalë, përveç fjalës postrojenje.

3. Për termin **veglëri** nuk e kemi si barasvlerës fjalën oprema dhe as fjalën pribor (pos te Gorani), por për fjalën pribor të serbokroatishtes pothuajse në të gjithë fjalorët del barasvlerësi veglëri, kështu del edhe për fjalën sprava.

4. Fjala **pajim** (pajime) nuk del si barasvlerës për fjalët sprava, pribor dhe postrojenje, por del si barasvlerës i rregullt për oprema dhe uredjaj. Gjithashtu del si barasvlerës edhe për termat alat dhe orudje.

5. Fjala **instalim** del si barasvlerës i fjalës postrojenje, përkatësisht instalacija.

Kështu nga këto dhe nga fakte të tjera del se barasvlerësit adekuatë në këto dy gjuhë, sipas fjalorëve të konsultuar, dalin të pakonsoliduar dhe njëherit për ne shtrohet nevoja e arsytimit të pasqyrës së barsvlerësve të përafërt që u dhanë në këtë trajtesë, sepse nga shembujt e mësipërm të nxjerrë nga burimet e caktuara dalin mjaft paqartësi dhe gjithsesi dallohen ndryshimet nga pasqyra parapëlqyese e paraqitur më sipër prej nesh.

Me të drejtë, shtrohet pyetja ku gjetëm mbështetja për një praqitje të tillë?

Për përcaktimin e përafërt të barasvlerësisë në pasqyrën e cekur fillimisht jemi mbështetur pikërisht në përkufizimet e dhëna për fjalët përkatëse në fjalorët shpjegues në të dyja gjuhët, në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980) dhe në atë të gjuhës serbokroate "Rečnik srbskohrvatskoga knjizhevno jezik" (Fjalori i gjuhës letrare serbokroate), /1 - 6, Novi Sad (fototip) 1982/. Është konsultuar edhe fjalori i gjuhës frënge "Nouveau petit Larousse", Paris 1973, natyrisht teksti i përkufizimit të barsvlerësit përkatës të gjuhës frënge është krahasuar me përkufizimet nga të dy fjalorët e mësipërm.

Për të qenë më e kapshme dhe më e pranueshme barasvlerësia e termave në fjalë më poshtë do të bëjmë krahasimet e përkufizimeve të gjuhës shqipe me ato të gjuhës serbokroate.

a) Me fjalën **vegël** si term teknik në gjuhën shqipe kuptohet "mjeti meknik i punës (makinë, pajisje, aparaturë)" (FGJSSH f.2122), kurse në serbokroatishte me fjalëm **sprava** kuptohet "orudje koje sluzhi na izvodjenje slozhenih radnji, operacija" /vegël a mjet që shërben për të kryer një punë", përkatësisht "pajisje, aparat që shërben për kryerjen e punëve e operacioneve të ndërlikuara"/, kurse me fjalën orudje kuptohet "predmet podešen za vršenje nekog rada"/ vegël e përdorshme për kryerjen e ndonjë pune/, kështu që përkufizimi i fjalës vegël përkon me kuptimin e fjalës **orudje**, por edhe me përkufizimin i fjalës **sprava**, sidomos kur kjo del me kuptimin e një makine.

b) Ndonjë fill kuptimi fjalën **veglëri** mund ta lidhë edhe me fjalën **sprava** si dhe me atë **oprema** të serbokroatishtes, por jo edhe me fjalët **uredjaj** dhe **postrojenje**. Kështu që prania e fjalës *veglëri* si barsvlerës edhe për termat uredjaj e postrojenje më duket e paqëndrueshme. Edhe pse, siç u tha, fjala *veglëri* ka ndonjë fill kuptimi me fjalët *sprava* e *oprema* ajo më tepër se me këto ka barasvlerësi me termin **pribor**, ashtu siç është parapëlqyer prej nesh në pasqyrën përkatëse.

c) Me termin **pajim/pajime** në gjuhën tonë kuptohet "tërësia e mjeteve, veglave etj. me të cilat pajiset dikush për të kryer një punë ose një veprim të caktuar", përkatësisht pajime quhen "tërësia e mjeteve plotësuese që i duhen një mjeti për t'u përdorur për nevoja të caktuara". Në gjuhën serbokroate për kuptimin e parë pjesërisht mund të përdoret fjala *pribor*, por marrë globalisht nocionit të tillë i përgjigjet më tepër në atë gjuhë termi **oprema**, me të cilën kuptohen "stvari sa odredjenom namenom", përkatësisht "sredstvo za nešto, orudja i pomagala" /gjësende për destinime të caktuara", përkatësisht "vegla, përdorëse a mjete ndihmëse".

Me qëllim po e theksoj faktin se barasvlerësia e fjalëve, përkatësisht **pajim / oprema** jo vetëm se është e mundshme, por ajo edhe duhet të favorizohet më shumë se me një prirje zëvendësimi të fjalës tjetër paralele pajisje të gjuhës sonë, e cila siç do të shohim më poshtë, në pikën vijuese, ka pësuar zgjerim, përkatësisht ndryshim kuptimi duke i lënë hapësirë për aktivizim simotrës së saj, pikërisht fjalës **pajim**.

ç) Siç është theksuar edhe më sipër nga folja pajis, si "pajis me rroba, me këpucë", madje "me ushqime etj.", por edhe pajis me vegla, makineri, me armë etj." doli emërtimi **pajisje** d.m.th. me kuptimin "makineri, vegël aparat etj." që shërben për të kryer një punë a veprimtari" (FGJSSH f.1328) që e mbulon po atë fushë kuptimore për të cilën në gjuhën serbokroate përdoret termi **uredjaj** "skup aparata slozhenih u celini radi vršenja odredjene funkcije" /tërësi aparatesh të vendosura si tërësi, të cilat shërbejnë për të kryer funksione të caktuara/, pra nga një përkufizim i tillë del ngjajshmëria me përkufizimin e dhënë për fjalën pajisje të gjuhës shqipe, mbasi "makinat, mjetet, veglat, aparatet etj" paraqesin një "tërësi strukturore", ashtu siç u tha për fjalën *uredjaj*.

Ç'është e vërteta, nga ajo "tërësi" ne më qëllim hoqëm fjalën "orendi", sepse orenditë më tepër mund të përfillen si pajime e më pak si pajisje, pasi që ato janë "sende a pajisje të mëdha të lëvizshme si dollapë, tryeza, banka etj. që plotësojnë nevojat e përditshme në shkollë a në zyrë dhe s'kanë të bëjnë ekskluzivisht me "mjete teknike" të natyrës profesionale, siç janë "makinat, veglat, aparatet, mjetet (teknike) etj. Në gjuhën serbokroate për kuptimin e fjalës **orendi** del barasvlerësi **nameštaj** "pokretni predmeti koji sluzhe za potrebe stanovanja, za smeštaj ili rad" /pajime (mjete) të lëvizshme që shërbejnë për nevojat e banimit, për vendosje ose për punë të ndryshme/ (RSHKJ 3 f.574).

Lidhur me kuptimin e fjalës *pajisje* në raport me kuptimin e fjalës *pajim* e shoh të nevojshme të cek edhe më dallimin që mendoj se duhet favorizuar, pasi që nga përkufizimi i dhënë në FGJSSH nuk del qartë. Mendojmë se lypset përkrahur prirja që për mjetet teknike, siç u cekën më sipër, të përdoret fjalë-termi **pajisje**, kurse për ato mjete a pjesë (ndihmëse) të mjeteve, siç janë "takëmi", "garnitura", "orenditë" etj., përkatësisht veglat e veglëritë a "takravatet", siç thotë M. Bejta në Fjalorin e tij (FFSH 1987 f. 19) që kanë pak a shumë përmbajtje jo ekskluzivisht makinerike të përdoret fjala **pajim/pajime**. Kështu nuk duhet të na hutojë përkufizimi i fjalës pajisje (të pajisurit) i dhënë në FGJSH f. 367: "mjetet për të pajisur një shkollë, një zyrë etj." sepse një përkufizim i tillë simbas mendimit tonë, mbase do t'i takojë apo i takon, shikuar sipas kushteve të zhvillimit a të zgjerimit të kuptimit të fjalëve të caktuara, fjalës **pajim/pajime** e jo asaj pajisje.

Nisur nga një koncept i tillë dalin si barasvlerës të drejtë shembujt si vijon: pajimet e kalit - konjska oprema, pajimet e ushtarit - vojnička oprema, por jo pajime me armë për naoruzhanje, por pajisje më armë, armatim ose pajimi me mjete te punës, me veshëmbathje, me orendi etj., por pajisja e ndërmarrjes me makineri. Po kështu: pajime industriale - industrijska oprema, pajime teknike - tehnička oprema, por tehnički uredjaji - pajisjet teknike etj. Madje edhe shembujt në FSHS 1981 do të pësonin përshtatje: pajime për prodhim pambuku hidrofil - oprema za proizvodnju medicinskog pamuka ose pajimet hidrosanitare - hidrosanitarna oprema etj.

Sot për sot, gjuha jonë ka nevojë për një diferencim të tillë të qartë të fjalëve **pajim** dhe **pajisje**, kështu që secili term do të mbulojë fushën e caktuar kuptimore, siç u cek më sipër. Një dallim i tillë nuk na imponohet vetëm nga diferencimi i termave **oprema** e **uredjaj** të serbokroatishtes, por edhe barasvlerësit nga gjuhët e tjera të njohura.

Këtë fakt po e theksoj në mënyrë të veçantë, sepse nga mungesa e një diferencimi të tillë, siç do të shohim më poshtë te ne janë shkaktuar gabime të rënda logjike e terminologjike. Është interesant se pikërisht për fjalën **pajisje** në asnjërin nga dy fjalorët normativë dygjuhësh shqip - serbokroatisht (FSHS 1976 dhe FSHS 1981), të cilët janë në përdorim të përditshëm te ne, nuk është dhënë brasvlerësi **uredjaj** i serbokroatishtes, madje, si të themi, është lënë nën hije të barsvlerësve të tjerë edhe në FSHS 1974, ku fjala **pajisje** për **uredjaj** është shënuar si barsvlerës i fundit dhe pa ndonjë përcaktim stilistik. Gjithsesi një lëshim i tillë nuk duhet të përsëritet në të ardhmen, sepse barasvlerësia e fjalëve **pajisje** / **uredjaj** është e qëndrueshme.

d) Për fjalën **instalim** që është ndërkombëtarizëm (lat. installare - vendos) në gjuhën tonë sipas FGJSSH-së jepet përkufizimi: "vendos pajisjet teknike, aparatet, mjetet, makineritë etj. aty ku duhet të punojnë", përkatësisht ashtu quhet një "vegël, aparat, makineri, pajisje etj.", por edhe "një tërësi aparatesh etj. në një fabrikë, në një laborator a një ndërtesë të vendosura sipas punës që kryejnë" ose ashtu quhet edhe "ngrehina së bashku me pajisjet" (FGJSSH f.723).

Në gjuhën serbokroate për fjalën instalacija (instalim) ka përkufizim pak a shumë të modifikuar më të reduktuar "uredjaji i naprava nekog preduze_a ili pogona" /pajisjet, veglat e një ndërmarrjeje apo të një reparti/ (Klaiq, VRSR f.597), përkatësisht **instalacija** indentifikohet me fjalën **postrojenje** të serbokroatishtes (Vujaklija LSRI f.597), kurse në Fjalorin e

gjuhës letrare serbokroate jepet përkufizimi "uredjaj, naprava u nekom pogonu ili postrojenje" /pajisjet, veglat në një repart ose në një stabiliment/ (RSHKJ 2 f.460).

Ç'është e vërteta, në realitetin gjuhësor të serbokroatishtes mbizotëron termi **postrojenje** në krahasim me fjalën **instalacija**, e cila ruan kuptimin "postaviti neki tehnički uredjaj ili postrojenje" (Aleksiq, RSRI f.3322), përkatësisht "stručno izvodjenje vodovodnih, elektroničkih i dr. postrojenja" /vendosja profesionale e pajisjeve të ujësjellësit, të pajisjeve elektroteknike dhe të makinerive të tjera/ (LRSI f.350).

Çështja e zëvendësimit të fjalës **instalacija** me **postrojenje** do të theksohet në mënyrë të veçantë, në mënyrë që të tërhiqet vëmendja, pikërisht në këtë dukuri, sepse, siç duket, duke i shkuar pas kuptimit të kësaj fjale te ne është bërë shkarje e rëndë lidhur me përdorimin e fjalës **stabiliment**(!), e cila pa të drejtë po përdoret si barsvlerës i fjalës **uredjaj** të serbokroatishtes, por edhe për fjalën **postrojenje**, kur kjo fjalë ka të bëjë ekskluzivisht me paraqitjen e makinave e të makinerive e jo për objektin a ngrehinën së bashku me makineritë e caktuara. Madje ka raste që me fjalën *stabiliment* ndër ne të emërtohet edhe një vegël, veglëri a pajim (!).

Pasi që një dukuri e tillë e pamirë është e shtrirë pothuajse në të gjitha shtresat intelektuale te ne (Kosovë) dhe se ka marrë përmasa shqetësuese e shohim të arsyeshme të tërheqim vëmendjen këtu edhe me ndonjë hollësi plus.

Fjala **postrojenje** është fjalë e prejardhur nga tema **stroj**, e fjala *stroj* me kuptim teknik është sinonim i ndërkombëtarizmit **makinë** (serbokr. mašina), ndërsa për makineri (serbokr. mašinerija) në gjuhën serbokroate doli emërtimi **strojevi**, përkatësisht **ustroj**, prej nga **ustrojenje** dhe **postrojenje**. Folja *ustrojiti* është sinonim i foljes *postrojiti* (FSHKJ 6 f.604). Prandaj *postrojenje* ka të bëjë me: "skup mašina" /tërësi makinash/ (Klajq VRSR f.855) apo "više strojeva koji rade jedan posao" /disa makina të cilat kryejnë një punë (operim)/ (RSHKJ 6 f. 604) dhe kështu mbulon po atë fushë kuptimore si edhe fjala **instalim** në gjuhën shqipe dhe është relativisht identike me kuptimin e fjalës **makineri** (serbokr. mašinerija). Për këtë sjellim formulimin për fjalën **mašinerija** "odeljenje u kome se nalaze više mašina koje sve sluzhe jednoj istoj stvari"/ reparti (vaçania) ku gjinden disa makina, të cilat shërbejnë për një destinim të caktuar/ (Vujaklija LSRI f.543). Edhe në gjuhën shqipe për fjalën **makineri** është dhënë formulim

pothuajse i ngjashëm "tërësia e makinave në një fabrikë, në një uzinë" (FGJSSH f.1051).

Po e kujtojmë se me fjalën **postrojenje** në gjuhën serbokroate kuptohet "ukupnost različitih uredjaja u industrijskom produzeću" /tërësia e pajisjeve (makinave) të ndryshme në një ndërmarrje/ (RSHKJ 4 f.770). Edhe njëherë tërheqim vërejtjen mbi ngjashmërinë e përkufizimeve për kuptimet e fjalëve: **makineri** - mašinerija dhe **instalim** - instalacija apo *postrojenje*.

Në gjuhën italiane si barasvlerës i fjalës **postrojenje** del fjala **impianto**. Sigurisht nga kjo gjuhë kjo fjalë është reflektuar a futur edhe në gjuhën tonë si term: *impiant* me kuptimin "tërësi veglash a pajisjesh të ndryshme në një fabrikë, në një repart prodhimi, në një laborator ose në një vend tjetër që shërbejnë për të kryer një punë të caktuar" (FGJSSH f.715) Nuk dimë se sa ka qenë e domosdoshme të merret fjala e tillë nga italishtja (nuk është ndërkombëtarizëm), kur për kuptimin e tillë do të mund të përdornim në raste të caktuara fjalët: *veglëri, pajime, pajisje, instalim* apo *makineri*, por për këtë fjalën kompetente e kanë ose duhet takenë kuadrot profesionalë inxhiniero - teknike e ekonomikë në gjuhën tonë, ndërsa ne pa e kërkuar me çdo kusht favorizimin e saj po ua kujtojmë kudrove të caktuar ndër ne se në shqipe si barsvlerës për termin **postrojenje** e kemi "të pranuar" edhe fjalën **impiant**, term ky i cili gjithsesi është më i rekomandueshëm se sa fjala **stabiliment(!)**, kur kemi të bëjmë me emërtimin e makinerive të caktuara. Madje, siç e pamë, H. Gorani e shënon barsvlerësin **impiant** për **postrojenje** të serbokroatishtes.

Edhe fjala **stabiliment** është me origjinë italiane, përkatësisht latine (lat. stabilimentum - fortesë, kala; it. stabilimento - fabrikë, uzinë, ndërmarrje) rreth spacifikës së përdorimit të saj në gjuhën tonë në raport me barsvlerësinë që mund të ketë me fjalën *postrojenje* të gjuhës serbokroate më në hollësi është bërë fjalë në një rast tjetër (gazeta "Rilindja" dt. 10.VIII.1985 f.17). Por këtu, megjithatë, e shoh të arsyeshme të ndalem rreth këtij fenomeni, pasi që ka lidhje drejtpërdrejt me kuptimin leksikor të termit *pajisje*, i cili është objekt trajtimi në këtë trajtesë.

Më poshtë po i sjellin disa shembuj konkretë, në të cilët shihet qartë përdorimi pa vend i fjalës *stabiliment(!)*. Shembujt i vola me qëllim nga këto tri burime:

1. Nga gazeta "Rilindja"; "transportimi i stabilimenteve të nevojshme" (dt. 15.IV.1985 f.15), "stabilimente për ngrohje qendrore për ventilim e

klimatizim" (dt. 27.XI.1984 f.18), "për prodhimin e stabilimenteve për nxemjen e ujit" (dt. 30.V.1985 f.7), "stabilimente siguruuese dhe sinjalizuese" (dt. 12.X.1985 f.7), "për pajisje më stabilimente bashkëkohore" (dt. 27.X.1984), "u shkaktua avari në stabilimentet e laboratoriumit" (dt. 2.VII.1985 f.5) etj.

2. Nga fusha e ekonomisë dhe e teknikës: libri "Ekonomia e Kosovës" (1983) f.118 (stabiliment / uredjaj); doracaku "Plani kontabël analitik" (1980) f.12/13 dhe 292/293 (stabilimente e instalime /uredjaji i postrojenja); Në librin "Kibernetika" (1982), pajisjet (instrumentet): monitor, ploter, simulator quhen stabilimente etj.

3. Nga "Nomenklatura e profesioneve" (1983): elektroteknik i TV - stabilimenteve; montues i stabilimenteve për ngrohje; elektromekanik i stabilimenteve matëse; mekanik i stabilimenteve termike etj.

Në të gjithë shembujt e sjellë më sipër fjala stabiliment duhet të korrigojohet, sepse është përdorur në fushëm kuptimore që nuk i takon as në italisht as në shqipen letrare. Ajo në të vërtetë është përdorur si barasvlerës për fjalën *uredjaj* të serbokroatishtes e që një barsvlerësi e tillë nuk qëndron.

Po rikujtojmë se me fjalën *stabiliment* në gjuhën shqipe kuptohet "një ndërtesë ose disa ndërtesa të pajisura me mjetet e duhura për të punuar a prodhuar diçka", përkatësisht kështu quhet një "pjesë e veçantë e një ndërmarrje prodhimi" (FGJSSH f.1785) e që në gjuhën serbokroate për një nocion të tillë në raste të caktuara mund të qëndrojë si barasvlerës fjala *postrojenje*. Me qëllim ilustrimi po cekim se në gjuhën serbokroate **elektrana** (centrali elektrik) është një "postrojenje za proizvodnju električne energije (MEP f.587) /stabiliment (qendër) ku prodhohet energji elektrike/ dhe nëse fjalën *elektrana*, që është e qartë për realitetim tonë gjuhësor, e zëvendësojmë me fjalën *stabiliment* në shembujt që sollëm këtu, atëherë me siguri do ta kemi plotësisht të qartë lajthitjen ose gabimin lidhur me përdorimin e fjalës stabiliment te ne. Pra, logjikisht (gjithnjë ta kemi vëmendjen të shembujt e mësipërm) nuk mund të qëndrojnë rastet në tekstet e caktuara, sepse **stabilimenti (elektrana)**, si ndërtesë nuk mund të transportohet, nuk mund të përdoret si mjet "për ngrohje, ventilim e klimatizim", s'mund të jetë vegël a pajisje "siguruuese" as "sinjalizuese", s'mund të jetë pajisje "laboratori", pra as monitor, simulator etj. etj.

*Për të gjithë shembujt e sjellë më sipër në vend të fjalës stabiliment duhet të përdoret fjala **pajisje**.*

Shpresoj se lënda e trajtuar këtu do të zgjojë kërshërinë e kuadrove, sidomos të personelit inxhiniero-teknik dhe të përkthyesve profesionalë si dhe të hartuesve të fjalorëve përkatës, të cilët pa mëdyshje do t'i kenë në konsideratë vërejtjet e dhëna në këtë trajtesë dhe ta shpiejnë më tej kristalizimin e termave në shqyrtim dhe kështu do të ndriçohet e do të kristalizohet edhe më përdorimi i fjalës **pajisje si term teknik**. Mbase nuk do të bënin keq autorët e librit "Stabilimentet elektroenergjetike", Prishtinë 1983 të harmonizojnë terminologjinë përkatëse mbi bazë të konstatimeve që sapo u dhanë në këtë paraqitje.

Mirëpo me aktivizimin e fjalës **pajisje** nuk është mirë të harrohen fare termat si **veglëri, pajim** e të tjerë, siç është bërë në "*Fjalorin politeknik frëngjisht - shqip*", Tiranë 1983, të Dh. Jolldashit, ku për asnjërin nga emërtimet e gjuhës frënge, që u cekën në pasqyrën tonë nuk është shënuar në asnjë rast termi **veglëri** apo **pajim**, bile krahas atij **pajisje**, kështu që së paku të favorizohej konkurrimi i tyre sipas rastit.

E nxjerr të nevojshëm shënimin dhe favorizimin e trajtave të tilla për fushat kuptimore që i mbulojnë sepse vetëm në këtë mënyrë mund të manipulohet me një numër më të madh të termave aq më mirë për ne kur ato ekzistojnë në fondin aktiv të leksikut tonë, prandaj ne na mbetet t'i aktivizojmë dhe t'i përdorim me vend.

Meqenëse është hera e parë që shtrohet një temë e tillë nga fusha e terminologjisë teknike e që ka të bëjë me disa emërtime të mjeteve të punës me karakter të përgjithshëm sigurisht do të ketë nevojë për ndonjë plotësim a thellim të mëtejshëm apo ndonjë korrigjim rasti, prandaj çdo vërejtje nga lexuesit ose profesionistët do të jetë e mirëpritur.

Përfundim

Edhe pse në kuadër të emërtimit të mjeteve teknike janë arritur rezultate të konsiderueshme, megjithatë, siç thuhet në fillim të kësaj trajtese, kanë mbetur shumë çështje të hapura, madje ka ndonjë rast që ende ka mbetur në fazën e konsolidimit jo të plotë. Në përmbyllje fare shkurtimisht po rikujtojmë përmbajtjen e kësaj trajtese, ku u trajtua jo vetëm çështja rreth kristalizimit, sidomos te ne, të fjalës **pajisje si term teknik** që është objekt shqyrtimi në këtë trajtesë, por edhe çështje të termave të tjerë të kësaj nënfushë.

Në të vërtetë, fjala **pajisje** u vështrua në kuadër të emërtimeve të tjera teknike me kuptim të përafërt, të cilat në stilin bisedor madje edhe këmbehen, por në aspektin e terminologjisë teknike ato duhet të dallohen duke e ruajtur secila fjalë-term fushën e vet kuptimore të mëvetësishme.

Pas pasqyrës së barasvlerësve të përafërt në shtatë gjuhë, të hartuar në bazë të fjalorëve përkatës, u bë krahasimi i përkufizimeve të termave në shqyrtim sipas "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (1980) dhe "Fjalorit të gjuhës letrare serbokroate (RSHKJ 1-6) dhe kështu arsyetohet barasvlerësia e termave në këto dy gjuhë, si vijon:

vegël - sprava,
veglëri - pribor,
pajim - oprema,
pajisje - uredjaj,
instalim (impiant, makineri) - postrojenje (instalacija - mašinerija).

Së këtejmi, po theksojmë se për të parën herë favorizohet dallimi i kuptimit të fjalëve (emrave paralelë) **pajisje** e **pajim(e)** si terma teknikë. Gjithashtu favorizohet dhe përforcohet barasvlerësia e termit **pajisje** për **uredjaj** të serbokroatishes dhe njëherësh tërhiqet vërejtje rreth përdorimit pa vend të fjalës *stabiliment(!)* ndër ne, e cila po përdoret në atë fushë kuptimore që nuk i takon asaj po fjalës **pajisje**. Si ilustrim për këtë sillen shembuj konkretë nga tri burime të caktuara: gazeta "Rilindja", tekste nga fusha e ekonomisë dhe e teknikës si dhe nga lëmi i nomenklaturës së profesioneve. Korrigjimi i fjalës *stabiliment* si barasvlerës i fjalës *uredjaj* (*pajisje*) është i domosdoshëm, ngase një barasvlerësi e tillë nuk ka kurrfarë baze të qëndrojnë.

Në fund kërkohet nga kuadrot kompetentë profesionalë e të tjerë që ta shfrytëzojnë lëndën e shtruar këtu, ta vlerësojnë atë dhe ta miratojnë në mënyrë që kristalizimi i të gjithë termave në shqyrtim të marrë drejtimin e parapëlqyer e sidomos termi **pajisje**, i cili duhet ta ketë vendin e merituar si në jetën praktike, ashtu të zërë vendin që i takon edhe në fjalorët përkatës, por gjithnjë duhet pasur kujdes që me aktivizimin e fjalës **pajisje** mos t'u zihet fryma termave të tjerë si **veglëri**, **pajim** etj., të cilët duhet ta ruajnë secili specifikën e përdorimit në fusha të caktuara kuptimore.

(5. VII. 1985)

Shkurtesat e burimeve mbështetës të konsultuara:

1. FGJSSH - Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.
2. FGJSH - Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954.
3. RSHKJ - Re_nik srpskohrvatskoga književnog jezika (1 - 6), Novi Sad (fototip) 1982.
4. FTTSH - Fjalor i terminologjisë tekniko - shkencore (nr. 2,4,5,6,7,8,13), Prishtinë (ribot.).
5. FSHS 1976 - Fjalor shqip - serbokroatisht (M.N), Prishtinë 1976.
6. FSHS 1981 - Fjalor shqip - serbokroatisht (IA), Prishtinë 1981).
7. FSSH 1947 - Fjalor serbokroatisht - shqip, Tiranë 1947.
8. FSSH 1953 - Fjaluer serbokroatisht - shqip, (SD), pr.1953.
9. FSHSH 1950 - Fjalor i gjuhës serbishte ose kroatishte dhe i shqipes (H. Barić), Zagreb 1950.
10. FTSSH - Fjaluer terminologjik serbokroatisht - shqip? Pr. 1961.
11. FSSH 1974 - Fjalor serbokroatisht - shqip (IA), Prishtinë 1974.
12. FTESSH - Fjalor i terminologjisë ekonomike serbokroatisht - shqip (HG), Prishtinë 1973.
13. FTJSSH - Fjalor i gjuhës juridike serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1979.
14. VRSR - Veliki rječnik srtañih riječi (Klaić),Zagreb 1978.
15. LSRT - Leksikon stranih reči i izraza (Vujaklija), Beograd 1978.
16. RSRT - Rečnik stranih reči i izraza (Aleksić), Beograd 1978.
17. MEP - Mala enciklopedija Prosveta, Beograd 1978.
18. FTSHESHSHS - Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike shqip

5. FJALA FILLESË SI BARASVLERËS I PLOTË I FJALËS NAVOJ TË SERBOKROATISHTES NË FUSHËN E TERMINOLOGJISË TEKNIKE (MEKANIKE-TEKNOLOGJIKE)

Nga kompleksi i termave të fushës teknike-teknologjike që ndër ne lypset rishikuar a saktësuar me qëllim harmonizimi është edhe barasvlerësi i fjalës **navoj** të serbokroatishtes.

Ç`është e vërteta, për nocionin e fjalë-termit **navoj** të serbokroatishtes në burimet tona të caktuara dalin trajta të ndryshme barasvlerësish, si: "**spirale**, vijat a rrokët në vidhë" (FSKSH 1974 f. 420), **filetaturë** ("Detalet e makinave - tekst për shkollat teknike të makinerisë, Prishtinë 1966, f. 81 etj.), **filetë** (FSHSK (1881) f. 285, FISH i Vocit f. 145) FFSHH i M. Ndrecës, f. 233), pastaj **gvint** në rrethe të caktuara, sigurisht edhe në ndikimin e serbokroatishtes, pasi që kjo fjalë-term me origjinë gjermane është e shënuar në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare të kësaj gjuhe. (Shih edhe te RSRI të Aleksiqit f. 272.) *gvint*, është edhe në FFSHH të M. Ndrecës f. 271.

Pra si barasvlerës për nocionin e fjalës **navoj** të serbokroatishtes dalin fjalët: **spirale** (edhe spirë), me cilësi ndërkombëtarizmi, por me kuptim më të përgjithësuar kundrejt konceptit në fjalë, pastaj **vijë a rrokë në vidhë** që në situata të caktuara stilistike mund të qëndrojnë, por sa i përket natyrës së përsaktësisë terminologjike jo, prandaj me arsye, siç e pamë më sipër, për të përcaktuar më me precizitet këtë nocion, dolën trajtat **filetaturë** (nga it. filettatura (della vite), përkatësisht **filetë** (nga italishtja: filetto (impanatura della vite) e fr. filet (d' une vis), pastaj **gvint** (nga gjermanishtja (Gewinde) që janë pra huazime nga gjuhët e huaja, por që asnjëri nuk e ka statusin e ndërkombëtarizmit.

Ndër ne, siç u pa edhe nga burimet e sipërcekura, me e favorizuar del trajta **filetë** (filetoj (me filetue), filetimit, filetues/e, i(e) filetuar), trajtë kjo që këtë kuptim nuk e ka në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980). Në të vërtetë, sipas këtij burimi kompetent fjala **filetë** ka kuptimin tjetër: thelë e

hollë mishi..." (Aty f. 470), ndërsa për nocionin në shqyrtim po në këtë burim hasim trajtën **fillesë**, me të cilën kuptohet një "pjesë e vjaskuar e një vidhe, e një kundërvide etj." dhe për këtë jepet sinonimi **vjaskë** (aty f. 472), kurse për **vjaskë** jepet përkufizimi i një "e thelluar e ngushtë në sipërfaqe të diçkaje", përkatësisht "vija e thellë në trajtë spiraleje brenda tytës së pushkës a të një arme tjetër zjarri" (Aty f. 2172).

Prandaj si barasvlerës i nocionit në shqyrtim a të fjalës **navoj** të serbokroatishtes në shqipen e sotme letrare në fushë të terminologjisë teknike (mekanike - teknologjike) del fjalë-termi **fillesë** dhe si sinonim i saj trajta **vjaskë**.

Në të vërtetë, fjalë-termat përkatësisht **navoj** - **fillesë** kanë barasvlerësi të plotë, kurse fjalë-termi **vjaskë** më tepër ka barasvlerësi me fjalë - termat: **loza** dhe **vijuga** të serbishtes, sesa me **navoj**, edhe pse në situata të caktuara dalin sinonime. Për *loza*, shih FSHSK 1981 "cepi i vidhës" - "loza šrafa", f. 343 dhe "vjaska" - "vijuga", f. 1010.

Si përfundim po theksojmë se kuadrot te ne, jo vetëm ato teknike - mekanike, por edhe të tjerët, gjithsesi duhet ta përdorin termin **fillesë**, sipas rastit edhe **vjaskë**, për nocionet që në serbokroatishte përdoren fjalët **navoj**, përkatësisht **loza** e **vijuga** dhe t'i pasivizojnë a t'i nxjerrin jashtë trajtat **filetaturë**, **filetë** a **gvint**, pasi që janë fjalë të huaja pa cilësi ndërkombëtarizmi. Në rusishte, sa për kërshëri po theksoj se, për nocionin **navoj** përdoret trajta **vitok** e në anglishte **thread**.

Sidoqoftë, edhe pse fjala **fillesë** që për dikë tash mund të duket e pamotivuar dhe jo fort e kapshme, në të vërtetë, ka mbështetje pikërisht në ligjshmërinë e fjalëformimit të gjuhës sonë, kur kemi për bazë fjalën temëprodhuese fill-(fije, foljen fill/oj, me fillue) dhe prapashtesën -ESË.

Në fjalorin anglisht shqip të Ilo Stefanllarit (1988) për fjalë-termin thread është shënuar barasvlerësi "fillesë (e një vidhe)", prandaj edhe ndër ne del e domosdoshme që me rastin e botimit a të ribotimit të fjalorëve përkatës të shënohen barasvlerësit gjegjës **fillesë** - **navoj**, përkatësisht **vjaskë** - **loza** a **vijuga**, pasi që barasvlerësit e tillë nuk janë të qartë ose mungojnë fare në burimet e deritashme dygjuhësore te ne.

(Prishtinë, 12.V.1988)

6. RRETH TERMINOLOGJISË KOMPJUTERIKE NË SHQIPE

/kumtesë/

Në kuadër të emërtimeve të huazuara të mjeteve teknike në shqipen letrare **kompjuteri** (angl. *computer*) me konceptin si makinë llogaritëse elektronike, që u lind dhe u pagëzua, me këtë koncept që e ka, në SHBA në këto tri dekadat e fundit dhe erdhi, duke rritur shtat e shtrat me përplotësim koncepti vazhdimisht në tërë botën moderne, sot për sot, edhe te ne paraqitet si mjeti më atraktiv dhe universal të një specifike të veçantë, qoftë nga pikëpamja tekniko-teknologjike, qoftë nga sfondi terminologjik që e shoqëron, terminologji kjo që ofrohet me imponim edhe në gjuhën tonë. Them i imponim për këto dy arsye:

e para, sepse vjen me një paketë të tërë termash (simbolesh, shkurtesa fjalësh e fjalësh të plota me një kuptimësi të veçantë specifike) drejtpërdrejt nga anglishtja (amerikane), gjë që nuk ishte praktikë e mëparshme, pasi rëndomë terminologjia teknike në shqipe vinte nga gjuhët neolatine, më tepër nga italishtja, madje edhe ndonjë term i gjuhës angleze e tjetërkah kalonte, si të themi, po përmes kësaj rruge dhe

e dyta, të gjitha konceptet që vijnë me atë paketë emërtimeve nuk paraqiten si koncepte të mjeteve konkrete materiale sipas skemës: *objekt-koncept-emërtim* (karakteristikë kjo e të gjitha elaboreve të mëparshme tekniko-teknologjike), por aq më tepër paraqiten si koncepte të mjeteve jomateriale, sipas skemës: *koncept-joobjekt-emërtim*, edhe pse veprimet teknologjike a operacionet kryhen automatikisht dhe me korrektësi të lartë, madje edhe më me saktësi se me mjete të rëndomta të punës.

Për të qenë sa më i qartë në këtë paraqitje po përmend faktin se kompjuteri sipas konceptit të ngushtë (pra hiq shtëpizën (bordin), monitorin (ekranin), tastierën, mausin dhe printerin) përbëhet prej dy komponenteve kryesore: **harduerit** dhe **softuerit**, pjesë-komponente këto që kanë shtrirje edhe në pjesët hyrëse dhe ato dalëse të kompjuterit sipas kuptimit të gjerë.

Si rezultat i analizës së përmbajtësisë semantike të të dyja këtyre koncept-pjesëve dalin dy fakte të rëndësishme që asociojnë figurativisht që pjesën **harduer** (anglisht: **hardware**) si komponent fizik ta quajmë "**trup**" të kompjuterit, ndërsa pjesën **softuere** (angl. **software**), si komponent "të butë", ta quajmë "**shpirt aktiv**" të tij, ngase vërtet nga programimi, përkatësisht zbatimi i tij si sistem operativ del vetë jeta a veprimtaria e gjallë e kësaj makine të posaçme që vepron sipas gjuhës së komandave (gjuhë e lartë programuese e standardizuar, përkatësisht assemblerit, gjuhë e ulët jo e standardizuar) e cila gjithnjë qëndron në shërbim të njeriut, duke kryer operacione të caktuara të komplikuar me aftësinë e përkthimit të simboleve të komandimit në mënyrë vetësimultante (konvertivisht) në "gjuhën e makinës", të cilën e kupton vetë dhe vetëm kompjuteri dhe së fundi e kthen rezultatin e të dhënave dhe të informatave të përpunuara të kuptimësuar në gjuhën natyrore të shfrytëzuesit të të dhënave a të informatave në përpunim.

Pas kësaj paraqitjeje fare - fare të shkurtër dhe sigurisht jo të plotë rreth përbërjes dhe funksionit të këtij mjeti elektronik, i cili veç **trupit** paska edhe **shpirtin veprues** dhe **gjuhën e simboleve komanduese dhe programuese "teknike kompjuterike algoritmike"** që e vetkupton dhe që vepron sipas programimit të ravijëzuar në fabrikë në njërën anë dhe të njeriut konkret komandëdhënës në anën tjetër, do të përmend edhe ndonjë çështje konkrete gjuhësore terminologjike që sipas mendimit tim shtrohet në këtë kontekst para shqipes sonë letrare.

Së pari, do të përmend dy-tri çështje drejtshkrimore të diskutueshme në raportin grafi-shqiptim të anglishtes ndaj shkrim-shqiptimit shqip, të cilat nuk i ndeshim të sanksionuara në burimet përkatëse të drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare dhe si pasojë imponojnë zgjidhje.

Së dyti, del e nevojshme të thuhet paksa rreth vazhdimësisë, shfrytëzimit dhe specifikimit të fjalë-termave të shqipes nga fondi ekzistues i traditës, qoftë si emërtime profesionale në fushën e elektronikës, qoftë si huazime të modifikuara, apo edhe të kalkuara, gjithsesi të specifikuara, në kuadër të kompjuteristikës, punë kjo që lyp vlerësim të posaçëm.

Së treti, shtrohet çështja e harmonizimit të terminologjisë së caktuar në shqipe në fushën e elektronikës në përgjithësi dhe të kompjuteristikës në veçanti, qoftë në raport individësh, qoftë në raport qendrash a institucionesh të caktuara kombëtare?

Së katërti, çfarë detyrash shtrohen aktualisht para institucioneve kompetente në këtë fillim shekulli, lidhur me ndjekjen e problemit të terminologjisë kompjuterike në shqipe?

1

Kur kemi parasysh faktin, që sapo u cek më sipër, se më tepër se anjëherë më parë bashkë me konceptin e mjetit teknik nuk ka ardhur drejtpërdrejt në shqipe një numër kaq i madh i fjalë-termave të anglishtes në gjuhën tonë, disa nga të cilat edhe si komanda të punës kompjuterike që dalin të domosdoshme në përdorim, atëherë në këtë kuadër vetvetiu para shqipes letrare shtrohet detyrë të sqarohen tri çështje të ngutshme drejtshkrimore:

a) përveç përdorimit mbi bazë të shqiptimit të përafërt të adaptuar sipas grafisë së gjuhës sonë imponohet nevoja e përdorimit të fjalë-termave të caktuar edhe sipas grafisë së gjuhës angleze, prandaj në këtë raport çfarë duhet bërë?

b) si të transkribohet në shqipe **W**-ja (dubël v-ja) e anglishtes me - **U** (uindo, uord-perfekt) a me **V** (vagon) në shqipe?

c) si të shqiptohet dhe shkruhet në shqipe **L**-ja e anglishtes me **I** a me **II**?

1) Specialistët shpjegojnë se kompjuteri si pajisje elektronike, e cila "përdoret për llogaritje të shpejta, të sakta dhe të sigurta si dhe për të mbajtur në mend sasi të mëdha të informatave, të cilat do të mund të shfrytëzohen dhe azhurohen sa herë që të jetë e nevojshme", nuk mund të lëshohet a të lëshohet në veprim aktualisht pa gjuhën e ulët programore - assemblerët, gjuhë kjo e cila përbëhet nga simbole të posaçme e shkurtesa fjalësh të marra nga gjuha angleze, të cilat mundësojnë që të aktivizohet gjuha e makinës. Kështu që rregulla drejtshkrimore se "*shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes*" si dhe sqarimi se "*në shfaqjen e parë të një emri të kësaj kategorie mund të shënohet në kllapa edhe shkrimi i tij sipas grafisë së gjuhës nga buron...*", (Shih: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe (1974, f. 104.) konsiderohet jo i vetmjaftueshëm në situata të reja, siç është pra edhe përvetësimi i një pjese të terminologjisë kompjuterike. Jo pse në atë rregull nuk precizohen "termat teknikë" por

vetëm "emrat e përveçëm", por pse aty siç po shihet nga teksti është paraparë fillimisht vetëm shqiptimi e jo edhe anasjelltas shkrimi sipas grafisë së gjuhës së huaj. Prandaj jo vetëm për shkaqe komerciale a studimore, e ku ta di unë, që ka filluar "të shkilet" në praktikë "rregulla" e sipërcekur drejtshkrimore, por pikërisht për arsye të presionit që vjen edhe nga terminologjia kompjuterike duhet bërë përplotësimin e tekstit të mësipërm me një paragraf të ri shtesë, mbase me këtë përmbajtje:

"Në raste të veçanta siç janë b.f. edhe porositi, procedurat e komandat në terminologjinë kompjuterike ashtu si edhe emërtimi i firmave, markave dhe shprehjeve të veçanta të huaja etj. kur emërtimi përkatës shënohet sipas grafisë së gjuhës dhënëse, në shfaqjen e parë në tekstin përkatës në kllapa duhet të shënohet shqiptimi duke iu përshatur sistemit grafik të shqipes ose për raste të veçanta të përdoret transkriptimi ndërkombëtar".

Nga lënda që konsultova kuptohet se në të gjitha publikimet nga fusha e kompjuteristikës, qoftë në libra të veçantë, qoftë në punime të caktuara profesionale fjalë-termat e kompjuteristikës (a emërtimet e komandave) shënohen sipas grafisë angleze, krahas sqarimit a përkthimit në shqipe. Këtu do të mjaftohem vetëm me këta shembuj sa për ilustrim, duke i shënuar bashkë me shqiptimin shqip në kllapa edhe përkthimin në shqip, por pa e dhënë sqarimin përkatës:

file (fajll) - dokument a skedë, close (kllouz)- mbyll, save (sejv) - ruaj, place (pillejs)- vendos, page (pejxh)- faqe, mouse (maus)- miu (mijuesi), box (boks)- kuti, typeover (tajpouer)- mbishkruarje a mbishtypje etj.

2) Në mënyrë që mos të ketë dilema del e nevojshme që në një pikë të veçantë në burimin përkatës drejtshkrimor të ceket se **W**-ja (dubël v-ja) e anglishtes (sidomos në terminologjinë kompjuterike) në shqipe do të transkribohet (shqiptohet) me shkronjën **-U** (uindo, uord-perfekt) apo v-në (vagon)? Madje ka raste që w-ja në shqipe të transkribohet me shkronjën **ë** (Shih për këtë te gazeta Bujku, 2.II.'98 f. 11: ëord (për word), ëindoës (për windows) etj.)

Në praktikë mbizotëron zgjidhja me -U, prandaj hëpërhë një zgjidhje e tillë do mbështetje.

3) Kur është fjala të rregullat e drejtshkrimit të shqipes, pa e prekur tekstin e sanksionuar, mendoj se lidhur me disa fjalë të huazuara nga anglishtja ku thuhet se:

"ndër fjalët me burim nga anglishtja shkruhen me l: gol, golf, kloun, klub etj. dhe me ll basketboll, penallti, volejball etj." (Shih: Drejtshkrimi gjuhës shqipe (1974) f.101.),

mbase duhet shtuar sekuencën:

"mirëpo çdo fjalë e re e huazuar nga anglishtja me grafën l (ll), siç është b.f. terminologjia kompjuterike, në shqipe do të shkruhet e shqiptohet me -ll- e jo me l-",

ngase, siç dihet, anglishtja zakonisht ka vetëm shqiptimin si **ll**-ja e shqipes e jo si **l**-ja.

Prandaj zgjidhja me **ll** që duket më e mbështetur, do të lehtësonte shumë njëformësinë e shkrimit të rasteve të caktuara të terminologjisë kompjuterike në shqipe, kështu që nuk do të dilnin me trajtat dysore herë me **l** e herë me **ll** si p.sh.: fajl / fajll, kloz / kllöz, plejs / plejjs, kompajler / kompajller etj.

Sidoqoftë, kjo çështje ia vlen të shqyrtohet.

Pra siç po shihet specifika e terminologjisë kompjuterike imponon a nismon (inicon) nevojën e përplotësimit domosdo të rregullave të caktuara të drejtshkrimit të shqipes letrare.

2

Meqenëse, siç u tha më përpara, tërë elaborati tekniko-teknologjik bashkë me objektin a konceptin përkatës vjen i shënuar në gjuhën angleze, atëherë është gjë normale që tërë terminologjia e tillë së pari të jetë e imponueshme sipas mënyrës së huazimit transfer. Por menjëherë shfrytëzuesit e gjuhëve të tjera të ballafaquar më një fakt të tillë iu përveshën punës për konvertimin a shpjegimin e asaj terminologjie në gjuhën përkatëse. Kështu vepruan edhe shfrytëzuesit shqipfolës, duke bërë përshtatjet, përkthimet e adaptimet e nevojshme përkatëse. Dhe në këtë drejtim sipas aftësisë dhe detyrimit profesional bënë shumë punë të vlefshme. Nga një pjesë e literaturës që pata rast e mundësi ta konsultoja, të botuar në gjuhën tone, mund të thuhet se sukcesi që në fillim nuk ka munguar, për çka duhet përshëndetur e përgëzuar, jo vetëm për guximin profesional, por edhe për gjeturinë si dhe për ndihmesën e dhënë, qoftë në përvetësimin e dijes së caktuar profesionale kompjuterike, qoftë në pasurimin e gjuhës shqipe të stilit të veçantë. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se edhe më përpara terminologjia teknike shkencore në shqipe nuk

ishte e konsoliduar në nivelin e dëshiruar, atëherë nuk është kurrfarë befasi që edhe lidhur me terminologjinë kompjuterike, e cila siç e thotë S. Skënderi është e "posalindur" te ne dhe përgjithësisht dalin edhe gjëra të diskutueshme. Në pikën tjetër në vazhdim do të jepet edhe ndonjë vërejtje konkrete, ndërsa këtu po cek vetëm disa fjalë-terma të burimit të shqipes që u inkuadruan me sukses dhe që po përdoren mjaft natyrshëm, qoftë si zëvendësim, qoftë si sinonime ndaj termave të huazuar të terminologjisë në shqyrtim. Pra në burimet e tilla ndeshen termat e shqipes, natyrisht me kuptime të specifikuar si:

- dritare e dritarez (angl uindow),
- pulla, prekla a susta (tasta / angl. ki),
- pema (tri),
- shtëpiza (monitori),
- foleja (drajv-i?),
- çelësi (suiç -i),
- rruga a shtegu (peth-i),
- tufa a vila (klloster-i),
- shtypësi (printer-i),
- tastiera (kibord-i),
- miu a miushi(maus-i),
- këmbëza (pin-a),
- doreza (komanduese) (pult-i),
- kuleta (bafer-i),
- kujtesa (memorie),
- fjala (uord) etj.,

pa hyrë në termat togfjalësha të suksesshëm që nuk janë në numër të pakët.

Gjithsesi termat e mësipërm, edhe pse ndonjëri mund të dalë i diskutueshëm, lypset jo vetëm përshëndetur, por edhe duhen sforcuar në përdorim e sipër.

Sigurisht me kalimin e kohës kur të bëhet stabilizimi i mëtejshëm edhe më i madh i terminologjisë, atëherë do të pasojë edhe seleksionimi më me kriter i trajtave të caktuara dhe sigurisht numri i emërtimeve në shqipe (qoftë edhe si pjesë të rezervës) do të jetë gjithnjë në rritje, madje edhe trajtat sinonimike si p.sh. simbol e shënjë, shkronjë e gërmë, emër e emërtim, komandë e urdhër (mëny), fajll e skedë a dokument etj. do të jenë

më të qarta dhe më të specifikuara për nënfusha a nuanca të caktuara semantike.

3

Një çështje shumë e rëndësishme që lypset trajtuar me përsheptim është pikërisht çështja e harmonizimit të terminologjisë shqipe dhe në këtë fushë. Në të vërtetë, pos konsultimeve në mes të kuadrove përkatës profesionale, por edhe me gjuhëtarë duhet bërë harmonizimi i trajtave shkrimore të të gjitha niveleve. Harmonizimi i tillë nuk duhet bërë vetëm nga individë të caktuar, por edhe në kuadër të qendrave të caktuara studimore kombëtare (Tiranë-Prishtinë-Tetovë).

Nga përqsja që i kam bërë një doracaku të botuar në Tiranë nga F. Reshpja "*Kompjuteri pa mësues*" (1996) kundrejt gjuhës së revistave profesionale **BIT** (dy numra) dhe **PC-info** (tre numra) të vitive 1996-1997, si dhe burimeve të tjera të botuara nga autorë tanë, siç është edhe libri "*MS-DOS*" i ing. Remzi Ademit (Prishtinë 1994), doracaku i Lulëzim Bunjakut "*WordPerfect-i 5.1 për fillestarë*", *Sistemi operativ i diskut* i Dr. S. Skenderit (Ljubjana 1994) e ndonjë tjetër, fitohet përshtypja se ekziston një shpërputhje jo aq e papërfillshme në këtë kontekst. Disa nga vërejtjet a sugjerimet lidhur me shkrimin a përdorimin e disa trajtave të fjalëve të huazuara e të tjera të diskutueshme po i paraqes më poshtë:

a) Te F. Reshpja b.f. vërehet ndonjë rast i diskutueshëm si p.sh.: WordPerfect (pa iu përshtatur lakimit në shqipe), *shkruajtur* në vend **shkruar**, *standart* në vend **standard**, *anullon* në vend **anulon**, *kompjuter*a (trajtë shumësi jo e qortueshme sipas meje), norma e sotme: **kompjuterë(?)**; *guidë* në vend **udhëzues**, doracak; *preferencë* në vend **parapëlqim** e ndonjë tjetër, por ndeshim edhe gjëra mjaft pozitive që duhet t'i kenë parasysh autorët tanë. Ndër të tjera ia vlen të tërhiqet vëmendja si më poshtë:

1. Ndërsa aty ndeshim *media*, *kriter*, *direktori* etj. në shkrimet e disa autorëve te ne dalin: medium, kriterium, direktorium. Kur kemi parasysh trajtat në anglishte F. Reshpja ka vepruar më drejt. S. Skënderi parapëlqen neologjizmen "**emëror**", në vend të trajtave: *direktori a direktorium*.

2. F. Reshpja b.f. e përdor trajtën *formatim* (angl. Formatting), ndërsa te autorët tanë kryesisht del *formatizimin*. Edhe këtu kur kemi parasysh temën e qartë fjalëformuese *format-* prej nga normalisht mund të përftohet

folja **formatoj** si dhe prejfoljori **formatim**, atëherë për të njëjtin koncept trajtat *formatizoj, formatizim* dalin të panevojshme.

b) Si te F. Reshpja ashtu edhe autorët tanë bien në sy përftime të foljeve si neologjizma si p.sh. *klikoj klikim, pikoj pikim; listoj listim, pulsoj pulsdim, memorioj memorim, skenoi skenim (skenerim), resetoj resetim, printoj printim, kuadroj kuadrim, ributoj ributim, editoj editim* etj., formime këto shumica të lejueshme. Gjithsesi kur kemi parasysh specifikën e stilit që përfaqësojnë, edhe pse ndonjëra e ka sinonimin në shqipe, krijimet e tilla po të përdoren me kriter e pasurojnë fondin e fjalësit të shqipes sonë letrare në domenin e caktuar.

c) Është interesant se nga burimet e të dyja qendrave përveç prejfoljorit të normuar më -IM, tipi *shkrim* dalin edhe trajtat prejfoljore jo të normëzuara nga e njëjta temë foljore fjalëformuese tipi *shkruarje* (te Reshpja del *shkruajtje*), *gatuarje, punuarje, paguarje, mëshuarje, ushqyerje, luarje(!)*, dukuri kjo që sfidon ose më mirë kërkon vlerësim dhe qëndrim.

ç) Te F. Reshpja për fjalë-termin a komandën **bold** del sqarimi: "*me e evidentuar me të zezë*" d.m.th. kuptimi del i sqaruar me foljen në trajtën e paskajores me + pjesore (madje në trajtën e letrarizuar). Si duket edhe sqarimi: "*të marrësh në shenjë (në thumb) apo me piketosh*" që jepet nga S. Skënderi për fjalë-termin **shënjim** na jep për të kuptuar se pjesëza **me** (në vend të) i ka shpëtuar lektorimit, jo autorit, i cili si duket fillimisht e kishte formulimin kështu: **Shënjim - "me marrë në shenjë (në thumb) apo me piketue"**. Me fjalë të tjera, meqenëse përdorimi i formës së paskajores së tillë të mirëfilltë gjithnjë e më tepër po zë vend në raste të ngjashme edhe në burime të tjera cyt interesimin e kuadrove përkatës që një çështje të tillë ta vlerësojnë a rivlerësojnë me kujdesin e duhur dhe sa më shpejt ta (ri)integrojnë.

d) Po e përmend kalimthi faktin se sipas një analize që u kam bërë emrave të mjeteve konkrete në shqipe nuk kam ndeshur në raste të shumta që emërtimi i kafshës të dalë i përkthyer si emërtim mjeti në mënyrë të vrazhdë, si të themi, të paprekur, por atij i është shtuar zakonisht ndonjë prapashtesë: Krahaso: *kaluç* ndaj kalë, *qenush e qenëz* ndaj qen, *arith a arush* ndaj ari, *pelush* ndaj pelë, *pulëz* ndaj pulë, *zogël, zogth a zogëz* ndaj zog, *delesh* ndaj dele, *gjelosh a gjelush* ndaj gjel etj., prandaj edhe ndaj fjalë-termit **mi miu** si barasvlerës i trajtës **maus** të anglishtes mbase mund të veprohej ashtu disi. Lidhur me këtë d.m.th. për konceptin e **mausit**, për

mendimin tim, nuk është keq që del miu ose *miushi*, por më mirë do të dilte mbase barasvlerësi **mijues-i**. Këtë po e paraqes si ide, pasi që më ka rënë rasti të dëgjoj foljen *mijon* (bën si mi) e së këtejmi del i përligjshëm, pra, edhe prejfoljori *mijues*.

dh) Në burimet e caktuara emërtimin e **elektronikanit** e ndesha në disa trajta si: *elektronist, elektronik, elektronikient, elektronikien, elektroniqar(!)* etj. Nuk di pse nuk po përqafohet në kuadër të shqipes letrare sugjerimi a prirja tashmë e njohur dhe e praktikuar që moti që në vitet `30 nga A. Xhuvani, K. Cipo, S. Riza e të tjerë që të gjitha emërtimet e njerëzve sipas profesionit kur kanë si temë fjalëformuese një ndërkombëtarizëm me -IK(ë) fundore (tipi matematikë, fizikë, elektronikë etj.) të marrin prapashtesën -AN. Pra ashtu siç kanë gjetur zgjidhje emërtimet e tipit: *matematikan, fizikan, politikan* etj. pse mos të përligjen pra edhe trajtat ende të papërfshira në burimet normative si p.sh.: *analitikan, elektronikan, robotikan, kronikan, statistikan, kompjuteristikan* (pa i konkurruar trajtës kompjuterist) etj. etj. Përvetësimi i një prirjeje të tillë do të zgjidhte njëherë e përgjithmonë një pikë shumë të ndjeshme të emërformimit në gjuhën tonë, nevojë kjo që vërtet ndjehet për ditë dhe në mënyrë permanente.

e) Kur është fjala te gjuha e shkrimit të disa autorëve kosovarë vihet re se ato shkrime vuajnë po nga ato sëmundje që po vuajnë, hë për hë, edhe disa shkrime publicistike e të tjera në masmediat tona. Më poshtë po i jap vetëm disa vërejtje që duhet të kuptohen si këshilla dashamirëse:

1. Të bëhet më mirë dallimi semantik i fjalë-termave sinonimikë *shënim* nga *e dhëna(të dhënat)*, ngase shpesh ngatërrohen njëra me tjetrën;

2. Gjithashtu ngatërrohen në përdorim edhe fjalët *njoftim* me *njohje*, ngase e para që më tepër ka karakter administrativ (zyrtar) po përdoret në vend të trajtës së dytë që ka karakter më të përgjithësuar.

3. Në shumë raste po bëhet shkelje e vrazhdë e normës semantike në përdorimin e fjalës *kyç kyçje*, e cila më tepër sinonimi ka me fjalën *mbyll mbyllje* a *fikje të aparatit* e jo futjen a të lëshuarit në veprim, të ndërlidhjes etj. të pajisjes përkatëse.

4. Shpesh ngatërrohet fjala *zgjedh* zgjedhje me *zgjidh* zgjidhje, *përkujtoj* me *rikujtoj* a *kujtoj*; *shfaqet*, *paraqitet* me *lajmërohet*, *termi* me *termin-in*, *ofroj* ofrim me *afroj* afrim, etj.

5. Ka edhe lëshime të tjera si p.sh. *absolutikisht* në vend **absolutisht**, *teoretikisht* në vend **teorikisht**, *kadrovik* në vend **kuador**, *kabllor* në vend **masovikisht**, *tokësim* për **tokëzim** e të tjera.

6. Së fundi po e cek edhe rastin **kompjutor** kundrejt **kompjuter**, trajtë kjo që në *Fjalorin e fjalëve të huaja të IA të Prishtinës* (1988) dhe në ndonjë burim tjetër, si duket hyri a u shpif si asociacionim mashtrues në vend të trajtës **kompjuter**. Trajta e tillë e paqëndrueshme *kompjutor* nuk duhet të na hutojë, edhe pse si duket erdhi te ne edhe nën ndikimin e fjalorëve të fjalëve ndërkombëtare të gjuhës serbokroate (Klaiqi, Vujaklija, Aleksiqi etj.). E themi se është trajtë mashtruese dhe e paqëndrueshme, sepse, ç'është e vërteta, kjo trajtë nuk ndeshet faktikisht në përdorim zyrtar në asnjë gjuhë, as në anglisht, as në italisht (latinisht), madje as në serbisht e shqip. Në shqipe që në *Fjalorin drejtshkrimor* (1976) del e sanksionuar trajta **kompjuter**, trajtë kjo që del e modifikuar sipas trajtës angleze *computer*, d.m.th. me fundoren *-er*, por sipas shqiptimit - ('/ër)kompjut:(ë)r dhe + grafit fundor *-er*. Po shtoj edhe këtë se nuk duhet ngatërruar fundorët **-or** e **-er** në rastet **kompjutOR** **kompjuter**, sepse as njëra as tjetra fundore këtë rast nuk janë prapashtesa të shqipes, ngase tema *kompjut-* (nëse mund të quhet kështu, është fjalë e paqenë në shqipe) nuk motivon. Sa për kërshtëri po e cek faktin se në frëngjisht për konceptin e kompjuterit fillimisht dilnin barasvlerësit *ordinator*, *calculeur*, ndërsa në italisht *calcolatore (elettronica)*, në serbisht *računar*, në shqip *llogaritës* (elektronik), mirëpo ndërkohë pikërisht për shkak të përthellimit të konceptit që bëri vetë pajisja me term-trajtën angleze **computer**, me shqiptimin përkatës u bë e njohur dhe me konkurrencë të fituar edhe pothuajse në të gjitha ato gjuhë. Kjo kështu në formën **computer** e ndeshim të shënuar qartë në burimet përkatëse, sidomos në gjuhën italiane.

Sigurisht po të konsultoheshin edhe burimet e tjera në shqipe varësisht nga vendi i botimit, por edhe nga autorët e caktuar si dhe përkthyesit përkatës evidencimi do të ishte më i plotë, por edhe rastet do të ishin më të dukshme dhe evidente.

Siç po dëshmohet për ditë zhvillimi i kompjuteristikës s'ka të ndalur. Çdo ditë dëgjojmë për shpikje të reja në këtë kontekst, prandaj për të ecur në hap me kohën shtrohet detyrë jo vetëm ndaj kuadrove përkatës që të ndjekin të mbërrimet në rritje të kompjuteristikës dhe të evidencojnë edhe çështjet

problemore terminologjike në shqipe, por të organizohen edhe konsulta pas parapërgatitjeve të duhura. Gjithsesi duhet të bashkohen forcat intelektuale e organizative, sidomos në sektorët përkatës brenda institucioneve profesionale (shtetërore). Aty duhet të angazhohen jo vetëm kuadër i profiluar i gjuhëtarëve, por edhe i ekspertëve të elektronikës. Gjithsesi duhet të parashihet buxheti për financimin e botimit të literaturës përkatëse profesionale të elektronikës (informatikës, përkatësisht kompjuteristikës), sidomos tashti kur Shqipëria po inkuadrohet në rrjetin kompjuterik **Internet** dhe se në Kosovë gjithsesi pritet të masivizohet kjo lidhje etj. Besoj se nuk do të jetë e largët koha kur varësisht nga kushtet ekonomike dhe ngritja intelektuale e kuadrove përkatës edhe në shqipe kompjuteri, kjo pajisje e fuqishme elektronike aq universale do të flasë edhe më mirë shqip. Nuk do të jetë e largët dita kur realizimi programeve, sidomos atyre zbatimore (aplikative), siç janë tekst-procesorët e sistemet e tjera, të programohen dhe të zbatohen sipas komandave të shqipëruara, por gjithnjë në konkurrencë lojale pa dëmtuar përdorimin e fjalë-termave ndërkombëtarë në këtë fushë.

* * *

Po përfundoj me konstatimin që del si rezultat i analizës së mësipërme se në ballafaqim me terminologjinë kompjuterike shqipja gjithnjë e më tepër korr suksese të kënaqshme, megjithatë për të qenë suksesi edhe më i mirë lypset rishikuar me qëllim përplotësimi:

së pari, raporti grafi-shqiptim i trajtave në anglishte ndaj shkrim-shqiptimit në shqipe dhe në këtë kuadër del e nevojshme që në burimet përkatëse të shqipes letrare të ceket "lejueshmëria" e përdorimit të komandave kompjuterike e të ngjashme sipas grafisë së anglishtes në original e jo vetëm sipas shqiptimit të tyre. Madje duhet të vlerësohet si i drejtë transkriptimi i shkronjat **W**, **L** të anglishtes me ato përkatëse të shqipes **U**, **LL** (apo **V**, **L** (!)).

së dyti, të vazhdohet me përdorimin me tempo të forcuar të termave të shqipes nga tradita e terminologjisë elektronike me kuptim të specifikuar si dhe të sforcohen përfitimet me burim vendi, natyrisht në përputhje me ligjet e fjalëformimit e të formëzimit të termave në shqipe;

së treti, të bëhet harmonizimi i trajtave të caktuara të përfutuara qoftë nga individë të caktuara qoftë nga institucionet përkatëse të qendrave të caktuara kombëtare (Tiranë-Prishtinë-Tetovë);

së katërtri, të përkrahen financiarisht e organizativisht institucionet e caktuara, qoftë në botimin e literaturës përkatëse nga fusha e kompjuteristikës, qoftë për stimulimin e kuadrove të caktuar që të perfeksionohen në këtë fushë të veprimtarisë elektronike, në mënyrë që të mund ta mbajnë nën përkujdesje zhvillimin e kësaj terminologjie.

Gjithsesi pas parapërgatitjeve të duhura duhet rrekur me përgjegjësi hartimit apo përplotësimin të fjalorit përkatës shumëgjuhësh të elektronikës, me theks në terminologjinë kompjuterike në gjuhën shqipe.

/ R e z y m e /

Në kumtesën *Rreth terminologjisë kompjuterike në shqipe* fillimisht pasi cekën disa specifika që imponohen nga fusha e terminologjisë kompjuterike me origjinë angleze dhe sqarohet paksa kuptimi i dy pjesë-komponenteve kryesore të kompjuterit: **harduerit** dhe **softuerit** duke e cilësuar figurativisht pjesën e parë si "**trup**", ndërsa pjesën e dytë si "**shpirt krijues**" të këtij mjeti elektronik, trajtohet konteksti i ballafaqimit të shqipes kundrejt terminologjisë (gjuhës) kompjuterike në këto katër pika duke vënë në pah disa çështje të diskutueshme:

Së pari, vihet në pah raporti grafi-shqiptim i anglishtes kundrejt shkrim-shqiptimit në shqipe, kështu që përveç drejtshkrimit të paraparë sipas shqiptimit shtrohet kërkesa që në raste të veçanta të jetë i lejueshëm parësisht drejtshkrimi sipas grafisë së gjuhës së huaj, sidomos i term-kamandave kompjuterike të gjuhës angleze, pa të cilat aktualisht s'mund të shfrytëzohet pajisja në fjalë. Gjithashtu jepet ideja që në rregullat përkatëse të drejtshkrimit të sqarohet transkriptimi (shqiptimi) i **W**-së anglishtes me **U**-në e shqipes si dhe të **L**-së së anglishtes me **LL**-në e shqipes.

Së dyti, konstatohet fakti se autorët tanë të ballafaquar me terminologjinë kompjuterike kanë vepruar drejt që në fillim kur e kanë shfrytëzuar lëndën e terminologjisë elektronike të traditës në gjuhën tonë, qoftë në përdorimin, specifikimin dhe shfrytëzimin e termave të përvetësuar më përpara, qoftë duke krijuar a modifikuar terma të rinj, punë kjo që duhet vazhduar edhe më tutje, por pa e dëmtuar anën profesionale të shprehjes, p.sh.: dritare (uindo), pemë (tri), prekël (ki), çelës (suiç), dorezë (pult) etj.

Së treti, si në disiplina të tjera edhe në kompjuteristikë në gjuhën shqipe dalin çështje ende jo të identifikuar, të konstatuara ose të harmonizuara, qoftë nga individë të caktuar, qoftë nga qendrat institucionale profesionale shqipfolëse (Tiranë-Prishtinë-Tetovë), prandaj del kërkesë e

natyrshme që sa më parë të konstatohen dhe të bëhet harmonizimi institucional i terminologjisë së tillë. Për këtë pos vërejtjeve konkrete të vjela në burime të caktuara në kumtesë jepet edhe ndonjë sugjerim a ide konkrete se si do të mund të zgjidhen disa nga çështjet e diskutueshme, si p.sh. kompjuter a kompjutor, miu, miushi a mijuesi; direktori a direktuarium (emërori), formatim a formatizim etj.

Së katërti, duke pasur parasysh faktin se çështja e terminologjisë kompjuterike është në ekspansion e sipër shtrohet detyrë e ngutshme që organet kompetente shoqërore (shtetërore) organizativisht e financiarisht duhet të ndihmojnë kuadrot kompetentë, qoftë në mbajtjen e konsultave, qoftë në botimin e literaturës përkatëse profesionale si dhe në hartimin e fjalorit shumëgjuhësh të elektronikës në shqipe me theks në terminologjinë e kompjuteristikës, në mënyrë që edhe kjo terminologji të jetë nën “konrollin” a përkujdesjen profesionale të autoriteteve përkatëse.

7. DOLI ME HUMBJE JO PUNOI ME HUMBJE

Në jetën tonë të përditshme si dhe në shtyp kemi raste të dëgjojmë e të hasim mjaft dendur në përdorimin e togfjalëshit të lirë ose të shprehjes: *punoi me humbje*, si p.sh.: në gazetën *Flaka e vëllazërimit*, 25.V.'84, f. 5 (pesë raste vetëm në një artikull të shkurtër), në gazetën *Rilindja*, 2.IV.=84, f.6 (katër raste), 6.IX.'84, f.5; 19.IX.'84, f. 11 etj.) Që është edhe refleksi ose përkthim i barasvlerësit të gjuhës serbokroate *poslovati sa gubitkom* dhe ka të bëjë me veprimtarinë me humbje ose me bilancin negativ që del ndonjë organizatë prodhuese të punës së bashkuar etj. me rastin e: *regjistrimit të obliguar periodik a vjetor të të gjitha vlerave materiale që disponon organizata e tillë*, përkatësisht me fjalë-termin humbje (serb. gubitak) kuptohet shuma më e madhe e të dalave (shpenzimeve) që del si ndryshim në krahasim me shumën e të hyrave që shënohet si fitim nga shitja e mallit (Shih: *Knjigovodstveni leksion*, Beograd 1965, f. 68 dhe 226), *kështu quhet ajo pjesë e të ardhurave në ndërmarrje që nuk sigurohet sipas planifikimit* (FGJSSH, f. 699), përkatësisht ku rezultati financiar del negativ ose kur: *bilanci del pasitiv, për shkak se shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat*. (Po aty f. 144.)

Këtu nuk del kontestuese vetëm çështja e barasvlerësit të fjalës *poslovati* (*poslovanje*) të serbokroatishtes, por del kontestuese përshtatshmëria e tërë shprehjes *punoi me humbje*, pasi me kuptimin leksikor të foljes **punoj (me punue)**, prej 20 kuptimeve polisemike që jepen në FGJSSH f. 1572, 1573 asnjëri nuk del me kuptimin që mund të arsyetohet përshtatshmërie e shprehjes *punoi me humbje*, për arsye se me foljen *punoj* (me punue), përkatësisht me emrin *punë*, prej kah doli kjo folje prejëmërore kuptohet: *një veprimtari që kryhet me vetëdije* ose rezultati i veprimtarisë që është gjithsesi dobiprurëse jo ai që sjellë humbje ose të jetë dëmprurës. (Shih FGJSSH, f.1572.) Pra, nga këto fjalë kuptohet: **një veprimtari e dobishme,... e ndërgjegjshme prodhuese etj ose fryti i veprimtarisë prodhuese me cilësitë dhe vlerat e ndryshme që ka**. (Po aty, f. 1560-1570.) *Pra kuptohet një veprimtari e caktuar, që kryhet duke*

përdorur forcën e krahut e të mendjes me vegla e mjete pune për të prodhuar diçka. (Po aty f.1572.) Dhe është e ditur, në anën tjetër se me fjalën *prodhim* kuptohet një: **veprimtari e ndëgjegjshme ekonomike e njerëzve.** (Po aty 1551.) Së këndejmi, nga kjo del se nuk e qas natyra e gjuhës shqipe shprehjen: *punoj me humbje* a *po punohet me humbje*, sepse (së paku sipas FGJSSH) humbja cilësohet si një shkak a pësim i mospunës a i veprimtarisë së dobët, jo si rrjedhojë e punës.

Vlen të theksohet këtë rast që neve aspak nuk duhet të na hutojë fakti pse për foljen **punoj** të gjuhës sonë në serbokroatishte ndër 22 barasvlerës aty si barasvlerës është shënuar edhe fjala **poslovati** (shih FSHSK 1981. f. 761.). e cila në rastin tonë nuk përshtatet, po në kontekste të tjera po, pra për **poslovati sa dobitkom**, në shqipe mund të thuhet **punoj me fitim** (me punue me fitim a *punë me fitim*), por më mirë **doli me fitim** ose *pati punë me fitim* (FGJSSH f.477.), por nuk është e pëlqyeshme të thuhet: *punoj me humbje*, por **pati veprimtari** (veprimësi) **me humbje** ose më drejtpërdrejt **doli me humbje** a *veproi* (pësoi) *me humbje*.

Togfjalëshat e lirë a shprehjet, *pati veprimtari me fitim* ose “**doli me fitim**” (poslovati sa dobitkom), përkatësisht *pati veprimtari me humbje* ose “**doli me humbje**” (poslovati sa gubitkom), ku dalin nga konteksti tingëllojnë fare natyrshëm, prandaj është mirë të shfrytëzohen në gjuhën tonë të përditshme, përkatësisht të kenë vend edhe në shtypin tone, po jo *punoj me humbje*, por **doli me humbje**.

(Prishtinë, 7.IX,1984)

8. RRETH PËRCAKTIMIT TË FUSHAVE KUPTIMORE TË TERMAVE FABRIKË DHE UZINË NË SHQIPE

Si emërtime themelore për kuptimin leksikor të ndërmarrjeve industriale në gjuhën shqipe kemi termat: **fabrikë** dhe **uzinë**. S' ka dyshim se këta dy terma, edhe pse të huazuar, i takojnë fondit aktiv të fjalësit të gjuhës sonë letrare, madje kanë një përdorim mjaft të gjerë dhe aktiv. Kemi raste që në jetën tonë të përditshme të dëgjojmë, sidomos në stilin politik, poetik e retorik edhe për uzinat tona, përkrah termave fabrikë, kombinatë, etj., paradoks ky, nëse mund të them kështu, ngase në realitetin tonë gjuhësor "zyrtar" në trevën e Kosovës, nuk e kemi të emërtuar kështu asnjë ndërmarrje, edhe pse padyshim ne kemi **uzina** dhe kemi të drejtë t'i përmendim, madje edhe të krenohemi me to. Ja pra pse del e nevojshme që edhe ky term të përcaktohet më mirë në gjuhën tonë përgjithësisht, por për ne në mënyrë të veçantë. Me të drejtë shtrohet pyetja kur ne paskemi **uzina**, pse nuk i quajmë kështu dhe cilat ndërmarrje mund të quhen me këtë emërtim?

Për të dhënë përgjigje në këto pyetje a për të sqaruar paradoksin ekzistues, në këtë trajtesë ne patjetër jemi të detyruar, me aq sa dime dhe mundemi, të zbërthejmë kuptimin leksikor të fjalë-termave fabrikë e uzinë në krahasim me termat përkatës të gjuhës serbokroate, ngase në këtë raport i ka fillet dukuria si dhe përgjigja në pyetjet e shtruara më sipër.

Termi *fabrikë* (nga lat, *fabrico* - mjeshtri, zeje; punëtori) si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë pothuajse në të gjitha gjuhët ashtu si edhe në gjuhën tonë dhe në atë serbokroate ka kuptimin: "*ndërmarrje industriale ku përpunohet lënda e parë me anë makinash*", mirëpo ky përkufizim paraqitet pakashumë i përgjithshur, sidomos pas revolucionit të madh tekniko-shkencor e teknologjik të kohës a të shekullit tonë, kur ndërmarrjet e tilla u zhvilluan dhe u degëzuan aq shumë në fusha të ndryshme të ekonomisë, të teknikës, e të teknologjisë, prandaj lindi nevoja që të shpiken edhe terma të rinj. Kështu ndodhi edhe në të gjitha gjuhët, ku natyrisht dolën emërtime për

nocione të reja, qoftë duke zgjeruar polisemisht kuptimin termave të mëparshëm, qoftë duke huazuar fjalë nga gjuhët e tjera, qoftë edhe duke farkëtuar emra të rinj. Në gjuhën shqipe për këtë nocion u huazua nga frëngjishtja termi **uzinë** (usine, lexo: yzin), fjalë kjo që i referohet lat. officina), por njëherazi u ruajt gjithnjë edhe termi **fabrikë**, i cili ishte i rrënjësor që më përpara.

Para se të zërthejmë kuptimin leksikor të këtyre dy termave sinonimikë që secili u specifikua në kohën tonë për semantikën përkatëse, për të pasur një ide më të qartë rreth kësaj kundërvënijeje, po jap pasqyrën e përafërt të emërtimeve të këtij raporti në disa gjuhë, sigurisht terminologjikisht a teknikisht më të zhvilluara se shqipja, pasqyrë kjo e përpiluar në bazë të fjalorëve përkatës:

gjerm.	Fabrik	/	Work(s);
anl.	works	/	factory;
it.	fabrico	/	stabilimento;
rus.	fabrika	/	zavod;
skr.	fabrika	/	zavod(!);
fr.	fabrique	/	usine;
shq.	fabrikë	/	uzinë.

Nga kjo vihet re se ngjashmëria e termave në shqipe dhe në frëngjishte si dhe të gjuhës serbokroate me atë ruse, mirëpo mbulimi i nocioneve të caktuara pothuajse në asnjë gjuhë nuk përputhet, nuk bëhet njësoj, madje dalin edhe terma të tjerë me kuptim të ngjashëm leksikor si p.sh. manufakturë (fr. manufacture, it. manifattura) me kuptimin: "fabrikë e madhe", në rusishte për këtë referohet: "tekstil", fabrikë tekstili, ndërsa në anglisht me fjalën fabric referohet: "tekstil", pëlhurë etj, mirëpo për të mos vajtur larg po i kthehem kuptimit leksikor që ka marrë termi uzinë në shqipe.

Termi **uzinë** në gjuhën tonë ka kuptimin "një ndërmarrje e madhe industriale e mekanizuar ku prodhohen mjete e makineri ose ku përpunohet lënda e parë" (FGJSSH 1980). Po të analizohet më thellë dhe më në hollësi kuptimi i këtij termi në krahasim me kuptimin leksikor që ka termi **fabrikë** si "një ndërmarrje industriale me disa reparte të lidhura ndërmjet tyre, ku përpunohet lënda e parë me anë makinash dhe përgatiten prodhime të gatshme për t'u përdorur ose nxirren prodhime gjysmë të gatshme që

përpunohen më tej" (po sipas FGJSSH-së), del se me **uzinë**, si "ndërmarrje e madhe" emërtohen kryesisht a plotësisht ndërmarrjet industriale metalpërpunuese, si p.sh. uzina mekanike, uzina e telave, uzina e pjesëve të këmbimit etj, kurse me termin **fabrikë** emërtohen ndërmarrje industriale paksa më të vogla të degëve të tjera të ekonomisë, si p. sh. fabrika e bukës (e miellit, e vajit, e birrës), fabrika e sapunit, fabrika e sheqerit, (e cigareve, e lëkurë-këpucëve, e letrës etj.), fabrika e tullave (e çimentos, fabrika e përpunimit të qumështit, fabrika e trikotazhit, fabrika e kapelave etj.

Me një fjalë, mund të themi se kryesisht lënda e parë në **uzinë** përpunohet, përtrajtohet, por përsëri në një farë mënyre mbetet **metal**, kurse në **fabrikë** lënda e parë (zakonisht jo metale), përpunohet a "fabrikohet" duke e tjetërsuar edhe materien në të shumtën e rasteve. P.sh. nga përpunimi i rrepave ose e panxharsheqerit del sheqeri - fabrika e sheqerit, nga drithi del mielli - fabrika e miellit, nga mielli del buka - fabrika e bukës, nga luledielli a ulliri del vaji - fabrika e vajit etj.

Nga sa u tha më sipër del qartë se në gjuhën shqipe të gjitha ndërmarrjet industriale ku përpunohet metali, duhet a është e udhës të quhen **uzina**, ndërsa ku përpunohen **lëndë të konsumit të gjerë, lëndë ushqimore, ndërtimore** etj. është e udhës të quhen pa mëdyshje: **fabrika**.

Nga ky përcaktim dalin të drejta emërtimet: "*Uzina e amortizatorëve - Prishtinë*", *Uzina për prodhimin e gypave - Ferizaj*, *Uzina e pjesëve të automobilave "R. Sadiku" - Pejë*, *Uzina për prodhimin e pajisjeve elektrike - Prishtinë* etj. etj., ndërsa duhet të vazhdojnë të quhen fabrika: *Fabrika e miellit - Xerxë (Gjakovë)*, *Fabrika e bukës - F. Kosovë*, *Fabrika e tapetave (tapicerive) - Prishtinë* etj.

Në mbështetje të rregullës që u tha më sipër duhet të korrigjohen rastet e caktuara si p. sh. Uzina e çelesheve, kapelave dhe beretave - Begej, firmë e vendosur në Prishtinë afër Shkollës follore "V. Nazor" (nr. 28). "Uzina e tapetave" në librin "Gjuha shqipe dhe (...)" (1984, f. 124) etj.

Mirëpo çështja te ne del edhe më e ndërlikuar, kur kemi parasysh faktorët jashtëgjuhësorë, prandaj ky fakt duhet të shqyrtohet me kompetencë nga kuadrot dhe faktorët përkatës të institucioneve tona shoqërore - shtetërore, përkatësisht të ndërmarrjeve të caktuara të cilat duhet të japin propozimin për ndërrimin e emërimit me qëllim që secila të marrë emërtimin përkatës që i përgjigjet në gjuhën shqipe varësisht nga veprimtaria themelore që ushtron ndërmarrja e caktuar, kjo aq më tepër del e nevojshme të shqyrtohet edhe në suaza pushtetore, siç e thashë, pasi që te ne

në gjuhën serbokroate pothuajse të gjitha ndërmarrjet janë të pagëzuara si fabrika, pra edhe ato metalpërpunuese(!).

Çështë e vërteta në gjuhën serbokroate termi **fabrika** (kroatisht: tvornica) ka kuptimin e termit **fabrikë** të shqipes, por edhe pjesërisht edhe të termit **uzinë**. Në të vërtetë për nocionin e termit uzinë në serbokroatishte përdoren edhe termat si: *zavod, industrija, mašinogradnja, postrojenje* etj., të cilat duhet pasur parasysh edhe këtë rast, prandaj po cek kalimthi ndonjë rast me interes mbi termat e sipërcekur që ndërlidhen me temën që po e trajtojmë këtu.

Para se të përmend disa konsiderata lidhur me termin **zavod** të gjuhës serbokroate po jap dy shembuj të përdorimit të këtij fjalë-termi në gjuhën ruse, në krahasim me përkthimin adekuat në gjuhën serbokroate dhe në atë shqipe:

1. rus. Zavod avtomobilniji;
 skr. Fabrika automobila;
 shq. Uzina e automobilave

2. rus. Pivovarnij zavod;
 skr. Fabrika piva (pivara);
 shq. Fabrika e birrës (birrëtoje).

Pra në gjuhën ruse për të dy shembujt përdoret termi zavod, në gjuhën serbokroate termi fabrika, ndërsa në gjuhën shqipe përdoret termi **uzinë** për për shëmbullin e parë, ndërsa **fabrikë** për shëmbullin e dytë.

Në gjuhën serbokroate termi **zavod**, sipas RSHKJ ka kuptimin e një "enti (themelate) a institucioni edukues shkollor, e pastaj nën kuptimin e dytë "emërtimin e plotë a të pjesshëm të institucioneve të tjera", pra edhe të ndërmarrjeve metalpërpunuese. Megjithatë me këtë term është mbuluar edhe ndonjë emërtim që i përgjigjet te ne barasvlerësit **uzinë**. Si duket, rastet e tilla me emërtimin **zavod** për industrinë metalpërpunuese në serbokroatishte kanë mbetur si trashëgim kur kishte ndikim në këtë gjuhë terminologjia ruse, sidomos në vitet e pas Luftës II Botërore.

Sidoqoftë, duhet ta kemi të qartë që fjala **zavod** e serbokroatishtes në shqipe duhet të përkthehet pa ngurrim me përgjegjësin **uzinë** e jo me trajta: *stabiliment, ngrehinë, fabrikë* - siç po ndodh herë-herë në shtypin

tonë, si në gazetën "Rilindja", më 27. VII. 1981, më 9. VI. 1982 etj. Më saktësisht kështu duhet përkthyer b.f. emërtimet: Zavodi "CZ" - Kragujevac, T. Zavodi "Litostroj" - Ljubljana, Metalni zavodi - Skopje, Zavodi "(e)R(e)R" tash EI – Nish, saherë që paraqitet e nevojshme.

Çështë e vërteta, termi **zavod** jo vetëm që po përdoret gjithnjë e më pak në gjuhën serbokroate, jo vetëm për emërtimet e ndërmarrjeve industriale (si term nuk është përfshirë as në *Ekonomski leksikon*, Beograd 1975), por edhe për nocionin e enteve a institucioneve të tjera (druge ustanove) nuk po përdoret, sidomos pas konstitutimit të BVI-ve, p.sh. Zavod (tash SIZ) za zapošljavanje (**Enti**) tash **BVI**) për punësim, SIZ za socijalno osiguranje (BVI për sigurimin social) etj.

Mirëpo ne nuk na tërheq vëmendjen vetëm, pasivizimi i termit zavod, por edhe aktivizimi i termit **indusrija** për të emërtuar ndërmarrjet industriale metapërpunuese, ashtu si emërtohen në shqipe me termin *uzinë*. Prandaj me termin **uzinë** në gjuhën shqipe kuptojmë nocionin e termit *fabrika* (pjesërisht), të termit *zavod* (për raste po ashtu pjesërisht) dhe të termit *industrija* plotësisht, kur ka të bëjë me ndërmarrjet industriale metalpërpunuese. Pra në mungesë të termit *uzinë* te ne (Kosovë), pra nën ndikimin e gjuhës serbokroate tashti në tërë Kosovën ndërmarrjet e caktuara po quhen **industri**. P.sh. në Janjevë, edhe pse është një uzinë relativisht e vogël quhet "**Industria për përpunimin e metaleve fisnike**". Madje ndodh që në të njëjtin qytet i ndeshim të emërtuara dy ndërmarrje si industri, edhe pse që të dyja i takojnë degës metalike. P.sh. Industria metalike - Ferizaj dhe Industria elektrometalike - Ferizaj (Shih te "Rilindja", më 21. V. 1982), kështu që, në të vërtetë, në shqipe ndërmarrjet e tilla është e udhës të quhen **uzina** e jo industri.

Termi **industri** në gjuhën shqipe ka kuptimin "tërësia e uzinave, e fabrikave etj." që në kushtet tona tashti po quhet "**organizatë e përbërë e punës së bashkuar**" që përfshijnë degën e caktuar b.f. të ndërmarrjeve metalpërpunuese, uzinave, në mbarë Kosovën.

Sido që të jetë, për ne është me rëndësi që me këtë paraqitje të bëjmë të ditur kuptimin lesikor që ka termi **uzinë** në raport me atë **fabrikë**.

Në gjuhën shqipe (në Shqipëri) nocioni i termit **uzinë**, si duhet, ka pësuar zgjerim kuptimi. Kjo vërtetohet edhe nga krahasimi i përkufizimit të dhënë për këtë fjalë-term në FGJSH 1954 si një "ndërmarrje e madhe industriale që përpunon me mjetet mekanike lëndët e para" me përkufizimin

e dhënë në FGJSSH 1980 si një "ndërmarrje e madhe industriale e mekanizuar" e cila jo vetëm "përpunon lëndën e parë", por aty "prodhohen mjete prodhimi e makineri" (Aty f. 2101.), që në serbokroatishte nocioni i tillë mbulohet më fort me termin **mašinogradnja**. Sa i përket termi **postrojenje** në shqipe më shumë parapëlqen barasvlerësi **stabiliment**, por jo plotësisht.

Nga autorë kosovarë, përpilues fjalorësh, fjalë-termi **uzinë** është përdorur relativisht vonë. Nuk e ndeshim as në Fjalorin termonologjik serbokroatisht - shqip të viti 1961, për të parën herë e ndeshim të regjistruar në FSKSH 1974 si barasvlerës për termin **zavod**. Mikel Ndreca në Fjalorin e tij shqip-serbokroatisht (1976) e shpjegon me përgjegjëset fabrika (tvornica) dhe (industrijsko) preduzeće, kurse fjalën zavod nuk e përmend fare. Në FSHSK (1981) si ekuivalent i fjalës uzinë në serbokroatishte dalin përgjegjësit: *fabrika, pogon, poduzeće, zavodi*, kështu që në këtë burim (hiq fjalën pogon - repart) ndeshim një përkufizim paksa më të drejtë se në burime të tjera.

Gjykimi se fjalë-termi **uzinë**, edhe pse e huazuar si term kulture, si fjalë e huaj, nuk del e nevojshme të përdoret te ne, pasi që tashme konceptin e tillë e kemi të zgjidhur, qoftë me termin fabrikë, industri etj. ashtu siç është zgjidhur edhe në gjuhën serbokroate, nuk qëndron. Nuk qëndron kur kemi parasysh terminologjinë shqipe në shkallë kombëtare. Së këndejmi, kur kemi parasysh lirinë e gjuhëve, nuk besoj se mund të krijohen "telashe" jashtëgjuhësore, nëse "fabrikat" a "industritë e veçanta" metalpërpunuese në gjuhën tonë do t'i quajmë dhe do të shënojmë si "uzina", ndërsa në gjuhën serbokroate le ta mbajnë emërtimin përkatës që i përshtatet natyrës së asaj gjuhe. Ne kemi plotësisht të drejtë, që siç po përdoret në stilet e tjera funksionale, të përdoret edhe në emërtimet zyrtare konkrete termi **uzinë**, sipas terminologjisë së rrënjësuar në gjuhën letrare të njësuar shqipe, apo jo?.

Me zbatimin e emërtimeve të tilla ne kryejmë detyren qytetare që na takon, qoftë si shtetas, qoftë si studiues, andaj të gjithë ne duhet ta japim ndihmesën tone në harmonizimin, njësimin dhe zbatimin e terminologjisë unike tekniko - shkencore në mbarë truallin shqipfolës.

Prishtinë, gusht 1981

9. PËR AKTIVIZIMIN E FJALËS VEÇANE / VEÇANIA

Është e ditur se përftimi a farkëtimi i fjalëve të reja apo shumëkuptimësia e fjalëve të caktuara motivohet edhe nga raportet në mes të gjuhëve të ndryshme, sepse nga marrëdhëniet e tilla bashkë me dukurinë a sendin e caktuar silltet edhe koncepti, i cili lypset për t'u emërtuar domosdo, ngase ai zakonisht vjen bashkë me emërtimin në gjuhën e huaj, dhe kështu mund të hyjë si barbarizëm, apo jo? Në vazhdë të kësaj dukurie, te ne shtrohet nevoja për gjetjen e barasvlerësit adekuat për fjalë-termin **odeljenje** të gjuhës serbokroate si term me kuptim të një lokali të veprimësisë, zakonisht në kuadër të uzinave ose ndërmarrjeve të mëdha metalpërpunuese.

Një nevojë e tillë ndihet edhe në sektorë të tjerë të jetës e të veprimtarisë te ne, por është më i ndieshëm në organizatat prodhuese, sidomos, siç u tha, në ndërmarrjet metalpunuese, siç është "Uzina e Amortizatorëve" - Prishtinës, ku emërtimi **odeljenje** ka të bëjë me njësi të caktuar në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes që del nga kuptimi i lokalit të caktuar, ku kryhet një veprimësi e veçantë e ndryshme nga të tjerat.

Për të pasur më të qartë dhe më të kapshme temën objekt shqyrtimi të kësaj trajtесе më poshtë po jap skemën globale organizuese (organizative) të kësaj ndërmarrjeje në gjuhës serbokroate dhe atë në shqipe, sipas organikës ose sistematizimit të punëve dhe të detyrave:

1. Radna organizacija udruzenog rada - Organizata punonjëse e punës së bashkuar
2. Osnovna organizacija udruzenog rada - Organizata bazë e punës së bashkuar
3. Radna jedinica - Njësia punonjëse
- /pogon. posebno odeljenje/ - /reparti/
4. Organizacijona jedinica - Njësia organizuese
5. Sektor - Sektori
6. Služba - Shërbimi

7. Linija - Linja a Vija
8. Odeljenje - mungon termi adekuat ?!(reparti, sektori, seksioni, paralelja, veçania!?)
9. Izvršioçi poslova i radnih zadataka - Kryerësit e punëve dhe të detyrave
10. Radna mesta - vendet e punës.

Pas këtyre emërtimeve pasojnë fjalët përkatëse përcaktuese të emërtimit të plotë të njësisë së caktuar. Ndërmarrjet e caktuara (fabrikat a uzinat) mund të kenë skemë tjetër, por për ne kjo që u paraqit do të mjaftojë sa për t'u kuptuar çështja që e morëm në shqyrtim, përkatësisht për të gjetur zgjidhjen sa më të drejtë lidhur me përcaktimin a gjetjen e termit adekuat në gjuhën tonë për barasvlerësin **odeljenje** të gjuhës serbokroate.

Për të ndihmuar më me lehtësi zberthimin e mëtejshëm të çështjes më poshtë po jap strukturën kuptimore (skemën polisemike) të fjalës **odeljenje** të asaj gjuhe, sipas fjalorit të gjuhës letrare serbokroate (RSHKJ 4 N. Sad 1971, f.36 - 37) duke i përkthyer përkufizimet në gjuhën shqipe si dhe duke dhënë përgjegjëset në gjuhën tonë ashtu siç janë dhënë në fjalorët përkatës:

ODELJENJE

1. Pregradjeni deo unutrašnjosti zgrade, prostorija. /*pjesë e ndarë/kthinë/ në një ndërtesë a të një lokali.*

Teksti shqip ka ose mund të ketë këta barasvlerës:

a) (*soba*) *odë, dhomë, danik, veçane.*

b) (*apartman*) *ane-ja (Bariç), e ndarë (e ndame, e dame), apartament.*

2. a) Deo neke ustanove, ureda, organizacije i sl. sa odredjenom delatnošqu.

/Pjesë e një institucioni, zyre, organizate etj. me veprimtari të caktuar/ shqip : repart (në një ndërmarrje, në spital), seksion, sektor, kompartament (në tren), ndarje, drejtori (S. Doboshi).

b) Vojn. Manja jedinica sa specialnim zadatkom.

/Usht. Njësi e vogël (ushtarake) me detyrë speciale/.

shqip: *repart, njësi, togë.*

3. Zajednica učenika u sastavu jednog razreda sa zasebnom nastavom.

/Bashkënjësi nxënësish në kuadër të një klase me mësim të ndarë, paralel,/ shqip: paralele.

Pra si barasvlerësi më adekuat përballë kuptimit leksikor të termit **odeljenje** në ndërmarrje (ekonomike) në gjuhën tonë parapëlqehen termat **repart** ose **sektor**, por siç shihet në skemën e mësipërme që të dy këta terma janë të zënë po në të njëjtën skemë dhe paraqesin një nëndarje më të gjerë organizative dhe kështu s'kanë se si të përthekojnë edhe këtë kuptim.

Edhe termi **seksion** (nga lat. sectio - *ndarje, prerje, këputje*) që ka kuptimin kryesor "degë ose ndarje e veçantë në një institucion (shtetëror) a organizatë shoqërore" (FGJSSH f.1739) nuk është i rekomandueshëm për një nëndarje të tillë të ngushtë në ndërmarrje prodhimi.

Termi **paralele** (nga gr. paralelos) për nga analogjia formale kuptimore mund të jetë i kapshëm, sepse veç tjerash e kemi të njohur nga shkolla, por pikërisht këto "paralele" në ndërmarrje ndryshojnë në esencë e në formë në krahasim me punën e nxënësve. Në njësitë e tilla në ndërmarrje kryhen krejtësisht veprimtari të tjera, prandaj emërtimi *paralele* nuk përshtatet. Këto njësi janë në të vërtetë nënreparte apo nënsektorë të caktuar, por në kushtet tona termat nënrepart apo nënsektor edhe këta nuk dalin të përshtatshëm, madje edhe sa i përket afrisë kuptimore ose sa i përket rangimit nuk dalin si zgjidhje aq të pranueshme, sepse *odeljenje* vjen pas emërtimit vijë a linjë, d.m.th. me koncept edhe më të ngushtë.

Në ndërmarrje të caktuara, sidomos tek ato që merren me veprimtari ndërtimore, bujqësore, blegtoriale dhe disa prodhuese përdoret termi **brigadë** (fr. brigade) që paraqet njësinë bazë, përkatësisht "një grup të organizuar njerëzish që kryejnë një punë të caktuar" (FGJSSH f. 179), por ky term përdoret zakonisht për punë publike me vend lokal të papërcaktuar e që në ndërmarrjet metalpërpunuese, sidomos te ne, nuk praktikohet një term i tillë, ku lokali i njësisë në shqyrtim përcaktohet qartë dhe puna kryhet në vazhdimësi po në atë lokal.

Në rrethana të caktuara një njësi e tillë mund të quhet **linjë (vijë)**, por çdo njësi e tillë s'mund të quhet **linjë a vijë**, madje një linjë (vijë) mund të ketë më shumë njësi të tilla që në serbokroatishte po quhen odeljenje.

Prandaj për të mbulur plotësisht kuptimin e termit odeljenje, siç po paraqitet këtu, ma merr mendja, se më së miri është të aktivizohet fjala **veçane - veçania** që është fjalë e fondit aktiv të leksikut të gjuhës onë, nuk ka prejardhje të huaj, siç kanë të gjithë termat që u cekën më sipër dhe pikërisht kjo fjalë, siç e pamë, qëndron ose është në vatrën e kuptimeve sinonimike të shënuara në barasvlerësi të fjalë-termit **odeljenje**.

Me fjalën **veçane/veçania** në gjuhën shqipe kuptohet një "kthinë e veçuar, e ndarë nga të tjerat" (FGJSSH f.600) apo "kthinë e veçuar nga të tjerat në një shtëpi" (FGJSH f.2121) që në gjuhën serbokroate kjo fjalë është përkthyer "odeljenje, posebna (odvojena) prostorija" (FSHS 1976 f.350) ose "posebna prostorija, posebno odeljenje" (FSHS 1982 f.987) që shikuar në përgjithësi fjala **veçane** pothuajse plotësisht i përgjigjet kuptimit fillestar të fjalës odeljenje të përcaktuar në gjuhën serbokroate "*pjesë e ndarë e ndonjë lokali*".

Ç' është e vërteta, siç u tha më sipër, me *odeljenje* kuptohet një lokal i caktuar, ku janë vendosur makineri e pajisje apo materiali i caktuar i punës që ceken si gjymtyrë përkufizuese e togfjalëshit të caktuar si p. sh.:

Odeljenje podsklopova - Veçania e nënblloqeve,
Odeljenje presa - Veçania e presave,
Odeljenje automata - Veçania e automatave,
Odeljenje universalnih i doradnih mašina - Veçania e makinave universale dhe atyre përpunuese etj.

Përkatësisht lokali e merr emrin sipas procesit teknologjik që kryhet aty me përdorimin e makinave të caktuara të vendosura në atë lokal, p.sh.:

Odeljenje brušenja - Veçania e grihjes,
Odeljenje galvanizacije - Veçania e galvanizimit,
Odeljenje farbanja (farbara) - Veçania e ngjyimit (ngjyrosjes),
(ngjyrtorja a ngjyrimtorja).

Pra, siç po shihet nga shembujt është fjala për "anë të veçuar" (veçane) që janë të ndara në hallat e punës si lokale të veçuara dhe me të vërtetë vetë etimologjia e fjalës veç + an(ë) = **veçane** nga "anë e veçuar" është një ko incidencë , bë e gjetë, si thuhet, kur diçka përshtat për bukuri me realitetin që na imponohet apo ashtu pasqyrohet nga jeta në *hallat* e prodhimit.

Këtu nuk është nevoja të ndalem në trajtimin e fjalëve të prejardhura nga tema veçan- si p.sh. *veçanti, veçanërisht, i veçantë, e veçanta, veçan, të veçantët* etj., si dhe për prirjen për formimin e fjalëve të reja, që nuk është pa interes, por edhe vetë nga dukuria e tillë mund të nxirret përfundimi se aktivizimi, përkatësisht përkufizimi i kuptimit të ri të fjalës **veçan/e veçania**

si term për të paraqitur një lokal veprimësie, përkatësisht një njësi të caktuar të organizimit të brendshëm në ndërmarrje, është jo vetëm i mundshëm, por edhe i arsyeshëm, kur kemi prasysh se zgjidhje tjetër më e përshtatshme nuk na ofrohet.

Edhe diçka duhet pasur parasysh, nëse kemi të bëjmë me një **odeljenje** a **posebno odeljenje** (pogon) si njësi organizuese në ndërmarrje që është e ndërlikuar dhe më vëllimëshe se njësitë e tjera dhe se në kuadër të saj mund të ketë njësi më të vogla organizuese dhe në vete ka kushte dhe mundësi të bëhet njësi e pavarur ekonomike, atëherë një njësi e tillë pahamendje në gjuhë tonë mund të quhet **repart**, **punishtë**, **fabrikë e vogël** etj. e jo *veçane*, por në rastin tonë ku **odeljenje** nuk ka mundësi të tilla, atëherë propozojmë që nocioni i tillë të mbulohet me emërtimin: **veçan/e / veçania**, sepse kemi të bëjmë me një njësi organizuese për dy a tri shkallë më të vogël se repart.

Po përsëris se fjalë-termi **veçania** (si anë e veçuar) plotësisht përshtat me vendin që zë në hallat e punës termi i tillë i serbokroatishtes, ngase **odeljenje**, përkatësisht **veçania** është lokal i veçuar i caktuar për veprimësi të caktuar dhe plotësisht i përgjigjet kuptimit primitiv "anë e veçuar" apo "e ndarë e veçantë" në një hapsirë (lokali).

Krahaso:

- a) it. scormpatimento, serbokr. odeljenje, shq. veçane;
- b) it. riparto, serbokr. pogon (odeljenje), shq. repart.

Me aktivizimin e fjalës **veçania** si lokal veprimësie si barasvlerës të termit **odeljenje** të gjuhës serbokroate, ne i japim jetë termi një fjale të gjuhës sonë, të krijuar me brumin e saj dhe pikërisht ia kthejmë të gatuar me jetë të re po asaj gjuhe, aty ku e marrim pra në prehërin e kuptimësisë hapësinore që e ka në hallkat e zingjirit të strukturës gjuhësore të ligjërit tonë.

Parimisht një punë e tillë është e drejtë dhe se më duket është në përputhje me detyrat që na shtron gjuhësia jonë lidhur me krijimin e terminologjisë tekniko - shkencore, sidomos "duke zgjeruar kuptimin" e fjalëve të caktuara a "duke shtrirë atë edhe përtej sferës së ngushtë të jetës praktike dhe zejtare, gjer në konceptet e përpikta e abstrakte të shkencës". (Shih: *Parathënie e fjalorëve të terminologjisë tekniko - shkencore* (1), Prishtinë 1970, f.6.)

Së këtejmi është e udhës që një term i tillë të përkrahet nga të gjithë faktorët përkatës të truallit të gjuhës sonë dhe të gjejë zbatim aty ku ka nevojë.

Fundi i fundit ne e nxorëm në shesh një fjalë të brumit të shqipes, së cilës i japim cilësinë e termit teknik-ekonomik dhe konkurrenca lojale mund ta sforcojë, apo jo, për konceptin e caktuar ose edhe mund ta nxjerrë jashtë.

Gjithsesi edhe kjo mundësi duhet të shfrytëzohet dhe jeta e një fjalë-termi të tillë barasvlerës **veçane – odeljenje** le të përcillet, ose le të kihet parasysh si zgjidhje jo e qortueshme momentalisht.

(Prishtinë, 4.X.1984)

10. TRAJTA SERVIR SI NJË RAST I VETMUAR

Në të folmen e disa intelektualëve si dhe në ndonjë shkrim të tyre kemi pasur rastin të dëgjojmë a të lexojmë trajtën **servir** (Shih edhe të gazeta Bujku, 10.IX.'92, f.4) të përdorur për konceptin: *shërbej me diçka a ofroj diçka* në raste të caktuara edhe më ngjyrim politik. Përdorimi i një trajte të tillë ka shkuar aq larg sa që ka arritur të jetë e regjistruar si fjalë shqipe në Fjalorin shqip-serbokroatisht të IAP-së, Prishtinë 1981, për barasvlerësin e serbokroatishtes *servirati* (Shih aty, f. 849) : *servir - servirati poslužiti jela, pica / servoj (shërbej me) gjellëra, pije/*

Pasi trajta **servir** paraqet një rast të jashtëzakonshëm në strukturën fjalëformuese të gjuhës sonë, siç do të shohim më poshtë me të drejtë shtrohet pyetja: prej kah u përftua trajta **servir** dhe sa është e qëndrueshme një fjalë e tillë pikërisht në kuadër të strukturës foljeformuese të gjuhës sonë? Përgjigjen do të përpiqem ta jap në vazhdim.

Në shqipe fjala **servir** është e përftuar si një huazim transfer nga frengjishtja **servir** (e në atë gjuhë rrjedh nga latinishtja *servire*). Importimi i tillë i drejtpërdrejtë transfer, d.m.th. pa kurrfarë ndryshimi i foljes në fjalë, paraqitete si rast i veçuar në gjuhën tonë dhe mund të konsiderohet si një përfitim jashtë rregullës që edhe aktualisht zbatohet lidhur me huazimin e foljeve të tipit të tillë. E thamë *jashtë rregullës*, sepse foljet në shqipe zakonisht përftohet sipas të ashtuquajturin huazim hibrid, d.m.th. tema (leksema) huazohet, ndërsa sufiksi (morfema) zëvendësohet. Një rregull i tillë është tradicional në gjuhën tonë.

Le të krahasohet lidhur me këtë trajta **servire** e latinishtes me trajtën **shërbej** të shqipes, ku raporti i interferencës, edhe pse mbase për dike del paksa i errësuar, edhe në gjendjen e sotme mund të kuptohet ajo mënyra e huazimit hibrid, që sapo u cek prej nesh. Krahaso: rrënja: **serv-** = **sherb-** dhe prapashtesa: **-ire** = **-ej**. Të vihet re, pra, ngjashmëria e temës prodhuese. Ky është përfitimi i parë mbi këtë bazë. Po cili qenka përfitimi i dytë apo i tretë?

Ndërkohë pasi formanti -ej u pasivizua bashkë me disa formante të tjera, dhe kur në gjuhën tone mbeti stabil (prodhimtar) për formimin e foljeve vetëm formanti **-o/j**, prapashtesë kjo autoktone (indoeuropiane e shqipes, e cila arriti të jetë aktive edhe produktive edhe në gjuhën e sotme letrare. Atëherë po në mbështetje po të kësaj rregulle (përftimi hibrid) të trashëguar, huazimi i ri i (i dyti) i trajtës servire të latinishtes, përkatësisht *servir* të frëngjishtes do të duhej të dilte në trajtën **servoj**, që do të thotë se tema *serv-* do të huazohej e pamodifikuar, ndërsa prapashtesa -ir do të zëvendësohej me barasvlerësin përkatës **-o/j**.

Siç po shihet, të dyja trajtat foljore të shqipes, **shërbej (me shërbye)** dhe **servoj (me servue)** kanë të bëjnë me të njëjtin etimon, d.m.th. lidhen me trajtën: *serv-* /*servire* të latinishtes, përkatësisht tash **servir** të frëngjishtes që është përftimi i tretë, huazim transfer). Sigurisht nevoja ka diktuar që në gjuhën tonë kjo fjalë e huazuar të dalë dy formash paralele si një trajtë e vjetër folja: **shërbej (me shërbye)** dhe si trajtë e re: **servoj (me servue)**. Dhe që të dyja trajtat gjeten shtrirje përdorimi në gjuhën tone, për koncepte të ndryshme. Prandaj shtrohet pyetja si u shpif dhe pse, tranferisht trajta *servir (me servirë)*, përshtatshmëria e të cilës po diskutohet prej nesh. Po diskutohet, sepse momentalisht dalin konkurrencte ndaj njëra trjetrës për të njëjtin koncept këto dy trajta: **servoj** dhe **servir**. Për ta fituar konkurrencën në këtë rivalitet, gjasa më të mëdha, sipas nesh janë në anën e trajtës **servoj**, edhe pse trajta *servir*, del e shënuar në ndonjë fjalor si dhe e pëdorur në shkrime më fort gazetareske.

Ja përse, ne shohim përparësi te trajta **servoj**:

1) Në gjuhën tonë jo vetëm që nuk kemi folje me prapashtesën -ir, po nuk kemi asnjë huazim të pranuar me -IR fundore. Trajta *servir* është një rast *i vetëm dhe i vetmuar*. Në të vërtetë, Jul Variboba, bëri porpjekje të fusë italianizmat: *partir e pendir*, *partirem* (nise) dhe *pendirem* (pendohem), të cilat nuk qëndruan madje as atje, në të folmen arbëreshe. (Shih: Sh. Demraj, *Gjuha dhe historia e saj*, Prishtinë 1989, f. 261.)

2) Rasti *servir* si fjalë shqipe nuk është i shënuar në asnjë burim normativ të gjuhës sonë, pos Fjalorit të sipërcekur, prandaj mund të konsiderohet si një trajtë që nuk parapëlqehet ose nuk ka nevojë të parapëlqehet, kur për atë koncept del trajta **servoj**.

3) Në të vërtetë, ndër ne përgjithësisht koncepti i kësaj foljeje shprehet në trajtën **servoj (me servue)**, e cila ka përdorim masiv. Sa për ilustrim po përmend këto burime:

Gaz. Rilindja, 3.IV. '85 f. 5; 14.IV. '88, 14; gaz.

Bujku, 22.VIII.'92, revista *Jeta e re* nr. 8/88, f. 1175;

Zëri, 22.VIII '92 f. 14 e 26 etj.

Ç'është e drejta, siç u cek më sipër, trajta **servoj** si huazim hibrid ka mbështetje në modelin e pranuar të strukturës foljeformuese të shqipes letrare dhe pikërisht për hir të modelit ka gjasa më të sigurta që nga masa të parapëlqehet më shumë kundrejt trajtës *servir*.

4) Në gjuhën shqipe nuk kemi folje të parme, madje as të prejardhur me fundoren a prapashtesën **-ir**, pos disa rasteve , si të themi, të vetmuara, si shtir/em, ir/em, ndir/em (si vetvetore) dhe formimet me konversion: dëlir e tumir (dë+lir nga *i lirë* dhe tu+mir nga *i mirë*), raste këto me strukturë heterogjene dhe paksa të errësuar fjalëformuese, të cilat gjithsesi nuk paraqesin kurrfarë modeli foljeformues.

Më duket se këta katër argumenta mjaftojnë që edhe adhuruesit (gazetarët frankofilë) më të flaktë të trajtës *servir*, jo vetëm të shprehin rezervë ndaj qëndrueshmërisë së saj, por edhe ta nxjerrin jashtë përdorimit. Është gjë e natyshme që një fjalë të mos ketë jetë të gjatë përdorimi, sado atraktive të jetë ajo fillimisht, kur krijohet në kundërshtim me natyrën e gjuhës përkatëse dhe kur për të nuk paraqitet nevojë e domosdoshme.

Gjithsesi, trajta *servir* si një **trasfer i vetmuar** ka më pak gjasa të qëndrojë në krahasim me trajtën **servoj (me servue)**, kur kemi parasysh përparësitë që u sollëm më sipër.

Foljen **servoj** e ushqejnë edhe prejppjesorët, siç është shprehja **servim** në tenis e pingpong, apo jo? Madje edhe fjalët e huazuara mbi këtë bazë, si: servilimi, servituda, madje as fjala **servis servisimi** etj, nuk e ka mbështetje trajtën *servir*, por rrënjën **serv-**, apo jo?!

Sidoqoftë, me këtë paraqitje nuk vihet fare në diskutim qëndrueshmëria e foljes **shërbej (me shërbye)** dhe favorizimi i saj për kuptimin leksikor që ka, por këtu patëm për qëllim të vëmë në pah faktin se trajta **servoj** është më e përligjur në aspektin fjalëformues në krahasim me transferin *servir*, i cili pa lënë keq asgjë mund të nxirret jashtë përdorimit si fjalë e huaj.

11. TERMAT PUNISHTE DHE KANTIER NË RAPORT ME KUPTIMIN LEKSIKOR TË TERMAVE RADILIŠTE DHE GRADILIŠTE TË GJUHËS SERBOKROATE

Kuptimi leksikor i termit punishte, sipas FGJSSH 1954 është: "*ngrehinë ku kryhen punë industriale*", kurse në FGJSSH 1980 është dhënë një përcaktim më i plotë "*Ndërmarrje e vogël për prodhimin e sendeve për përdorim të gjerë; repart i vogël pune pranë një uzine a kombinati ose fabrikë e vogël*", ku shihet qartë zgjerimi apo përcaktimi më i mirë i kuptimit të këtij termi, i cili, në të vërtetë, sidomos në Kosovë nuk është përdorur dhe as që po përdoret sipas përkufizimit të dhënë, në FGJSSH 1980, kur kemi parasysh se termi *punishte* po përdoret vazhdimisht si barsvlerës i termit *radilište*, madje edhe *gradilište* të gjuhës serbokroate.

Po të analizojmë në hollësi përkufizimin apo përkufizimet për termin **punishte** mund të themi me plot gojën se ky term më shumë ka të bëjë me **radionica**, përkatësisht (**mala**) **fabrika** se sa me *radilište* e aq më tepër me *gradilište*.

Së këndejmi, p.sh., përkufizimi i parë "një ndërmarrje e vogël për prodhimin e sendeve për përdorim të gjerë" në serbokroatisht mund të përkthehet "malo preduzeqe za proizvodnju robe široke potrošnje", ndërsa përkufizimi tjetër vazhdues: "repart i vogël pune pranë një kombinati apo uzine ose fabrikë e vogël" në serbokroatisht kuptohet si një "**pogon**, **radionica**, odnosno **posebno odeljenje** pri kombinatu odnosno fabrike, ili mala fabrika" e që nga kjo rezulton se kuptimi i termit **punishte** si barsvlerës i termit **radilište** jo vetëm vihet nën pikëpyetje, por, pothuaj, nuk qëndron tërësisht.

Në të vërtetë, kuptimi leksikor i termit **radilište**, sipas *Fjalorit të gjuhës letrare serbokroate*, Novi Sad 1976 është "mesto gde se nešto radi,

izradjuje - gradilište", pra "vendlokalu ku punohet ose përpunohet (bëhet një send) dhe për këtë referohet termi *gradilište*, për kuptimin e të cilit do të bëjmë fjalë më poshtë, ngase pikërisht një prirje e tillë e kuptimit leksikor të këtyre dy fjalëve në gjuhën serbokroate bën që këta dy terma me kuptim të përafërt të këmbehen njëri me tjetrin.

Krahaso shembujt në disa gjuhë:

a) serbokroatisht: *radilište*,
it. *lougho di lavoro*
frëngj. *chantier, leeu de travail*;
shq. *punishte; vend-punishtë*.

b) serbokroatisht: *gradilište*:
fr. *shantier de construction, terrain à baâtir*;
rus. *strojka*;
it. *cantiere*
shq. *shesh ndërtimi, kantier*.

Ç'është e vërteta, termin *radilište* e hasim të përkthyer në shqip me përgjegjësen *punishte* në Fjalorin e Sokol Dobroshit si dhe në Fjalorin serbokroatisht - shqip të IA (1974), ndërsa fjalën *punishte* në serbokroatishte Mikel Ndreca (1976) e përktheu: *radionica; gradilište*.

Në Fjalorin shqip - serbokroatisht të IA (1981) për fjalën *punishte* jepen në serbokroatisht barasvlerësit: *radilište* (që nuk e kishte M. Ndreca) dhe *radionica*. Aty jepet edhe shembulli: *punishte e metaleve - radionica metala*, por edhe këtu në rend të parë jepet përparësi termit **radilište**. Ndoshta për një barsvlerësi kuptimore të tillë këtu ka ndikuar pikërisht elementi fjalëformues prapashtesor njëformësh i këtyre dy fjalëve.

Krahaso:

- shqip: tema + pun(ë) + prapashtesa **-ishte** - *punishte*,
- serbokr.: tema *rad/il* + prapashtesa **-ište** - *radilište*.

Pra për nga forma e jashtme fjalëformuese ka ngjashmëri, sidomos prapashtesa - *ishte/ište* (që i referohet në njëfarë mënyre ilirishtes *-(e)ist(e)*), por në thelb kuptimet leksikore nuk përkojnë ndërmjet termave të tillë.

Ç'është e vërteta, siç mund të konkludohet, nga sa u tha më lartë, për termin **punishte** të gjuhës sonë në serbokroatishte duhet të qëndrojnë përgjegjëset: **(malo)preduze_e, (mini)fabrika, radionica, pogon** si dhe **radilište**, në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale.

U tha se në gjuhën serbokroate termi **radilište** dhe **gradilište** kanë afërsi kuptimi dhe referohen njëri për tjetrin, kurse në gjuhën shqipe termi **punishte** dhe termi **kantier** nuk përkojnë, përkatësisht nuk kanë afërsi të kuptimit leksikor në mes të tyre, dallim ky që vërtetohet edhe sipas FGJSSH-së 1980, siç do ta ilustruonim më fill.

Kështu me termin **kantier** (it. cantiere, cantir; fr. chantier) në gjuhën e sotme shqipe kuptohet një "*vend a shesh zakonisht i rrethuar, ku janë grumbulluar materiale e pajisje të ndryshme dhe ku punohet për ndërtimin e një fabrike, të një hidrocentrali etj.*" përkatësisht të një objekti ekonomik, shoqëror a industrial dhe për këtë në gjuhën serbokroate përdoret termi **gradilište** "mesto gde se nešto radi, podizhe" (vendi a sheshi ku diçka ndërtohet, ngrihet), që me të drejtë nga Sokol Dobroski fjala "gradilište" është përkthyer si "shesh ndërtimesh" apo edhe "kantier ndërtimesh", sipas Fjalorit serbokroatisht - shqip të IA (1974).

Mikel Ndreca edhe për **punishte** edhe për **kantier** në serbokroatishte jep përgjegjësen: gradilište. Ndërsa në Fjalorin shqip-serbokroatisht të IA 1981 për fjalën **kantier** në serbokroatishte jepen fjalët: **gradilište, radilište**, që duket si një zgjidhje shumë me vend.

Sidoqoftë, për zëvendësimin e termit **kantier** me **punishte**, siç është propozuar nga autorë kosovarë si p.sh. Murat Bejta (Rilindja dt. 31.I.1981) e që bien në kundërtënie me Fjalorin e tij frëngjisht - shqip, Prishtinë 1978, ku referon kantier - punëtori, dhe për atelje - punishte), nuk më duket me vend. Po këtë vërejtje e japim lidhur me zgjidhjen që jep Mikel Ndreca në Fjalorin e tij shqip - serbokroatisht, Prishtinë, 1976 apo siç po veprohet rëndomë në shtypin tonë (Kosovë) si dhe në ligjërimet e përditshme të ne.

Pra siç rezulton nga analiza e mësipërme, ma merr mendja se në kushtet e sotme të gjuhës sonë është i pakapshëm dhe i papranueshëm zëvendësimi apo ndërkëmbimi i termave në fjalë, sidomos kur kemi parasysh kuptimet e këtyre termave në gjuhës e sotme letrare shqipe, sipas FGJSSH 1980 si dhe qëllimin parimor që del në gjuhën tonë lidhur me njësimin e kuptimeve leksikore edhe të terminologjisë tekniko - shkencore.

Më ka rënë në sy, përpos togfjalëshave: *shesh ndërtimesh*, shesh a vend punimi, edhe kompozita *vendpunishte* për zëvendësimin e termit *kantier*, që në kontekste të ndryshme është krijuar mbase i qëlluar, gjithsesi

jo i qortueshëm, sidomos kur kemi të bëjmë me ngjyime stilistike, përndryshe termi **punishte (më drejt punishtë)** dhe termi **kantier** nuk janë sinonime, andaj duhet të përdoren me dallime sipas kuptimeve leksikore që kanë. Gjithsesi drejtshkrimi e pragmatikisht më e parapëlqyeshme dhe më me të ardhme del trajta **punishtë punishta punishtat** ndaj asaj **punishte punishtja punishtet**.

12. AUTOFIÇINË APO AUTOSERVIS?

Në kuadër të çështjeve problemore të emërtimeve të ndërmarrjeve, përkatësisht të reparteve të punës është edhe çështja e termit **autoofiçinë**, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin e termit **ofiçinë, punëtori mekanike**.

Me termin **autoofiçinë** në gjuhën shqipe emërtohet një **punëtori mekanike** për ndreqjen e automjeteve, qoftë në kuadër të **autoparkut**, qoftë edhe si **repart më vete** me përkufizimin, sipas FGJSSH 1980: "*vend ku mbahen edhe ndreqen automjetet*", po kështu quhet edhe "**ofiçina e vendosur në një automjet**" e destinuar për kryerjen e shërbimeve e të riparimeve të përhershme në rast nevojë të mjeteve transportuese qarkulluese në ndonjë vijë rrugore.

Për këtë në gjuhë të tjera dhe në atë serbokroatishte përdoret termi **autoservis**. Sigurisht nën ndikimin e vazhdën e kësaj në Kosovë punëtoritë e tilla i kemi të emërtuara si **autoservise**.

Termi **autoservis** është ndërkombëtarizëm (krah.: auto - utomobil, automjet dhe fr. service - shërbim) me të cilin, sipas Klaiçit, emërtohet një "ndërmarrje a stacion ku bëhet ndreqja, pastrimi si dhe furnizimi i automobilave me mjetet e nevojshme". E ngjashme me këtë në Shqipëri ekziston **SMT-ja** (Stacion makinash e traktorësh), që është një "*qendër e posaçme e pajisur me mjetet e duhura për të kryer një punë a një shërbim*", pra edhe këtu kryhen punë autoofiçinore, si riparim - shërbime etj. Gjithsesi termi **autoservis** është barasvlerës i termit **autoofiçinë**.

Pasi që termi **autoservis**, ka përhapje të gjerë në gjuhët evropiane lidhur me këtë lind pyetja si do të mund t'u bëjë ballë presioneve të gjuhëve tjera termi **autoofiçinë** në gjuhën shqipe, kur edhe në italishte për këtë koncept kemi termin **autoservizio**, e dihet se fjala **ofiçinë** në shqipe është marrë si huazim nga gjuha italiane. Kjo është njëra nga arsyet që këtë barasvlerësi e quajtmë çështje të hapur në gjuhën tonë, ngase ashtu edhe na imponohet, pasi, siç u tha, në Kosovë emërtimet e tilla i kemi të shënuara si servise, apo **autoservise**, kështu rekomandohet edhe në Fjalorin shqip - serbokroatisht të IA, Pr. 1981, por megjithatë duhet ditur se në gjuhën e sotme letrare shqipe termi i tillë quhet edhe **autoofiçinë**.

Sidoqoftë, edhe kjo çështje duhet të gjejë zgjidhje sa më të përshtatshme në kuadër të harmonizimit të terminologjisë tekniko-shkencore në gjuhën shqipe.

Por para se të analizoj kuptimin e termit **punëtori**, si repart pune, e shoh të arsyeshme të cek se termi **mehaniçarska radionica**, si **punëtori mekanike**, përkatësisht **oficinë** edhe pse ka kuptim më të ngushtë se termi **radionica**, njëherazi ka edhe kuptim më të gjerë përgjithësues në raport me termat që po përdoren në jetën e përditshme te ne (Kosovë), me përhapje semantike më të kufizuar si p.sh.: **mehanika** (mekanika), **remont** (rimont). **autoservis** e ndonjë term tjetër sipas dyqaneve a punëtorive private (privatnim radnjama), sipas riparim - shërbimeve që kryhen p.sh. **radio - servis**, **tekno - servis**, **TV-servis** etj. e që reparte të tilla ka edhe në ndërmarrje (apo mund të jenë edhe ndërmarrje më vete) e që këto nocione nuk janë të pranishme në FGJSSH 1980, për shkak dallimi të sistemit të caktuar ekonomik dhe pothuajse të gjithë këta terma në mënyrë të përgjithshme përfaqësohen ose mbulohen me termin **oficinë**, përkatësisht me modifikimet: *autooficinë, oficinë riparim - shërbimi* etj.

U cek më sipër se termi **punëtori** në gjuhën shqipe në Kosovë ka kuptim më të gjerë se termi **oficinë**. Ç'është e vërteta, koncepti i fjalës **punëtori** përfshin në kuadër të vet edhe kuptimin leksikor të termit **oficina**, i cili së paku në stilin zyrtar pothuajse te ne nuk përdoret.

Në të vërtetë, këta dy terma **punëtori** dhe **oficinë** (si punëtori mekanike) duhet të bashkëpërdoren në mbarë shqipen. Termi **punëtori** duhet të fitojë zgjerim kuptimi, jo vetëm të përfaqësojë një "repart pune në një ndërmarrje prodhimi" (sipas FGJSSH 1980), por të marrë edhe kuptimin e termit **oficinë**, përkatësisht të bashkëjetojë si sinonim për **repartet e riparim-shërbimeve**. Madje në fjalorin normativ fjala **punëtori** mund t'i referohet fjalës oficinë, e jo fjalës punishtë, siç është në FGJSSH.

U tha se termi punëtori në Kosovë po përdoret si ekuivalent i termit radionica të gjuhës serbokroate, por a mund ta zëvendësojë atë më të gjitha situatat, ma merr mendja se jo. Varësisht nga konteksti termi *radionica* në gjuhën shqipe mund të mbulohet me termat:

*punëtori; oficinë; punishtë; repart pune;
laborator; atelje; dyqan etj.*

Kjo tregon për kuptimin përgjithësues që ka ky term në gjuhën serbokroate. Sa për ilustrim dhe për të përforcuar këtë fakt po përmend se për të gjitha këta terma të gjuhës gjermane:

Werk, Werkstatt, Arbeitsansalt, Arbeitstube, Botreibransalage,

e ndonjë tjetër, në ndonjërin nga kuptimet polisemike të tyre në gjuhën serbokroate jepet fjala **radionica**. (Shih: Fjalorit enciklopedik gjermanisht - kroatoserbisht, Beograd 1063.)

Në të vërtetë, kuptimi leksikor i termit *radionica* në gjuhën serbokroate është "prostoriya gde se nešto izradi ili popravlja" (Reçnik srpskohrvatskog knjizhevno jezik, N. Sad 19876) që do të thotë: **vend lokal ku punohet (përpunohet, fabrikohet, bëhet, kryhet, prodhohet) a ndreqet një send**", pra përkufizim i gjerë përgjithësues, por në gjuhën shqipe, siç u tha, si barasvlerës më i afërt është termi **punëtori** "vend-lokal ku punohet diçka" si **oficinë** a si **punëtori mekanike**: "vend-lokal ku ndreqet diçka", d.m.th. punëtorja ka nocion më të gjerë se *oficinë* ose *punëtori mekanike*.

Për të pasur një ide edhe më të qartë lidhur me përkufizimin e termave **oficinë** dhe **punëtori** po jap shembujt e mëposhtëm që i përgjigjen ekskluzivisht kuptimit leksikor të termit **oficinë** në gjuhën shqipe:

gjermanisht: Reparatur Werkstatt;
anglisht: repair shop;
frengjisht: atelier de reparations;
italisht: officina di riparazioni;
serbokroat.: radionica za opravke, dhe
shqip: oficinë (punëtori riparimi)

Pra edhe këtu termi *oficinë* del në kuadër të termit punëtori, me kuptim më të kufizuar, pra si *punëtori riparim-shërbimi*.

Fjala **punëtori** u krijua nga rrënja *punë-*, përkatësisht tema *punëtor-* dhe prapashtesa *-i*, për të treguar një *repart pune*, ku kuptohen edhe punëtorët që kryejnë punë aty. Siç dihet në gjuhën tonë kemi fjalën homonimike *punëtori*, që është emër kolektiv, dhe është krijuar më herët se kjo, me të cilën kuptohet "tërësia e punëtorëve a klasa punëtore", madje një fjalë e tillë është e favorizuar nga fjalorët përkatës, që nga Fjalori i Bashkimit 1908 dhe tek të gjithë fjalorët e mëpastajmë. E kemi dhe në FGJSSH 1980, ku i jepet kuptimi i parë. Në të vërtetë, që të dyja format e krijimit kanë gjedhe p.sh. punëtori, katundari etj. si emra kolektivë, kurse **sekretari, drejtori, punëtori, axhusteri**, etj. kuptohen si zyre a reparte pune.

Mënyra si dhe mjetet e formimit janë të njëjta, por nuk është i njëjtë motivi, nevoja, arsyeja dhe as koncepti që emërtojnë këta terma.

Krijimi i termit të dytë, **punëtori** si *repart pune*, u bë në ato situata, ku fjala **punëtori**, si tërësi e punëtorëve nuk paraqiste pengesë, pasi që ajo u zëvendësua me fjalët: punëtorët (me kuptim të ri cilësor), klasa punëtores, punuesit, punonjësit, njerëzit punues (në Kosovë), pastaj punëtorët si persona fizikë, juridikë etj. dhe kështu, sidomos në kohën tonë, kjo homonimi nuk paraqitet e fortë dhe nuk lë shteg dykuptimësie, megjithatë mendoj se në të ardhmen termi **punëtori**, si **repart pune**, në strukturën polisemike duhet të zërë vendin e parë duke e detyruar fjalën *punëtori*, si tërësi punëtorësh, të kalojë në kuptimësi jo parësore, madje mund të kalojë mbase edhe në fondin e shtresës jo aq aktive të leksikut tonë.

Sa për kërshtëri dhe për të treguar ndryshueshmërinë kuptimore të fjalës që mund të pësojë në rrethana të caktuara po e përmend faktin se fjala **punëtori**, po me këtë përbërje fonetike-morfologjike dhe po në këtë kategori leksiko-gramatikore haset edhe në Fjalorin e Kristoforidhit, që para shekullit të kaluar, por jo me kuptimet që u cekën këtu, por me kuptimin nga fusha e financave, përkatësisht si term me të cilin emërtohej "paga e punëtorit, mëditja", pra *punëtori* quhej paga që merrte punëtori për një ditë pune.

Termi **punëtori**, si *repart pune*, siç po trajtohet këtu, pati dhe ka përhapje të gjerë te ne, por nuk e hasim në fjalorët që u botuan në Kosovë. Nuk është as në Fjalorin Sokol Dobroshit (1953) as në Fjalorin terminologjik serbokroatisht - shqip (1961). Atë për të parën herë e hasim në fjalorin rusisht - shqip, Moskë 1954 për fjalën ruse **masterskaja**, pastaj e hasim në Fjalorin anglisht - shqip të Mann-it, Kembrixh, 1957 për fjalën angleze **workshop** si dhe për fjalën **manufactory**. Në Fjalorin serbokroatisht - shqip të IA 1974, për fjalën **radionica**, të gjuhës serbokroate në shqip jepen përgjegjëset: *oficinë, punëtori, punishte (mekanike); atelje*. Mikel Ndreca në Fjalorin e tij shqip - serbokroatisht (1957) për fjalën **punëtori** jep në serbokroatisht vetëm përgjegjësen barasvlerëse **radionica**, pa shtuar asnjë sinonim, po kështu është edhe në Fjalorin shqip - serbokroatisht të IA (1981), në serbokroatisht jepen përgjegjësjë e fjalës **punëtori: radionica**, përkatësisht **delaonica**. Edhe nga dy shembujt e fundit mund të nxirret konkluzioni se në Kosovë rekomandohet termi **punëtori** si ekuivalent i plotë i termit **radionica**.

Nga sa u shtrua më lartë si përfundim dëshiroj të nxirret si i drejtë mendimi që kuptimi leksikor i termit **punëtori** në raport me kuptimin leksikor të termit **oficinë** duhet të përforcohet, të shtrihet përdorimi i tij i sforcuar edhe në Shqipëri dhe njëherit edhe termi **oficinë** të përdoret në Kosovë, sipas kuptimit përkatës në të gjitha stilet.

4. RRETH TERMIT KAMIONETË

Për t'u orientuar drejt në këtë analizim, mendoj se duhet nisur nga koncepti i përgjithshëm i automjeteve në gjuhë të huaja dhe në gjuhën shqipe për të kaluar tek të veçantat përkatëse. Dihet se koncepti i parë i automjeteve si term ndërkombëtar në gjuhën tone është reflektuar me fjalën automobil-i automobila-t (gr. auto – vetë + lat. mobilis – vetëlëvizës) – *automjet me formë e madhësi të ndryshme, që shërben për mbartjen e udhëtarëve dhe të mallrave*. Ndërkohë automjetet për mbartjen e udhëtarëve, zakonisht me karroceri të mbuluara u quajtën **vetura**, **autobusa**, **limuzina** etj, me emërtime të specifikuara, ndërkaq automjetet për mbartjen e mallrave zakonisht me karroceri të hapur u quajtën, **kamiona**, **kamioneta** etj.

Së këndejmi, në gjuhën serbokroate në kuadër të emërtimeve të automjeteve për mbartjen e mallrave përdoret edhe termi **dostavno vozilo** ose **dostavna kola**, me të cilin kuptohet një automobil, përkatësisht një kamion i vogël me karroceri të hapur me të cilin bëhet zakonisht mbartja e mallrave dhe sendeve të ndryshme dhe se për një nocion të tillë në gjuhën tonë mungon termi a barasvlerësi i caktuar adekuat i kristalizuar. Me një barasvlerësi të tillë ne jemi ballafaquar kaherë e jo vetëm tashti kur është aktualizuar çështja, kur bëhet fjalë për themelimi e një uzine të këtyre automjeteve te ne në kuadër të firmës "Crvena Zastava" të Kragujevcit, kështu që në realitetin tonë gjuhësor këtë term e hasim "*të zgjidhur*" në disa trajta si p.sh. **automjet dorëzues** (në tabelat e shenjave të komunikacionit te ne), **automjet ekspedues** (në dokumentacionin rreth elaboratit të caktuar), **automjet furnizimi** (në praktikën e disa OPB), **automjet shpedicioni** (gazeta "Rilindja", dt. 28,29,3/. XI.1985, f.11) etj. Kështu pra në të gjitha rastet e mësipërme, në të vërtetë, është "*përkthyer*" togfjalëshi **dostavno vozilo** i gjuhës serbokroate po me togfjalësh të ndryshëm në gjuhën tonë.

Në krahasim me disa gjuhë të tjera më të zhvilluara termi i konceptit në shqyrtim del kështu:

serbokr..dostavno vozilo, përkatësisht dostavna kola

angl. pickup truck ose light lorry;
gjerm. Kleinlastwagen;
fr. camionette,
it. cammionetta, camioncino;
shp. kamionetë,

kështu që edhe te ne kemi ndonjë rast reflektimi nga këto gjuhë p.sh. "pik ap" në gazetën "Rilindja" dt. 30. IX. 1985 (nga pick up e anglishtes), pastaj kamionçino/ nga italishtja kamioncino / (Kokona FFSH, f.44; FSHS 1981 f.404); por edhe **kamionetë**/ nga frëngjishtja por edhe nga it. cammionetta / (M. Bejta FFSH f.89).

Duke pasur parasysh se fjala *kamionet(a)* (sipas trajtës frënge) është përfshirë edhe në fjalorin e gjuhës letrare të serbokroatishtes me sqarimin "manji kamion /kamion i vogël/ (RSHKJ 2 f.645) si dhe në fjalorin e termave teknike "Reçnik tehničkih izraza" (Beograd 1971, f.157) ashtu si dhe në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare me sqarimin "lako teretno motorno vozilo, mali kamion" / automjet i lehtë mbartës motorik, kamion i vogël/ (RSRI f.353) si dhe "mali kamion, kamionçina_"/kamion i vogël, kamionth/ VRSR f.612), atëherë prej fjalëve të huaja, për realitetin tonë gjuhësor, për mendimin tim, del më e kapshme trajta **kamionetë** që na rekomandohet nga Fjalori frëngjisht - shqip i Murat Bejtës, përkatësisht edhe nga fakti se trajtën më *-etë* (etta) fundore e kemi tashmë të pranuar edhe në disa fjalë të tjera me origjinë italiane si **bicikletë, biletë, piketë, kuletë** etj. Dhe që përshtat si barasvlerës trajta italiane **cammionetta** me **dostavna kola** të serbokroatishtes sjellim si provë fjalorin italisht - kroatoserbisht të Jernejit (THSR f.132), ku për camioncino (kamionçino) jepet vetëm barasvlerësi "mali kamion" /kamion i vogël, kurse për cammionetta (kamioneta) "mali teretnjak, dostavna kola" /kamion i vogël, kamionetë/ (Po aty f. 132), ndërsa për "vetura utilitaria" jepet barsvlerësi "ekonomiçna kola", d.m.th. "automjet ekonomik", që ka kuptim diçka më të përgjithësuar se sa fjala kamionetë.

Edhe në fjalorin spanjisht - serbokroatisht për camioneta është dhënë barasvlerësi "dostavna kola, kamionet" (ŠSHR f.60). Mikel Ndreca në fjalorin e tij të fjalëve ndërkombëtare (FFSHH, f. 368) fjalën **kamionetë** e shënon me prejardhje edhe frënge edhe italiane(!), prandaj në mbështetje të të dhënave të mësipërme mund të konstatojmë se edhe në gjuhën serbokroate nuk gabohet, nëse për *dostavna kola* apo *dostvno vozilo* të përdoret trajta **kamionet(a)**, por kjo nuk është çështje për ne, mirëpo së këtejmi, me sa paraqitëm, mund të shërbejë si mbështetje që edhe në gjuhën

tonë mund të rekomandohet termi **kamionetë** si barasvlerës për termin togfjalësh **dostavno vozilo** ose **dostavna kola** të serbokroatishtes.

Përveç trajtës **kamionetë**, e cila del më e vetëmjaftueshme për të shprehur autencitetin e përmbajtjes në shqyrtim, në gjuhën tonë mund të dalë edhe trajta **kamionth**, nëse duam të aktivizojmë prapashtesën zvogëluese të gjuhës sonë -th. Një trajtë e tillë gjen sqarim dhe mund të arsyetohet në bazë të strukturës fjalëformuese të gjuhës sonë, ngase fjalën **kamion** me të cilën kuptojmë "një automobil të madh me karroceri të hapur që shërben për të mbartur sende të rënda, mallra ose forca ushtarake", e kemi si fjalë aktive të fjalësit të gjuhës sonë letrare, atëherë duke ia shtuar prapashtesën zvogëluese -th formojmë fjalën e re kamionth, me të cilën do të kuptonim "një automobil të vogël për mbartjen e mallrave, përkatësisht "një kamion i vogël transporti". (FFSH f.89.) Në të vërtetë ashtu siç e ka funksionin zvogëlues prapashtesa -th në gjuhën shqipe, ashtu në gjuhët romane, në kontekste të caktuara e ka prapashtesa -etta. Krahaso edhe në serbokroatishite funksionin e prapashtesës -çiç: kamionçiç.

Për rastin tonë në shqyrtim duke i pasur parasysht disa rrethana, mendoj se më e parapëlqyeshme del trajta **kamionetë**, por si sinonim mund të qëndrojë trajta **kamionth** si bashkëkonkurrente, madje në stile të caktuara përdorimi i të dyja trajtave është i paqortueshëm dhe mund të arsyetohet.

Mirëpo, me zhvillimin e tregut dolën të nevojshëm që i njëjti automjet të modifikohet dhe të shërbejë edhe për mbartjen e udhëtarëve edhe për mbartjen e mallrave. Dhe pikërisht tema jonë ka të bëjë për një automjet të tillë që në serbishte quhet **dostavno -putničko vozilo**.

Kur është fjala për "**dostavno-putničko vozilo**" atëherë në gjuhën tonë mund të qëndrojë barasvlerësi **veturë - kamionetë** ose **veturë - kamionth**, apo jo?!, ngase me veturë kuptohet :

"një automjet i vogël udhëtimi" (FGJSSH f. 2151),

kurse me **kamionetë** a **kamionth** (nga rrënjori *kamion-*) siç u cek më sipër :

"një kamion i vogël për mbartjen e mallrave"

dhe se këtu është fjala për një tip të veçantë automjeti si me thënë, njëherazi gjysmëveturë - gjysmëkamionetë.

Me këtë paraqitje ne jo vetëm që kemi ambicie për gjetjen e trajtës më të parapëlqyer, e cila do të gjejë shtrirje në mbarë truallin e shqipës, por edhe të kërkojmë ndihmë e përkrahje në mënyrë që zgjidhja të jetë sa më e drejtë dhe e qëndrueshme, zgjidhje kjo që po na imponohet, ngase me sa dimë, është përgatitur elaborati në gjuhën serbokroate me tërë dokumentacionin e caktuar përcjellës teknik për themelimin e një uzine të

kamionetave apo të veturë - kamionetave (fabrika putničkih dostavnih vozila, të cilën do ta ndihmojë ose themelojë firma "Crvena Zastava" e Kragujevcit. Prandaj, kur është fjala për "pagëzimin" a emërtimin e organizatës së caktuar të punës së bashkuar në themelim mendoj se në shqipe duhet miratuar emërtimin: Uzina e veturë-kamionetave e jo Fabrika (...), sepse na është i njohur fakti se në gjuhën tonë ndërmarrjet metalpunuese, përkatësisht ndërmarrjet metalpërpunuese ku prodhohen (montohen) automjete apo ku prodhohen pjesë të automobilave ose pjesë të vogla teknike e të punës quhen **uzina** e jo fabrika. Kjo na rekomandohet sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe e po kështu edhe nga Fjalori shqip-serbokroatisht, IA, Prishtinë 1981, f.64.

Gjithsesi është e nevojshme që në fjalorët tanë përkatës të përfshihet edhe termi **kamionetë (kamionth)** për barasvlerësit e gjuhës serbokroate: **kamionet(a) /kamionçiç**, përkatësisht **dostavna kola** ose **dostavno vozilo**, ndërkaq për **Fabrika putničkih dostavnih kola** të qëndrojnë barasvlerësi **Uzina e veturë-kamionetave**.

Ndërkohë, kemi marrë vesh se në Shqipëri, sidomos kohëve të fundit për konceptin karro e vogël transporti është përhapur fjalë-termi *furgon*, po nga frëngjishtja *fourgone* dhe vërtet kjo na çudit, ngase në frëngjishte kuptimi parësor i kësaj fjale është: vagon mallrash, vagon i mbyllur për mallra (transporti), ndërkaq në realitet në Shqipëri furgon furgona po quhen paksa me ndryshim ose zgjerim kuptimi, automjete për bartjen e pasagjerëve, që te ne quhen **kombi-busa** ose mini-busa, autubusa të vegjël.

Sidoqoftë, unë mendoj se termi barasvlerës më i qëndrueshëm për termin Fabrika **putničkih-dostavnia vozila** në shqipe është: **Uzina e veturë-kamionetave**.

(Prishtinë, 5.II.1986)

15. RRETH SHUMËKUPTIMËSISË SË ANTONIMEVE KYÇJE /SHKYÇJE NË RAPORT ME BARASVLERËSIT E GJUHËS SERBOKROATE

Shumëkuptimësia (polisemia) si një dukuri gjuhësore me të cilën kuptohet: *aftësia e fjalëve për të pasur më shumë se një kuptimë* (FGJSSH f. 1514.) është një ndër mënyrat më produktive për zgjerimin e korpusit të leksikut edhe në gjuhën tonë, e cila në të vërtetë cilësohet si një zgjidhje mjaft ekonomike, pasi që një fjale të njohur për nga ana shqiptimore (tingullore) dhe shkrimore (grafike) i jepet një kuptim i ri i prejardhur, natyrisht i ndërlidhur në njëfarë mënyre me kuptimin kryesor a fillestar të fjalës së caktuar, duke i plotësuar kështu nevojat që dalin për të shprehur koncepte të reja e të nuancuara në fusha të caktuara semantike, mirëpo edhe në këtë rrugë duhet ecur me kujdes, përkatësisht duhet vepruar me maturi e me kriter, në mënyrë që të mos bëhet shkelje të natyrës së gjuhës. Me fjalë të tjera mos të krijohen hominimi të vrazhda a krijime të palogjikshme, siç ka ndodhur me rastin e antonimit **kyçje/shkyqje** që në rrethe të caktuara ndër ne, sigurisht, është përftuar nën ndikimin e gjuhës serbokroate a në raport me barasvlerësit përkatës të asaj gjuhe.

Ç’është e vërteta, në asnjërin nga fjalorët përkatës të gjuhës sonë kjo çështje nuk është qartësuar e saktësuar plotësisht, prandaj e pashë të udhës të vë në spikamë ta trajtoj, ngase paraqitete si jo pak problemore.

Është e ditur se nga emri **kyç kyçi** “*mjet prej metali që varet në dy hallka dhe që shërben për të mbajtur mbyllur një derë, një dollap, një arkë etj.*” (FGJSSH, 932.) dhe nga ky emër me konversion, duke ndërruar kategorinë leksiko-gramatikore, doli folja **kyç (me kyçë)** dhe antonimi **shkyç (me shkyçë)** e së këndejmi emri prejfoljor **kyçje** përkatësisht **shkyçje**.

Kuptimi fillestar i të dyja trajtave **kyçje/shkyçje** ka të bëjë me mbylljen ose hapjen e drynit (kyçit) të një dere etj., por më i ndjeshëm është

përdorimi i tyre në terminologjinë e elektroteknikës (Shih: Fjalori i terminologjise tekniko-shkencore (9) Terminologjia elektro-teknike (rib.), Beograd 1970, f 18 dhe 62) që ka të bëjë me lëshimin dhe ndërprerjen e rrymës, përkatësisht me hapjen ose mbylljen e qarkut elektrik.

Këto fjalë në gjuhën serbokroate kanë barasvlerësit përkatës: **zaključivanje / odključivanje** ose **uključivanje / isključivanje**, me kuptimet përkatëse të dalluara siç do të shohim më poshte, që janë emra të prejardhur nga e njëjta temë prodhuese, nga emri **-ključ-**, i cili në gjuhën tonë ka kuptimin e barasvlerësit *çelës*, përkatësisht *kyç* (ngjashëm për nga etimologjia), mirëpo problemi del se formimi i fjalëve të reja ndryshon në këto dy gjuhë, jo vetëm sa i përket strukturës fjalëformuese a fjalëndërtuese, por sa i përket fushës semantike a koncepteve që mbulojnë fjalët e tilla. Do theksuar se në gjuhën shqipe kuptimi i fjalës **kyç kyçi**, sipas fjalorit normativ përshkrues të gjuhës sonë letrare, shkon më tepër si sinonim i fjalës *dry dryni*, *kyç*, *varës* (serbokroatisht: *katanac*) sesa i fjalës *çelës çelësi* (serbokroatisht: *ključ*).

Me qëllim që të vihet në pah më mirë problemi për çka tërhiqet vëmendja në këtë trajtesë, në vazhdim po i jap disa togfjalësha në të dyja gjuhët të nxjerra nga fjalorët përkatës, përkatësisht nga realiteti ynë gjuhësor:

I. 1. *kyç derën(?)*, *mbyll derën* me *dry* (*çelës*) – *zaključati* (zatvoriti) vrata (klučem).

2. *shkyç derën (!)*, *hap drynin* e *derës* me *çelës* - *otključavati* (odbraviti) vrata.

II. 1. *kyç rrymën* (aparatin), *lëshoj rrymën*, aparatin – *uključiti* struju (aparati);

2. *shkyç* (*ndërpres*) *rrymën* (aparatin) - *isključiti* struju (aparati).

III. 1. *lëshoi* (*kyç!*) *ujin* (ujësjellësin) - *uključiti* vodu, vodovod);

2. *ndal* (*shkyç!*) *ndërpres ujin* (ujësjellësin) - *isključiti* vodu (vodovod).

IV. 1. *kyç të rinjtë (!)*, *fuqinë punëtore (!)* ose *rezervat (!)* – *uključiti* mlade, radnu snagu, rezerve;

2. *shkyq (!)* të rinjtë (!) - *isključiti* mlade.

V. 1. *shkyçe e problemit (!)* - *razrešenje* problema.

Sqarim: *shembulli me pikëpyetje (?) mund të jetë i lejshëm ose jo të qortueshëm në përdorim, ndërsa shembujt me pikëçuditëse (!) gjithsesi duhen konsideruar si lajthitje konteksti në gjuhën shqipe, madje cilësohen edhe si gabime të rënda, të patolerueshme.*

Sidoqoftë, të vihet re:

a) Te shembulli nën I., fjalët *kyçje/shkyçje* në serbokroatishte kanë për barasvlerës: **zaključati** (zatvoriti)/ **otključati** (odbraviti) që në shqipe më normalisht dalin trajtat: *mbyll /hap (derën me çelës)*.

b) Shembujt nën II. mund të thuhet se *kyçje/shkyçje* ka barasvlerësi të plotë me **uključivanje/isključçvanje** të serbokroatishtes, ndërsa

c) te shembujt nën III dhe sidomos IV. e V. **uključenje/ isključenje** nuk përkohjnë aspak me *kyçje/shkyçje* të gjuhës shqipe, prandaj **këto tri çështje të hapura** do të shkoqiten më poshtë:

1) Është e ditur se *uji (ujësjellësi) lëshohet dhe ndalet* është e kundërta e *kyçjes* (d.m.th. e *mbylljes*) dhe e *shkyçjes së rrymës*, ngase procesi i aktivizimit të rrymës dhe të ujit nuk janë të ngjashëm, kur *mbyllet qarku rryma aktivizohet*, ndërsa kur *mbyllet ventili (valvula), uji ndalet*. Këtë proces duhet pasur parasysh, në mënyrë që mos të ngatërrohen kuptimet e fjalëve, duke u shkuar pas barasvlerësve të serbokroatishtes!

2) Në stilin bisedor tek disa individëve ndër ne fjala *kyçje* dëgjohej jo rrallë si barasvlerës i fjalës *uključivanje* të serbokroatishtes që është tejet gabim, madje edhe në stilin zyrtar *politiko-shoqëror* kam pasur raste të gjejë të shkruar, deri edhe në dokumenta me vlerë a me peshë politike (fatmirësisht jo në mjetet tona të informimit) dhe një dukuri e tillë a shkarje pa vetëdije është me siguri si rezultat i *përkthimit* (nënvetëdijshtëm) nga gjuha serbokroate e fjalës *uključivanje*, nga ata që nuk e njohin zhvillimin e fjalës *kuçje* në gjuhën tonë letrare. Në të vërtetë në serbokroatishte fjala *uključivanje* nga kuptimi i parë kryesor, d.m.th. nga fusha e elektroteknikës ka kaluar edhe në stilin *politiko-shoqëror* e ekonomik, duke e zgjeruar kuptimin me përdorim normal (Shih: RSHKJ 6, f. 48).

Ja dy shembuj konkretë në të dyja gjuhët, të nxjerrë nga një raport zyrtar i OTHLK të një organizate punonjëse:

1. Da bi nash uspeh bude shto potpuniji mi moramo *uključiti* mlade - Në mënyrë që sukcesi ynë të jetë sa më i plotë ne patjetër duhet *t'i kyçim* (!) të rinjtë.

2. U postojëçim trenucima mi treba *ukljuçiti* i sredstva rezerve - Në çaste ekzistuese në duhet *t'i kyçim*(!) edhe mjetet e rezervës.

Pra, këtu s'do mend, në rastin e parë është fjala për *përfshirjen (angazhimin) e të rinjve* ose **inkuadrimin e tyre** në proceset politiko-shoqërore e jo kursesi për **kyçjen a mbylljen e të rinjve**. Gjithashtu edhe në rastin tjetër nuk kemi të bëjmë më **kyçjen a mbylljen** e mjeteve të rezervës, por për **aktivizimin (përfshirjen) e mjeteve të tilla**. Po të përkthehej teksti i tillë i shkëputur nga konteksti nga shqipja në serbokroatishte, me siguri fjala **kyçe** do të përkthej me barasvlerësin më të natyrshëm: *zatvaranje* ose *zaključavanje*, e cila siç dihet sipas Fjalorit serbokroatisht shqip 1974, f. 990 në gjuhën tonë ka këta barasvlerës: **mbyllje, mëshelje** etj. deri edhe **mbyllje me çelës, burgosje**. Pra ja në çfarë pozite të palakmueshme mund të në sjellë mosnjohja e kuptimeve polisemike të fjalëve të caktuara në gjuhët përkatëse, siç është bërë me *zgjerimin kuptimor polisemik të fjalës kyçe të shqipes*. Andaj gjithsesi duhet kuptuar e respektuar kriteri semantik me rastin e krjimit të një fjalë të re me polisemi.

Mjerisht raste të tilla nuk janë të vetmuara, sidomos në stilin e disa *zyrtarëve tanë* ose të disa individëve te ne, të cilët duket se fjasin shqip po mendojnë tjetër gjuhë(!) ose nuk e dine se çfarë po thomë në gjuhën e vet amtare. Madje edhe në shtyp patëm rastin të lexonim më në formë pyetjeje: Sa jemi të kyçur në rrjedhat shoqërore? (Shih: *Bota e re*, nr. 16-19/84, f.8). Mbase nga konteskti më i gjerë mund të zbutet keqkuptimi, por vështirësia për të kuptuar drejt mesazhin mbetet gjithnjë e pranishme, andaj lypset kujdes më i madh në të shprehurit e gjuhës shqipe që një dukuri e tillë fort e pamirë **të kyçet (të mbyllet, të shuhet)** dhe kursesi mos të përhapet.

2) Edhe shembulli *shkyçje e problemit për razreshenje problema* që mund të dëgjohet tek-tuk dhe që është e regjistruar edhe në FSHSK (1976), f. 312 dhe nuk duket se është shkarje rasti (pasi që është shënuar aty edhe si folje edhe si emër e mbiemër), andaj del çështje fort e diskutueshme, madje mund të themi edhe e paqëndrueshme. Themi kështu se vetë kuptimet kryesore që ka fjala *shkyçje* kundërshtojnë jetësimin e një kuptimi të tillë. Dihet se me fjalën *shkyçje* kujtohet, së pari, koncepti: *hap kyçin me çelës* dhe së dyti, *ndërpres kalimin e rrymës në qarkun elektrik*. Me fjalë të tjera, me **shkyçje** tregohet një veprim jo aktiv. Me fjalë të tjera *shkyçja* e aparatit ose mos veprimi i rrymës nuk mund të asocioanojë lirshëm për zgjidhjen e problemeve a të çështjeve në aspektin logjik, semantik e pragmatik, prandaj nga kjo pikëpamje nuk mund të përlligjet në aspektin e zgjerimit polisemik të fjalës *shkyçje* si barasvlerës më i përafërt i shprehjes **razreshenje problema** të serbokroatishtes. Siç dihet në gjuhën shqipe

për konceptin *razreshenje problema* si barasvlerës më i përafërt shërben shprehja **zgjidhja e problemit** ose **zgjidhje e një problemi**, siç është shënuar në të gjithë fjalorët përkatës, madje edhe në fjalorin në fjalë f. 371.

Ç'është e vërteta, në gjuhën serbokroate përdoren dy trajta togfjalëshe: **reshenje problema** dhe **razreshenje problema**, e cila del e sforcuar me parashtesën *raz-* + *reshenje*. Prandaj pikërisht ky kuptim i sforcuar ka krijuar problem në përkthim, dhe si rrjedhojë edhe është përfutur përgjegjësi i diskutueshëm për ne *shkyçja e problemit*. Mendoj se në shqipe, varësisht nga konteksti i caktuar mjafton shprehja *zgjidhja e problemit*, për të dyja trajtat e serbokroatishes, por nëse paraqitet nevojë e madhe për diferencim, më duket më e natyrshme që edhe në gjuhën tonë të krijohet një fjalë e re, *po* sipas ndërtimit të serbokroatishes, duke i vënë fjalë-temës **zgjidhje** parashtesën **për**: për + *zgjidhje* = **përzgjidhje: përzgjidhja e problemit – razrešenje problema**. Pra për *rešenje i razrešenje problema* në shqipe mund të dalë **zgjidhja dhe përzgjidhja e problemit**, gjithsesi më e kapshme se **shkyçja e problemit(!)**, ngase me fjalën *shkyçje*, do me thënë hapje (e derës), *hapje jo mbyllje* e problemit apo jo?! Por edhe më mirë se **zgjidhje e përzgjidhje** për mendimin tone, në kontekste të caktuara mundet me dalë shprehja: **zgjidhja dhe shkarkimi i një problemi**. Në të vërtetë nocioni i fjalës **razrešenje** ndryshon nga ai **rešenje**, kështu në Fjalorin e gjuhës letrare serbokroate (RSHKJ 5 f. 728) fjala **razrešenje** ka kuptimin: *osloboditi çega (lirohem (shkarkohem) nga diçka)*, përkatësisht *oslobodjenje od obaveza (shkarkimi nga ndonjë obligim)*. Ç'është e drejta, në stilin juridik, fjala *razreshenje* ka për barasvlerës në shqipe fjalën *shkarkim* (Shih: *Fjalori terminologjik juridik serbokroatisht - shqip* 1979, f. 137)

Fjala **razreshenje** në gjuhën tonë mund të ketë edhe barasvlerës të tjerë, varësisht nga konteksti, por asnjëri prej tyre nuk ka kurrfarë gjase të afrohet me konceptin e fjalës **shkyçje**. Ç'është e drejta, në njërin nga kuptimet polisemnike të fjalës *razrešiti*, del edhe *sinonimi iskljuçiti bashkë me smeniti, ukloniti s çega*, d.m.th. *përyjashtoj, ndërroj, largohem nga diçka* dhe asnjëri sinonim, po përsëris, nuk përputhet me nocionin e fjalës *shkyçje* të gjuhës sonë.

Nga sa u shtrua më sipër mund të nxjerrim këto katër përfundime:

1. Ndërsa fjala *ključ* e serbokroatishes, e cila etimologjikisht mund të jetë e një origjine me fjalën *kyç* të shqipes, nuk kanë barasvlerësi të plotë,

ngase trajta *ključ* mbulon konceptin fillestar që në shqipe shpreh fjala *çelës*, ndërsa *kyç* në shqipe më tepër ka të bëjë me fjalën *katanac* të serbokroatishtes, dhe më tepër ka sinonimi me fjalën *dry dryni* të shqipes, e cila nuk ka pësuar rotacizëm, mirëpo kur është fjala te derivatet mbi këto baza ndryshon raporti. Ndërsa fjala *ključ* është fjalë e parme, e cila shërben si temë prodhuese për formimin e foljeve dhe të prejfoljorëve në atë gjuhë (*uključiti, isključivti, priključiti, zaključiti* etj.) në shqipe fjala *çelës* është prejfoljor, nga folja *çel* (me *çelë*) *çelë/s - çelës*, antonimi mëshel me mëshelë, mëshelës. Siç po shihet emrit *çelës* nuk shërben si temë prodhuese për formimin e foljeve, siç shërben përgjegjësi **ključ** i serbokroatishtes.

2. Nga fjalë-emri **kyç** në shqipe del edhe folja **kyç me kyçë** si dhe antonimi **shkyç me shkyçë**, e së këtejmi dalin prejfoljorët: *kyçje/shkyçje*, të cilët, siç e pamë kanë barasvlerësi të plotë në fushën e elektroteknikës vetëm me *uključivanje ose uključenje/ isključivanje ose isključenje*, pa marrë parasysh faktin se në FGJSSH për *kyçje* nuk është saktësuar kuptimi edhe për fushën e elektroteknikës, siç është bërë për fjalën *shkyçje*.

3. Duhet pasur kujdes që mos të bëhen lajthitje, ngase barasvlerësia nga pika e mësipërme nuk vlen edhe për nënfusha të tjera semantike, sepse polisemia që vlen për fjalët e tilla të serbokroatishtes nuk vlen për fjalën shqipe, sepse, siç e pamë nga shembujt e mësipërm mund të rrëshqitet padashtas në gabime të rënda, me pasoja, siç edhe ka ngjarë duke u shkuar pas verbërisht krijimeve të serbokroatishtes. Gjithsesi duhet të pranohet i saktë konstatimi se në gjuhën e sotme letrare shqipe fjala *kyçje* nuk ka aftësi të jetë sinonim i fjalës *përfshirje* ose *angazhim, inkuadrim* etj., siç u pa në shembujt e mësipërm: **uključivanje mladih** jo **kyçja e të rinjve**, po *përfshirja (angazhimi, aktivizimi, inkuadrimi) i të rinjve*; **uključivanje vode (vodovoda)** jo *kyçje e ujit e ujësjellësit*, por **lëshimi i ujit, instalimi i ujësjellësit**; **uključivanje rezervnih sredstava** jo *kyçja e pjesëve të rezervës*, por: **të vënit në veprim (përfshirja) e mjeteve të rezervës** etj.

4. Për togfjalëshin **razrešenje problema** jo *shkyçja e problemit*, por **zgjidhja a përzgjidhja e problemit**, madje në kontekste të caktuara edhe **shkarkimi i problemit**.

Gjithsesi me rastin e zgjerimit të kuptimit të ndonjë fjale me polisemi, duhet të kihet parasysh natyra e gjuhës shqipe në përgjithësi, ajo letrare në veçanti, në mënyrë që fjala e re ose kuptimi i ri të mos krijojë ngatërresa kuptimore. Pra, si kriter për vlerësimin e aftësisë së fjalës së caktuar për të mbartur kuptime të reja polesemikisht duhet respektuar përveç kriterit

gramatikor (morfologjik) edhe ai i strukturës semantike e logjike të sisemit të tërësishëm gjuhësor.

Vetëm kështu mund të ndihmohet natyrshëm pasurimi i fondit lesikor të shqipes letrare dhe do t'u bëhet ledh dukurive të pamira gjuhësore te ne që si rrjedhojë e ndikimit të konstrakteve të gjuhëve të huaja, konkretisht e gjuhës serbokroate janë vënë në përdorim lajthitës trajtat **kyçje/shkyçje** te ne, sëmundje kjo që nëse nuk çrrënjohet, është drojë që do të infektojë edhe më shumë e më thellë se deri tani, jo vetëm gjuhën e administrates por edhe të stileve të tjera.

16. EDHE NJË HERË RRETH PËRDORIMIT TË FJALËS KYÇ KYÇJE TE NE

(Shkelje e vrazhdë e normës semantike)

Në një artikull të botuar në revistën *Gjuha shqipe* 3/84, me titull *Rreth shumëkuptimisë së antonimeve kyçje/shkyçje në raport me barasvlerësit e gjuhës serbokroate*, është tërhequr vërejtja për dukurinë e krijimit të homonimisë a të një krijimi të palogjikshëm, lidhur me përdorimin e fjalës **kyç kyçje** te ne, e cila nën ndikimin e fjalës **uključivanje (uključiti)** të serbokroatishtes po përdoret edhe në ato nënfusha semantike, për të cilat ekzistojnë barasvlerës të tjerë. *Fatmirësisht*, thuhej, pos tjerash, në atë artikull, *një dukuri e tillë nuk po haset në mjetet tona të informimit*, por *vetëm në stilin bisedor a zyrtar të ndonjë individi*. Tash pas kaq vitesh, mjerisht, mund të thuhet se një dukuri e tillë ka marrë përmasa shqetësuese edhe në mjetet tona të informimit, madje edhe në punime shkencore (profesionale) të ndonjë gjuhëtari albanolog me emër e me diplomë. Mjafton të përmend sa për ilustrim vetëm tre-katër shembuj të nxjerrë nga numrat e gazetës *Bujku: Ekonomia e Kosovës të kyçet në tregun ndërkombëtar* (30.V.=92, f. 1); *Kyçja në Konferencën e Hagës* (9.11. 91, f. 5); *H. kyç Shqipërinë në çështjen e Kosovës si dhe Shqipëria të kyçet në bisedime* (1.VII.1992, f.1) etj.

Njohësit e gjuhës shqipe, të cilët **nuk janë të infektuar nga barasvlerësi uključiti** (uključenje) të serbokroatishtes, siç ka ndodhur me autorët e shembujve të mësipërm, e kanë lehtë ta kuptojnë se fjala në shembujt e cekur është përdorur në vend të fjalës adekuate shqipe: *përfshij (përfshirje)*, ose *marr pjesë (pjesëmarrje a inkuadrim)*, ngase një koncept të tillë e shprehin kryekëput, secila nga këto fjalë ose të tjera sinonime, por kurrësi fjala **kyç kyçje(!!!)**. Në të vërtetë, fjala **kyç kyçje** sinonime më të përafërta ka fjalën *mbyll mbyllje* ose *mëshel mëshelje, ndryj ndryrje* (ndrymje) dhe jo fjalët *përfshij (përfshirje, me marrë pjesë, pjesëmarrje*. Po të zëvendësohej fjala kyç kyçje me sinonimin e vet *mbyll mbyllje* ose me

ndonjë tjetër, atëherë do të shihet qartë konfuzioni semantik i krijuar në konstruktet e sipërcekura.

Kuptimi i plotë leksikor i fjalës kyç kyçe më gjerësisht është shpjeguar në artikullin e cekur në fillim të atij artikulli, megjithatë, këtu do të ritheksohet vetëm fakti se pos sinonimisë pak a shumë të plotë që ka me fjalën *mbyll* (*mëshel, ndryj*) që përkon me barasvlerësit përkatës të serbokroatishtes *zatvoriti, zaključati*, kjo fjalë e ka zgjeruar kuptimin edhe në nënfushën e elektroteknikës si term për konceptin: *kyç/shkyç motorin a qarkun elektrik etj.*, sigurisht në Shqipëri nën ndikimin e barasvlerësit **ukljuçat** të rusishtes dhe ndër ne **ukljuçiti ukljuçivanje** të serbokroatishtes, siç është cekur më përpara. Në gjuhën serbokroate në situata të caktuara fjala ukljuçiti ukljuçivanje del në sinonimi dhe zëvendësohet me fjalën *obuhvatiti* (*obuhvaçenje*) në shqip *përfshij përfshirje* dhe *uçestvovati* (*uçestvovanje*) në shqip: *marr pjesë* (*pjesëmarr*) *pjesëmarrje*. Të kemi kujdes se pikërisht për këto koncepte në shqipe krijohet homonimi e vrazhdë a bëhet shkelje e normës letrare, sepse në gjuhën tonë nuk kemi sinonimi të fjalës **kyç kyçe** me gjegjësen **përfshij përfshirje** ose me **marr pjesë** a **pjesëmarr pjesëmarrje**.

Kur kemi parasysh faktin se përdorimi i fjalës *kyç kyçe* për konceptin që po kontestohet këtu, së pari bie ndesh me të gjitha burimet leksikografike dhe normative të gjuhës sonë letrare, së dyti, i sjell dëm qartësisë së të shprehurit dhe së treti, fatmirësisht një lajthitje e tillë ka shtrirje lokale të kufizuara. Përdoret vetëm nga disa individë te ne. Ma merr mendja se lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje nuk duhet angazhim aq i madh. Duhet tërhequr vërejtje shoqërore dhe si pasojë besoj se vetë autorët posa ta kuptojnë lajthitjen në fjalë do ta shtojnë kujdesin për mos përdorimin pa vend të fjalës **kyç**.

Pra, duhet shkruar jo *Të kyçet ekonomia e Kosovës në tregun evropian*, por **të përfshihet** (inkuadrohet) **ekonomia e Kosovës në tregun evropian**; jo **kyç Shqipërinë në çështjen e Kosovës**, por të ndërlihdet, ndërfitet, angazhohet, inkuadrohet) **Shqipëria në çështjen e Kosovës**; jo **Shqipëria të kyçet në bisedime**, por **Shqipëria të marrë pjesë** (të përfshihet) në bisedime; jo **Të kyçem në bisedë** (në lojë) por **të ndërlihdem, të ndërfitem në bisedë** (në lojë, në garë) etj.

Për t'u shëruar nga të pamirat si kjo duhet pasur edhe vullnet. Gjithsesi edhe redaktorët e lektorët nuk duhet të jenë imun, e aq më keq të familjarizohen me kalkëzime të tilla, vërtet të panevojshme dhe të vrazhda. Në çdo kohë dhe situata, ata me gërsherë e neshter në dorë, po

qe nevoja, duhet hequr misht e keq, i cili shëmton trupin e shëndoshë të gjuhës sonë letrare kombëtare.

Në fund, si shenjë jo të mirë po përmend faktin se vetëm në një intervistë me një veprimtar tonin të shquar të botuar po në gazetën *Bujku* në fundjavën e tretë të muajit shkurt (1996), qoftë në formulimet e pyetjeve të gazetarëve, qoftë në përgjigje të tij fjala **kyçje** është përdorur keq me dhjetra e dhjetra herë, gjë që flet edhe për shkujdesje totale ndaj terminologjisë së gjuhës sonë letrare.

Mjerisht, gabime të tilla si kjo, qoftë nga pakujdesia, qoftë nga padija vërehen jo në pak raste në shtypin tone, sidomos kohëve të fundit. Jemi të vetëdijshëm që ne duhet t'i demaskojmë dhe luftojmë padrejtësitë, kudo që ndodhin ato në shoqërinë tone, po assesi mos të harrojmë se një luftë e tillë duhet të jetë edhe më e forte edhe në fushën e gjuhës përkatësisht në të mire të respektimit të terminologjisë, sidomos në masmediat tona, përndryshe gabimet siç është përdorimi pa vend i fjalës *kyç kyçje* lë përshtypje të keqe ndaj vetë gazetarëve, lektorëve dhe redaktorëve të rubrikës së caktuar, jo vetëm të gazetes *Bujku*, por edhe të organizmave e të organeve të tjera profesionale e joprofesionale të pushtetit në vendin tone e më gjerë.

(Prishtinë, shkurt, 1996)

17. RRETH SPECIFIKËS SË BARASVLERËSISË SË TERMAVE STABILIMENT / POSTROJENJE

Në një kumtesë vite më parë pata shprehur mendimin se "*kristalizimi i fjalës **stabiliment** në gjuhën tonë është i nevojshëm, sidomos te ne në Kosovë, ku vihet re se ky term po përdoret edhe atje ku nuk është e nevojshme, madje del edhe shumë i dëmshëm sa i përket qartësisë së paraqitjes së nocionit të caktuar*", po ay ishte konstatuar me vend se "*ky term nuk duhet të përdoret si ekuivalent për termin **zavod** dhe as për **uredjaj** të serbokroartishtes*", por mund të përdoret vetëm si barasvlerës i termit **postrojenje** të asaj gjuhe dhe vetëm atëherë kur është fjala për një vend (hapësirë) në kuadër të organizimit të punës në ndërmarrje, si term ekonomik. (Shih: *Seminari ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare* nr. 8/83 f. 11 -115).

Një konstatim i tillë ia vlen ose imponohet ende të sforcohet, ngase çështja mbetet e hapur edhe sot e kësaj dite. Prandaj në këtë trajtesë do të bëjmë fjalë më në hollësi rreth specifikës së barasvlerësisë së termave **stabiliment**, përkatësisht **postrojenje**, pasi që rreth barasvlerësisë së tillë po ndodhin paqartësi, madje edhe shkelje të rënda semantike.

Fjala **stabiliment**, si fjalë e huaj, në gjuhën tonë ka hyrë nga italishtja, ndërsa termi **postrojenje** është është term i mirëfilltë i gjuhës serbokroate. Me fjalën **stabiliment**, ç'është e vërteta, në gjuhën shqipe kuptojmë "*një ose disa ndërtesa të pajisura me mjetet e duhura për të panuar a për të prodhuar diçka*", përkatësisht kështu quhet "*një pjesë e veçantë e një ndërmarrjeje prodhimi*" (FGJSSH f. 1783). Ndërsa me fjalën **postrojenje** të serbokroatishtes kuptohet "*tërësia e pajisjeve (makina) të ndryshme në një ndërmarrje industriale*" (ukupnost različitih uredjaja u industrijskom preduzeću - RSHKJ 4 f. 770).

Natyrisht kuptimi i një fjale vështirë përmblihet në një përkufizim, me një apo dy fjali, por për përkufizimet e mësipërme menjëherë na bie në

sy ndryshimi, i cili nuk është i vogël, në të vërtetë, në formulimin shqip dallojmë lehtë *elementin e vendit si objekt ose ndërtesën a ndërtesat si lokale pune*, ndërsa në atë të serbokroatishtes dallojmë në radhë të parë: *tërësinë e mjeteve teknike, të pajisjeve a makinave*, të cilat kanë mundësi manovrimi, lëvizjeje e nuk janë statike, siç janë b.f. ndërtesat (stabilimentet).

Për të pasur një ide edhe më të qartë se ku përputhet e ku jo barasvlerësia e termave në fjalë në vazhdim po i themi dy fjalë rreth rrugës së zhvillimit të fjalëve të caktuara deri në pikën e takimit (të përkimit) të kuptimeve.

a) Fjala **stabiliment**, vjen nga etimoni stabilis e latinishtes (serb. stabilan - çvrst, shq. stabil - i qëndrueshëm), përkatësisht nga trajta latine: *stabilimentum* që në serbishte ka barasvlerësin: *utvrdjenje* (RLS f. 262) e kjo në shqipe ka këta barasvlerës: *fortesë, kështjellë, kala, fortifikatë* (FSSH 1974 f. 529), koncept ky që në italishte mbulohet me fjalë-termin **stabilimento**.

Pra fjala **stabilimento** e gjuhës italiane në serbokroatishte sipas Fjalorit italisht- kroatoserbisht (f. 408) dhe atij serbokroatisht - italisht (f. 244) ka këta barasvlerës: **zavod (ent), ustanova (institut, institucion), fabrika ose tvornica (fabrikë, uzinë), trgovina (tregtia) e produzeće (ndërmarrje)**. Po ashtu edhe në gjuhën shqipe stabilimento është huazuar për nocion vend-objekt ose ka këta barasvlerës: 1. *vendosje, caktim*; 2. **stabiliment, fabrikë** (FISH f. 325).

Po të krahasojmë barsvlerësit e mësipërm me përkufizimin e fjalës **stabiliment** që ka në gjuhën shqipe shihet qartë njëfarë reduktimi të kuptimit në gjuhën tonë në krahasim me atë që ka në gjuhën latine, përkatësisht të italishtes, por gjithnjë, siç u cek më sipër, kuptimi mbetet në suaza të një objekti industrial apo të një lokali të punës, përkatësisht të një reparti prodhimi, kurse fjala **postrojenje** e gjuhës serbokroate ka pasur fillim e zhvillim tjetër.

Nga pikëpamja fjalëformuese fjala **postrojenje** zërthehej kështu: po + stroj + enje. Së këtejmi fjala (emri) **stroj** në shqipe ka këta barasvlerës: **radhë, rresht, makinë**, ndërsa folja **strojiti, postrojiti: radhit, rreshtoj, vë në radhë, vë në rresht**. Emri **postroj** në shqipe shprehet me këta barasvlerës: **formacion, vendosje, makinë (vendosje (bllok makinash)**, përkatësisht **postrojenje - instalim, ngrehinë, fabrikë** (FSSH 1974 f, 588).

Pra gjithnjë kuptimi i fjalës **postrojenje** lidhet me makinat (pajisjet) dhe pastaj vendi i vendosjes së tyre në repartin përkatës të uzinës a të

fabrikës së caktuar. Dhe pikërisht këtu, si emërtime të lokalit të punës, kanë pikëtakimin e përbashkët këto fjalë-terma **postrojenje/ stabiliment**, prandaj si barasvlerës i fjalës **postrojenje** të serbokroatishtes veç fjalës **instalim, ngrehinë** mund të qëndrojnë edhe fjala **stabiliment**, por duhet pasur parasysh se krahas këtyre qëndrojnë në raste të caktuara edhe fjalë-termat: **makineri, impiant**.

Fjala **fabrikë** si edhe ajo **uzinë** si barasvlerës për **postrojenje** në shqipe nuk më duken të nevojshme, pa marrë parasysh se përveç FSKSH 1974, edhe në Fjalorin ekonomik serbokroatisht - frëngjisht për **postrojenje** pos barasvlerësit **intallation** (instalim) është dhënë edhe fjala **usine** (uzinë). (Shih: *Ekonomski rečnik srpskohrvatski - francuski*, Beograd 1975 f. 254.)

Pra edhe nga ky shembull mund të shihet shtrirja e kuptimit të fjalës **postrojenje** edhe në fushën e terminologjisë ekonomike që përkon pra me kuptimin e termit **stabiliment** në gjuhën tonë.

Gjithashtu edhe nga formulimi që është dhënë për fjalën **instalacija** në gjuhën serbokroate "pajisjet, makinat në një repart ose stabiliment (punishtë) (uredjaj, naprava u nekom pogonu ili postrojenje - RSHKJ 2 f. 661) del si kuptim i lokalit të punës jo për makina e makineri, siç u tha për fjalën **stabiliment**, nocion ky që pjesërisht vlen për konceptin **postrojenje**.

Sa për ilustrim të kësaj që u tha më sipër dhe për të tërhequr vëmendjen në barasvlerësinë adekuate po jap një shembull në disa gjuhë:

skr. Fabričko ili tvorničko postrojenje;
rus. zavodnie oborudovanie;
gjerm Fabrikationsanlage, Betriebsanlage;
angl. manufacturing plant, instalation machinery;
fabrique;
it. impianto (macchinario) di fabbrica;
shq. impiant (makineri fabrike, uzine, ndërmarrjeje stabiliment
(!!!)).

Pika e takimit të termave në shqyrtim ka rëndësi të njihet më mirë, ngase pothuajse aty ku takohen aty edhe mbetet barasvlerësia e tyre e nuk shkon më tej zhvillimi i tyre i përbashkët, prandaj barasvlerësit **fabrikë** e **uzinë** për **postrojenje** nuk duhet favorizuar në gjuhën tonë, por edhe zhvillimin e fjalës **stabiliment** të shqipes nuk duhet pranuar si të lejueshëm në asnjë rast, nëse kalon si barasvlerës i termit **uredjaj, instalacija** apo

edhe **postrojenje**, nëse kuptimi i tillë ka të bëjë me **pajisjet teknike (makineri)**.

Termi *stabiliment* në shqipe nuk duron shkëputje nga vendi (ndërtesa), pra nuk bën të kalojë me kuptim të pajisjeve teknike apo si emërtim i pjesëve të pajisjeve, siç po ndodh te ne. Madje mjerisht po kjo dukuri ka përhapje masive në mjetet tona të informimit. Edhe pse lidhur me këtë të pamirë kam bërë fjalë në një vend tjetër, prapseprap s'mund ta anashkaloj, pa e cekur këtu, mjerisht, një rast të freskët nga realiteti ynë gjuhësor. Në një emërtim të TVP-së (më 23.IV.1985 etj.) disa herë u reklamua një makinë e cila, siç thuhej aty, ishte e pajisur me "stabilimente speciale" (!).

Tashti më, më duket se çdo lexues e ka të qartë, sesa absurde del kuptimësia e një shprehjeje të tillë. Si mundet që pajisja të jetë e përbërë nga stabilimentet?!, kur dihet se stabilimenti në shqipe ka kuptimin e një ndërtese (kalaje, kështjelle etj.) (!).

Njohja e fushave kuptimore që mbulojnë termat në shqyrtim në gjuhët përkatëse dhe sidomos njohja e pikës së përkimit ose e mospërkimit të tyre në këto dy gjuhë ka rëndësi të madhe, sidomos në realitetin tonë gjuhësor aktualisht, sidomos lidhur me emërtimin e profesioneve në shkollat tona. Nga sa u tha secili mund të gjykojë sesa është e paqëndrueshme kur fjala e huaj *stabiliment* përdoret në atë kuptim që nuk ka as gjuha burimore prej nga është huazuar dhe aq më tepër kur një kuptim të tillë nuk e njeh as gjuha jonë letrare marrëse në asnjë stil funksional të saj, ndërkaq ajo përdoret te ne "pa lidhje fare"(!!?).

Dihet se fjala e huaj mund të pranohet vetëm atëherë kur importohet bashkë me sendin a me konceptin e ri, kur për atë send a koncept mungon fjala e gjuhës vendëse, përndryshe për koncepte e njohura asociacionisht aktivizohen fjalët e fondit aktiv të gjuhës përkatëse vendëse, qoftë sipas mënyrës së polisemisë, qoftë me farkëtimin e fjalëve të reja. Ndërkaq te ne zgjerimi i përdorimit të fjalës *stabiliment*, kur nuk përkon as me letrarishtesën e shqipes as me konceptin e italishtes, mund të cilësohet si një lapsus të cilin duhet kuptuar si të tillë dhe njëherazi duhet flakur pa mëshirë fare.

Në kuadër të kësaj që u tha mbetet detyrë e kuadrove tanë kompetentë, jo vetëm e ekspertëve të caktuar që të vlerësojnë situatat faktike se kur një term ka barasvlerësi autentike e kur jo.

Gjithsesi fjala **stabiliment** duhet të gjëjë vend në fjalorët tanë normativë dygjuhësh, jo pse për një term të tillë paraqitet nevojë e domosdoshme, por edhe me qëllim që ashtu do të stabilizohet përdorimi a mospërdorimi i fjalës së tillë. Me sa u trajtua del se fjala **stabiliment** ka kuptim sinonimik me termat **punishtë, punëtori, ngrehinë** (me makineri) a **repart** (...) dhe në realitetin tonë mund të zëvendësohet me njërin prej tyre sipas situatës, por nuk mund të ketë sinonimi me termat si b.f. **makineri, impiant, instalim, pajim e pajisje**, prandaj ky fakt duhet ta kihet parasysh, ngase pikërisht në këtë segment po ngjajnë shkarjet më të rënda.

Shpresojmë se kërkesa jonë nuk do të mbetet pa jehonë pozitive.

(Prishtinë, 26.IV.1985)

18. PËRHOLLËSI RRETH PËRDORIMIT TË TERMIT REPART NË RAPORT ME BARASVLERËSIN POGON TË SERBOKROARISHTES

Termi **repart** që në gjuhën shqipe ka hyrë nga italishtja: *reparto*, *riparto* - ndarje, veçim (krahaso: lat. re + pars, partis = ri + pjesë me kuptimin "ndarje në një ndërmarrje ... sipas llojit të punës, të pajisjeve ose të prodhimit" (FGJSSH 1980) si barasvlerës në gjuhën serbokroate ka termin **pogon** (odeljenje fabrike za pojedine poslove /Shih: *Reçnik srpskohrvatskog književnog jezika*, N. Sad 1976/), pothuajse me të njëjtin kuptim. Megjithatë në raportin semantik ndërmjet këtyre dy barasvlerësve sidomos në gjuhën tonë paraqiten ndryshime. Dhe pikërisht raporti i ndryshimeve të kuptimeve leksikore të këtyre dy termave barasvlerës tek ne do të jetë objekt trajtimi në këtë artikull, sepse në këtë kuadër dalin jopak ngatërresa e paqartësi, të cilat del e nevojshme të mënjanoohen doemos.

Dihet se në gjuhën shqipe fjala **repart** ka kuptimin kryesor, strumbullar, siç u cek, "ndarje e një ndërmarrje...", ndërkaq, në gjuhën serbokroate kuptimi kryesor i fjalës **pogon** është "forcë e cila lëviz një gjë" apo "burimi i një force të tillë", që mund të jetë me fuqi elektrike, hidraulike, deri atomike, etj., madje edhe si term teknik së pari me këtë fjalë (pogon) kuptohet "pajisja a makineria" e pastaj kuptohet edhe një "ndarje (repart) fabrike për punë të veçanta", ku janë vëndosur *makineritë a pajisjet e caktuara*.

Pra në strukturën polisemike termi **pogon** si barasvlerës i termit **repart** del në shkallën e tretë. Këtë po e spikas në mënyrë të veçantë, sepse duke i pasur në *nënndërdije* këto dy fjalë si barasvlerës në gjuhën shqipe te ne lidhur me këtë është interpretuar gabim (a përkthyer keq) termi i njeriut sipas profesionit, përkatësisht i veprimtarisë përkatëse në shkollat tona profesionale, siç e kemi cekur më përpara e siç do të shohim më poshtë.

Pra, përkthimi i termit **pogon** me brasvlerësin **repart** në gjuhën shqipe është i lejueshëm vetëm kur me **pogon** emërtohet një "*pjesë e ndërmarrjes që paraqet një tërësi teknike - teknologjike e lokale me një program të diferencuar prodhues*" (Shih: Ekonomski leksikon, Beograd 1975.), ndërsa në rastet tjera jo, nuk përkon. Po përsëris **nuk përkon**, sepse, siç u tha kjo fjalë s'ka të bëjë fare me kuptimin e termit **repart** të shqipes, po paraprakisht ka plus kuptim krejt tjetër.

Prandaj me të drejtë shprehim mospajtim e rezervë lidhur me saktësinë e emërimit të disa shkollave, përkatësisht rreth veprimtarisë së tyre të formuluar me shkrim(!), apo të emërtimeve të profesioneve të caktuara, siç janë paraqitur (të përkthyer në shqipe) në librin "Lista e shkollave", EFS. Pikërisht e kemi fjalën për këto emërtime:

1. *Kursi për teknikë reparti*, shifra 305, f. 49;
2. *Dega e lektro-teknike e shkollave për teknikë reparti*, shifra 307, f. 51;
3. *Shkolla për përpunimin e drurit për teknikë reparti*, shifra 404, f. 60;
5. *Seksioni i makinerisë i shkollës për teknikë reparti*, shifra 405, f. 62.
6. *Shkolla për teknikë reparti të degës së tekstilit*, shifra 408, f. 63;
7. *Shkolla e konfesionit për teknikë reparti*, shifra 408, f. 63.

Në kontekste të caktuara ndeshim edhe emërtime të tjera po me këtë lajthitje.

S'do mend se në të gjitha emërtimet e mësipërme fjala *repart* duhet të zëvendësohet me *makineri a pajisje elektromotorike* përkatëse. Mjerisht një lëshim i tillë gjithashtu del i vërejtshëm edhe në Vendimin e BVI-së Krahinore të Arsimit dhe të Edukimit të dates 24.XI.1980, nr. 610-1784/80 si dhe në Konkursin e shpallur në gazetën "Rilindja" nga kjo Bashkësi për regjistrimin e nxënësve për vitin shkollor 1980/81 në QAMO të Krahinës, p. sh.:

- *elektroteknik i reparteve motorike*;
- *elektro-mekanik reparti (elektracist reparti)*.

Po një rast të tillë e ndeshim edhe në librin "*Lista alfabetike e profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar (teksti në gjuhën shqipe)*", Beograd, prill 1981 si dhe në Konkursin për regjistrimin e nxënësve në AMO të Krahinës (...) të publikuar në gazetën "Rilindja", më 31 maj 1982.

Pra, gjithsesi pa kurrfarë mëdyshjeje, tek të gjithë shembujt që u dhanë më sipër siç janë: *teknik reparti; elektromekanik reparti, elektroteknik reparti* që në serbishte dalin: *pogonski tehničar, pogonski elektromehaničar, pogonski elektrotehničar* - është bërë gabim i pafalshëm me rastin e përkthimit, ngase fjala **repart(i)** në shqipe nuk i përgjigjet ekuivalentit **pogon(ski)** të serbokroatishtes në asnjërin nga rastet e mësipërme.

Po si është dashur përkthyer, cili është barasvlerësi edekuat? Patjetër lypset gjetur jo vetëm përgjigjen por edhe zgjidhjen. Në konsultim me ekspertët që e njohin fushën e veprimtarisë në shqyrtim del se emërtimet e tilla në atë mënyrë dalin "të zgjidhura" gabim, mirëpo pasi që, sipas tyre nuk dinin se si mund zgjidheshin emërtimet e tilla në kuadër të tërë truallin shqipfolës, nuk e kanë alarmuar shumë këtë golle (zbrazëti lakuriqe) duke e lënë tamam një lapsus të tillë, për turp, si *zgjidhje zyrtare(!???)*. Tash pasi po kuptohet qartë se kemi të bëjmë me një shkarje shumë të rëndë, po jepen mendime e propozime të ndryshme, se si është dashur ose duhet zgjidhur kjo çështje. Në vazhdim para se të jap mendimet a propozimet që më duken të drejta, edhe pse fjala e fundit u takon ekspertëve kompetentë dhe organeve shtetërore te ne e më gjerë, edhe njëherë do të tërheq vëmendjen se ku qëndron lajthitja.

U tha më sipër se termi **pogon** në raste të tilla nuk ka të bëjë fare me kuptimin e nocionit **repart**, por me kuptimin "*lëvizje, forcë e lëvizjes*" (Fjalori serbokroatisht - shqip, Tiranë 1947), "*forcë që vë në lëvizje*" (Fjalori i S. Dobroshit, Prishtinë 1953), "*veprimi i të lëvizurit, forcë motorike*" (FSSH 1974) - me një fjalë **pogon** ose **pogonska sila** është një forcë që lëviz (pajisjen) me ndihmën e fuqisë, e cila mund të jetë: fuqi që vepron *me anë të ujit, avullit, gazit*, pastaj me anë të fuqisë elektrike, fuqisë atomike etj, kështu që **pogonska sila** në serbishte del si sinonim me **pokretna sila** në terminologjinë e **mekanikës teorike** që në shqipe ka barasvlerësin **forcë** a **fuqi levizore** (Krahaso: pokret - lëvizje, pokretanje - të vënë në lëvizje) apo **pokretna jedinica** është sinonim me **pogonska jedinica** që në shqipe ka barasvlerësin **njësi levizore (lëvizëse)**.

Edhe në fusha të tjera të shkencës fjala **pogon** assesi nuk del me kuptimin e **repartit**, por me kuptime të tjera të përafërta, siç u tha më sipër. Kështu që p.sh. **pogonska poluga** në elektroteknikë ka kuptimin **shufër**

komandimi a manovrimi ose **pogonsko gorivo** ka barasvlerësin në shqip: **lëndëdjegëse motorike** (Shih Fjalori i termave ekonomike të H. Goranit).

Për mos me lënë shteg dyshimi mbrapa po përmend edhe faktin se në krahasim me barasvlerësit e gjuhëve të huaja të zhvilluara përforcohet mendimi i shprehur prej nesh. Kështu, kërkojmë të vihen re sinonimet e mëposhtme në disa gjuhë:

1. serb. pogonska snaga:
gjerm. Betrieskraf,
angl. working pover,
fr. force motrice d' operations,
shq. forcë motorike e veprimit;
2. serb. pogonska (pokretna) sila:
gjer, Treibkraft,
angl. propelling force,
fr. force de propultions,
shq. force (lëvizëse) motorike.

(Shih edhe te Poslovni privredni tehnički rečnik, Beograd 1963).

Pra edhe nga dy shembuj e mësipërm del se kemi të bëjmë me elektromotorë apo me pajisje të tjera që punojnë me ndihmën e burimit të energjisë përkatëse, e cila vë në lëvizje, si me thënë, pajisjet energjetike.

Për ta kuptuar edhe më mire etimologjinë e fjalës pogon të serbokroatishtes e shohim të arsyeshme ta shtojmë edhe këtë sqarim:

*Fjala **pogon** në gjuhën serbokroate është fjalë e përjardhur me parashtesin: po- (parashtesë) + gon/iti (tema fjalëformuese që shërben edhe për formimin e foljes goniti – grah (me grahë), shtyj (me shty), ndjek, grah, gonjenje - ngasje, grahje (sipas kuptimit primitiv: goniti stoku - me u grahë kafshëve) dhe së këtejmi **pogon** (po+gon...) doli me kuptimin që ka të bëjë me forcën e makinave, me ngasje të motorave, përkatësisht të motorave me ngasje ...).*

Në gjuhën serbokroate sipas Mala enciklopedija Prosveta, Beograd 1959, të gjithë **motorat** quhen **pogonske mašine** dhe makinat e tjera quhen **radne mašine** ose mašine radilice (**makina pune**). Në makinerinë e zhvilluar bëhet edhe një ndarje e mesme **transmisioni mehanizmi** a mekanizmat transmisionorë, siç janë: **dhëmbëzorat, reduktorat, zingjirorat, rriporat** etj., mekanizma këta që mund të jenë të pajisur me energji të llojllojshme, si:

elektrike, hidraulike, ajrore, termike, animale, bërthamore etj.

Kështu që me anë të mënyrave të tilla bëjnë mbartjen (transmisionin) e forcës së caktuar energjetike tek makinat e caktuara të punës, të cilat shpenzojnë energjinë mekanike. Thuhet gjithashtu se **makinë - veglat "mašine alatljike"** që sipas konstruksionit mund të të jenë të thjeshta ;,

(*obiçne* (të rëndomta), *universale, speciale e automatike (automatat)*) mund të marrin forcën motorike (serb. *pogonsku snagu*) drejtpërdrejt nga elektromotorat ose nëpërmjet mekanizmave transmisionorë.

Nga sa u tha del se lidhur me këtë duhet pasur kujdes që emërtimi **pogon pogonski** me kuptim *force motorike* assesi mos të ngatërrohet me fjalën **repart (i repartit)**, ngase aty është fjala për **forcë a ngasje motorike** e jo për vend a lokal pune, apo jo, siç i ka kuptimin fjalë-termi **repart** në gjuhën shqipe, apo jo?!!

Disa inxhinierë tanë të elektroteknikës, me sa di unë, fjalën **pogon** të serbokroatishtes e përkthejnë me fjalën **ngasje** e disa me fjalën **ren(d)tim**. Që të dyja këto trajta lidhen me foljen ngarend (me ngarendë) ngarendje ose *ngas* (me nga, me ngajtë, me vrapue), gjithsesi me kuptimin: "ecje (me vrap) përpara", përkatësisht *rend* (me rendë): "shkoj me vrap" përpara.

Nëse kjo fjalë-term nuk është konsoliduar plotësisht në terminologjinë tekniko-shkencore të degës së caktuar, shpreh mendimin se trajta *rendtim* (nga folja *rend+TO/j, rendtoj*) del më e parapëlqyer, ngase një mundësi të tillë e mundëson modeli foljeformues e emërformues i gjuhës sonë dhe se forma e caktuar nuk ndesh në homonimi me asnjë trajtë tjetër, siç mund të ndeshet folja **ngas ngasje (me nga)** ashtu edhe trajta *rentoj rentim* (me termin *rentë renta*) apo *rend rendoj* d. m. th. me mjetin *rende rendoj - grij me rende etj.*

Sigurisht nëse e lyp nevoja le të kihet parasysh neologjizma **rendtoj rendtim**, e cila do të përdorej vetëm për nocionin e rendtimit (ngasjes) të energjisë së caktuar, po kjo lypset të konstatohet dhe vlerësohet si nga ekspertët tanë inxhinierikë, ashtu edhe gjuhëtarë e kuadri tjetër profesionistë i shkollës shqiptare.

Për të qenë edhe më e kapshme lënda që po trajtohet këtu po jap edhe barasvlerësin përkatës në gjuhën angleze:

driving medium për shprehjen *pogonsko sredstvo (mjet rendtimi)* të serbokroatishtes.

Fjala **driving** e anglishtes ka sinonimi me fjalën *propel* (shtyj, ngas, rend). (Shih Fjalori i Mann-it 1957.) Në frëngjishte me fjalën **propulsion** shprehet nocioni "shtyj përpara", ndërsa **propulseur** quhen motorat e caktuar, prandaj edhe në shqipe për **pogonski motori** ka raste të ndeshim termin **motorat propulsorë**, sigurisht më mire kështu se të thuhet *motorat e repartit(!)*.

Në mbështetje të këtyre fakteve emërtimi **pogonski tehničar** në shqipe del **teknik i ngasjeve elektromotorike**, përkatësisht **elektroteknik** (*elektromekanik, mekanik, elektrikist*) **rendtimi a i motorave propulsorë** (!). Sidoqoftë, secila nga këto zgjidhje është më e qëndrueshme se sa ajo ku shënohet fjala "repart", ngase vërtet profesioni i tillë s'ka të bëjë me repart fare (si vend-lokal) po ka të bëjë me motora, me *forcën e caktuar energjetike*.

Nga sa u tha më sipër mendoj se kemi plotësisht të drejtë të kërkojmë me forcë (diturie) që të korrighohen emërtimet e 13 profesioneve të teknikëve të degës së elektroteknikë sa mësohen në këtë viti shkollor në QAMO-t e Kosovës, pa i llogaritur edhe emërtimet e tjera që e bartin gabim fjalën "repart" nga vitet e tjera.

Po përsëris se në gjuhën shqipe (në asnjë trevë shqipfolëse) fjala **repart** nuk përdoret në asnjë emërtim profesioni pra as për profesionet në degën e energjetikës që ka të bëjë me "me forcën lëvizëse" që transmetohet me anë të motorave a të pajisjeve të caktuara.

Po e përmend kalimthi se edhe termin "**inxhiner reparti**" (pogonski inzhener) që ende dëgjohet në stilin bisedor aty-këtu, te ne nuk është term i pranuar zyrtarisht as në serbishte si *pogonski inzhener* ... (Shih: Udhëzimin e BFPP, Beograd 1970), prandaj nuk duhet të përdoret as në gjuhën shqipe, aq më tepër kur vetë fjala "repart" del jo vetëm e diskutueshme, por as e qëndrueshme, siç u cek disa here në këtë trajtëse.

Para se të përfundoj po e cek edhe dukurinë se sot për sot në gjuhën serbokroate fjala **pogon** me konceptin që ka fjala **repart** në shqipe si njësi pak a shumë të veçuar organizuese a si pjesë të një ndërmarrjeje, fabrike uzine a kombinati nuk po përdoret, ne vend të saj po përdoret termi **odeljenje** a "**posebno odeljenje**: d.m.th. "repart" a "repart i veçantë a nënrepart" apo **veçani**, kështu që edhe ky fakt le të shërbejë si një sinjal plus që mos të përdoret fjala **repart** as për ato nënfusha semantike që nuk mund t'i arsyetohet asnjë logjikë.

Gjithsesi mendoj se Komisioni i caktuar duhet të marrë parasysh vërejtjet që u dhanë në këtë artikull dhe të bëjnë korrigjimet e domosdoshme menjëhershëmrisht (automatikisht) në të gjitha nivelet e sistemit shkollor, sidomos në shkollat e mesme e të larta profesionale të ne si dhe në të gjitha organizatat e punës së bashkuar, sidomos në ndërmarrjet elektrike e metalpërpunuese.

(Prishtinë, qershor 1983)

19. RRETH PËRDORIMIT TË TERMIT NDËRRESË

"Koha e caktuar gjatë së cilës punon në një ndërmarrje një grup njerëzish që zëvendësohen pastaj me një grup tjetër" në gjuhën shqipe, në stilin libror, është emërtuar me këto trajta: **ndërrim, turn, ndërrojë dhe ndërresë**.

Për të pasur një ide më të qartë lidhur me këtë dhe me qëllim që termi i parapëlqyer të gjejë përdorim më me lehtësi dhe me të gjerë në të gjitha stilet funksionale edhe ndër ne, më poshtë po i parashtroj disa konsiderata.

Termi **turn**, si shumë terma të tjerë tekniko-shkencorë, na është eksportuar nga italishtja: **turno** (fjalë neolatine *turnus* që i referohet greqishtes *tornos*) me kuptimin: "radhë e përcaktuar, sipas të cilës disa persona njëri pas tjetrit kryejnë ndonjë punë" (Vujaklija), apo "përsëritje e një veprimi sipas radhës së parapërcaktuar" (Klajq), kështu fjala turn u pranua në shqipe duke u përfshi edhe në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954) me kuptimin "*radha pas së cilës duhet kryer një punë, duke ndërruar me tjerë*".

Mirëpo edhe pse kjo fjalë e huazuar u përfshi në fjalorët shqip-gjuhë e huaj e anasjelltas ajo nuk arriti që plotësisht ta fitojë "qytetarinë" shqiptare në fjalorin themelor normativ të gjuhës shqipe, madje në ndërmarrjet ku punohet me "radhë", si p.sh. në minjera (Shih fjalorin e terminologjisë tekniko-shkencore - Terminologjia e minierave (13) Tiranë 1963, në vend të trajtë- termit **turn** parapëlqehet termi **ndërrojë**, i cili, ç'është e vërteta nuk pati përhapje të gjerë. Në gjuhën serbokroate si barasvlerës për një nocion të tillë përdoret termi **smena** (ashtu si edhe në rusishte) që si ekuivalent në gjuhën shqipe në burime të caktuara është shënuar trajta **ndërrim**. Kështu e ndeshim në *Fjalorin serbokropatish - shqip* (1947), pastaj në *Fjalorin e S. Dobroshit* (1953) që ilustron me shembujt: *smena* strazhe - ndërrim roje; raditi na smenu - me u ndërrue në punë. Edhe në *Fjalorin rusisht - shqip*, Moskë 1954 (edhe pse nën pikën 2. ceket edhe trajta turn) jepet shembulli *smena* karuale - ndërrimi i rojës (i karaulit). Në *Fjalorin serbokroatish - shqip*, (1974) për **smena** jepet së pari trajta *turn*, por edhe shembulli:

ndërrimi i rojës, Ndërsa M. Ndreca në FSHSK (1976), parapëlqen termin *turn*, por edhe *ndërrim*. Në FSHSK (1981) parapëlqehet trajta **ndërrim** e jo *turn*.

Po e cek faktin se A. Xhuvani për zëvendësimin e termit të huazuar *turn* propozonte fjalët: *sërë e radhë*, të cilat nuk gjetën pranim.

Në *Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe* (1976) lancohet termi **ndërresë**, ndërsa trajta **turn** nuk shënohet fare. Kështu për nocionin në shqyrtim fjala **ndërresë** sforcohet gjithnjë e më shumë në mjetet e informacionit dhe në burime të tjera si dhe në kolektivat punonjës. Kështu që në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) për nocionin përkatës parapëlqehet kjo trajtë duke i nxjerrë jashtë për këtë kuptim emërtimet: *ndërrojë, ndërrim dhe turn*. Në të vërtetë trajta e fundit *turn* shënohet vetëm si fjalë e shtresës pasive.

Pse iu dha përparësi trajtës **ndërresë** për t'u ngritur në normë, në krahasim me trajtat e tjera: *turn, ndërrojë e ndërrim*?

Përparësitë mund të jenë jashtëgjuhësore dhe brendagjuhësore. Për mendimin tim mund të cekem këto përparësi:

Së pari, edhe pse nuk ka pasur denduri përdorimi aq të madhe sa trajtat *ndërrim e turn* termi **ndërresë** është formëzuar pothuajse përafërsisht me këtë kuptim qysh herët. E ndeshim në *Fjalorin e "Bashkimit"* (1908) në trajtën **Nnrresë -at** si barasvlerës për termin it. cambio. Krahaso: cambia della gardia - ndërresa e rojës (Italijsko- hrvatski ili srpski rečnik, Zagreb 1980).

Së dyti, termi **turn** kaloi në shtresën pasive të fjalësit të gjuhës sonë pasi që ishte fjalë e huaj, e pakuptueshme për masën, madje edhe si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë nuk ka arritur të bëhet. P.sh. në gjuhën frënge (si gjuhë neolatine) për këtë kuptim përdoren këto fjalë, varësisht nga konteksti: *poste, roulement équipe, réileve* - por: *équipe de premier tour* do të thotë: *ndërresa e parë*, kurse italisht p.sh. *turno di lavoro* - **ndërresa e punës**, prandaj si fjalë e tillë, pasi gjeti zëvendësimin e plotë në gjuhën shqipe nga termat që ka vetë gjuha nuk pati më nevojë për të.

Së treti, sa i përket trajtës **ndërrojë**, nga *ndërr/OJ+Ë* që ka një rrugë specifike fjalëformimi, mund të konstatohet se formimet e tilla më prapashtesën -Ë nga fundorët më -OJ nuk paraqesin ndonjë model të qartë, edhe pse krijimet e tilla meritojnë trajtim të veçantë, si emra prejppjesorë pandajshitesorë të gjinisë femërore.

Së katërti, lidhur me termin **ndërrim** që ka përhapje jo të vogël që është krijuar nga rrënja **ndërr-**, përkatësisht folja **ndërroj (me ndërrue)**, me prapashitesën -IM, pos procesit të punës mund të paraqitet fare mirë edhe si rezultati i veprimit, mirëpo kur kemi parasysh se fjala **ndërrim**, si strukturë kuptimore, është shumë e ngarkuar në gjuhën tonë, e cila tregon veprimin sipas kuptimeve të foljes ndërroj (ndërrohem) (me ndërrue a me u ndërrue) që ka mëse gjashtë kuptime si: "*zëvendësoj, këmbëj, ndërroj mendjen, shkëmbej, aratis, ndryshoj, pësoj ndonjë ndryshim apo ndonjë cilësi ndreqem zbukurohem etj.*", atëherë kuptimi në shqyrtim do ta ngarkonte edhe më shumë këtë fjalë, prandaj nga nevoja, por edhe pse ishte fjalë e gatuar më përpara që në Fjalorin e Bashkimit (1908) etj., me vend e me arsye u parapëlqye trajta **ndërresë**.

Së pesti, në strukturën kuptimore të termit **ndërresë** (sipas FGJSSH (1980)), veç kuptimit kryesor që u trajtua më lartë cekën edhe pesë kuptime të prejdardhura (polisemike), argument ky i fortë që dëshmon për kuptimin autonom të kësaj fjale në raport me kuptimin leksikor të fjalës **ndërrim**.

Së gjashti, krijimi i emrave konkretë e abstraktë që emërtojnë rezultatin e veprimit ose një send konkret me prapashitesën -ESË në kohën tonë është mjaft produktivë, si p. sh.: pagesë, ngarkesë, shtesë etj., pra edhe ndërresë.

Prandaj krijimi i fjalë - termit **ndërresë** në këtë mënyrë del i përligjur dhe kuptimisht i kapshëm.

Sa i përket homonimisë kuptimore me emrin konkret **ndërresat** që është vetëm në shumës me kuptimin "tërësia e veshjes të brendshme" mund të konstatojmë se kjo homonimi e pjesëshme nuk është aq e fortë dhe nuk paraqet fare pengesë kuptimi.

Nga sa u tha del konkluzioni se pa kurrfarë ngurimi duhet të përdoret në të gjitha ndërmarrjet e shkollat tona, përkatësisht në të gjitha stilet funksionale të gjuhës sonë fjala **ndërresë**, me kuptimin siç u cek këtu, si barasvlerës i termit **smena** të gjuhës serbokroate dhe për këtë koncept të mos përdoret më termi: *turn* dhe as trajtat *ndërrojë* apo *ndërrim*.

20. RRETH AKTIVIZIMIT TË FJALË-TERMIT ORGANIKË TE NE

Çdo organizatë e punës së bashkuar (ndërmarrje a institucion etj.) me përcaktimin e veprimtarisë së vet përkatëse me aktin themelor normativ njëherësh përcakton edhe skemën organizuese të vendeve të punës, dokument ky që ngërthen në vete nevojat për kuadrin e domosdoshëm të paraparë për kryerjen e punëve dhe të detyrave që dalin në suazat e veprimtarisë së përgjithshme të saj. Pikërisht ky akt administrativo-juridik me të cilën rregullohen këto çështje, ndër ne, po emërtohet me termin togfjalësh "**sistematizimi i vendeve të punës**", shprehje kjo që në të vërtetë, është përkthimi i barasvlerësit të gjuhës serbokroate: "**sistematizacija radnih mesta**".

Çështje e vërteta, po ky koncept në gjuhën serbokroate del edhe në trajtën e ndryshuar "**sistematizacija poslova i radnih zadataka**", së këtejmi edhe në shqipe është përkthyer: "**sistematizimi i punëve dhe detyrave**", pasi që me "*Ligjin për punën e bashkuar*" (1976) termi "*radno mesto*" (*vendi i punës*) për arsye të plotësim-ndryshimeve të marrëdhënieve në përsosjen e sistemit vetëqeverisës, në shumë raste u zëvendësua me termin "*poslovi i radni zadaci*" (*punët dhe detyrat*), mirëpo, po në atë dokument nuk u hoq nga përdorimi as emërtimi "**vendi i punës**" (*radno mesto*), së këtejmi që të dyja këto trajta i hasim në përdorim edhe në organizatat tona të punës së bashkuar. Gjithsesi togfjalëshi "**sistematizimi i vendeve të punës**" (sistematizacija radnih mesta) del si term më i përdorshëm e stabil edhe për shkak të traditës së përdorimit. (Shih: Pravna enciklopedija 2, Beograd 1985, f. 1507.)

Synimi ynë nuk është të diskutojmë a të vëmë në pah dy trajtat sinonimike të sipërcekura, por kemi për qëllim të tërheqim vëmendjen a t'ua kujtojmë kuadrove përkatës e të tjerëve te ne, se pikërisht për konceptin e zënë në gojë këtu në gjuhën tonë e kemi termin **organikë**, fjalë kjo që i takon fondit aktiv të fjalësit të gjuhës shqipe të sanksionuar edhe me dokumentat normativë të gjuhës sonë letrare.

Kështu, fjala **organikë** (gr. organon, lat organum) në shqipe ka hyrë nga italishtja **organico**, me kuptimin "tërësia e nëpunësve (të një institucioni)". (Shih: TRHS, Zagreb 1960.) Në FGJSH (1954) për këtë fjalë jepet ky përkufizim: "lista e plotë e kuadrove në zyrë, të një ministrie, me emërtimin e detyrave dhe të gradave të tyre". (Aty f. 361.) Kurse në FGJSSH (1980) përkufizimi del paksa më i plotë:

"tërësia e vendeve të punës të një institucioni, të një ndërmarrjeje, të një reparti a të një njësie ushtarake, e cila miratohet nga organet e larta; lista e nëpunësve dhe e punëtorëve që zënë këto vende pune së bashku me emërtimin e detyrave, të titujve ose të gradave të tyre".
(Aty f. 1308.).

Ç`është e drejta këtë fjalë-term e hasim edhe në fjalorët shqip-serbokroatisht të botuar te ne. Në FSHSK të M. Ndreçës (1976) për fjalën **organikë** në serbokroatishte jepen përgjegjësit: "ustrojstvo, sistematizacija, kadrovi (jedne ustanove)", në FSHSK (1981) "sistematizacija (ustrojstvo) radnih ljudi ustanove, institucije", ndërsa në Fjalorin e termave dhe të shprehjeve ekonomike të H. Goranit (versioni shqip - serbokroatisht) (1985) jep barasvlerësin, siç thuhet, shkurt e qartë: "**sistematizacija radnih mesta**".

Njëra ndër arsytet për mos përdorimin e termit në fjalë te ne mund të jetë edhe mosnjohja në shkallë të gjerë e kësaj fjale nga kuadrot e caktuar në organizatat tona të punës së bashkuar, madje si arsye tjetër mund të merret edhe shkaku i njohur se në gjuhën e administratës të ne mbizotëron parimi i përkthimit (kalkëzimit) të termave nga serbokroatishtja, parim ky që është zbatuar edhe te rasti i krijimit të termit togfjalësh "sistematizimi i vendeve të punës" nga serbokroatishtja "sistematizacija radnih mesta" pa e vrarë mendjen a pa e përfillur faktin se për konceptin në fjalë kemi zgjidhje tjetër, siç është rasti me fjalë-termin **organikë**.

S`ka dyshim se me fjalë-termin **organikë** në shqipe, ashtu si edhe me termin togfjalësh "sistematizimi i vendeve të punës" (serb. sistematizacija radnih mesta") mbulohet po ai koncept a kuptim. Është fjala, pra, për aktin administrativo - juridik a dokumentin zyrtar në të cilin janë përfshirë emërtimet e vendeve të punës që njëherazi përfaqësojnë edhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit apo të kuadrove bashkë me gradat, titujt, kualifikimet e specializimet që kanë a duhet të ketë personeli i tillë për të kryer punët dhe detyrat në ato vende pune. Dhe në këtë kuadër kuptohen

edhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë personat e caktuar varësisht nga detyrat dhe funksionet që ushtrojnë momentalisht.

Meqenëse fjala "sistematizim", sipas FGJSSH (1980), në kuadër të kuptimit të vet leksikor nuk e ka nuancën kuptimore që jepet në togfjalëshin "sistematizimi i vendeve të punës" dhe duke pasur parasysh porosinë që shtrohet rreth njëzimit të terminologjisë sonë tekniko-shkencore, mendojmë se fjala **organikë** duhet të aktivizohet edhe në organizatat tona të punës së bashkuar, jo vetëm krahas a si një sinonim ndërkëmbyes, por edhe në vend të krejt togfjalëshit "sistematizimi i vendeve të punës".

Në të vërtetë, togfjalëshi në shqyrtim, edhe pse nuk mund të quhet si përkthim i paqëlluar a si një njësi e pakapshme leksikore në rrethe të caktuara te ne, shikuar në tërësi ai nuk mund të favorizohet edhe për arsye se ka përhapje të kufizuar (nëndialektore) dhe gjithsesi nuk ka perspektivë shtrirjeje për mbarë folësit e gjuhës sonë letrare.

Për qëndrueshmërinë e fjalë-termit **organikë** për konceptin në fjalë do të ketë pasur ndikim aktualisht edhe te ne, mund të ketë, edhe kuptimi figurativ i mbiemrit me karakter ndërkombëtarizmi: organik/organike me nocionin "që ka të bëjë me ndërtimin e brendshëm të një diçkaje" (FGJSSH f. 1308), ngase pikërisht skema organizuese e ndërmarrjes është në të vërtetë një organizëm a "ndërtim i brendshëm" i saj, ku vendet e punës i përbëjnë njësitë themelore "organizative - teknologjike" të asaj skeme.

Gjithsesi fjalë-termi **organikë** ka përparësi në krahasim me togfjalëshin "sistematizimi i vendeve të punës".

(Prishtinë, 27.II.1989)

21. RRETH SHPREHJES "PËR KOKË BANORI"

/Reagim rreth një "lëshimi" terminologjik/

Në gazetën "Rilindja" të datës 25.X.1986 f. 15, në rubrikën "gjuha në praktikë" u botua artikulli me titull "Disa lëshime gjuhësore në shtyp, radio dhe televizion" në të cilin si "lëshim" ceket edhe "përdorimi i gabueshëm" i shprehjes gjuhësore nga fusha e terminologjisë ekonomike "për një banor". Gjithsesi autori ka meritë jo vetëm pse e nxjerr në pah, por edhe pse e sugjeron zgjidhjen e një çështjeje të tillë të hapur nga fusha e terminologjisë tekniko-shkencore. E quaj të hapur "lëshimin" d. m. th. shprehjen në fjalë, sepse një çështje e tillë nuk ka gjetur zgjidhje, përkatësisht nuk është përfshirë në asnjërin nga fjalorët dygjuhësh të ne, madje edhe në fjalorët e terminologjisë ekonomike, ku e ka vendin, nuk del e zgjidhur aq qartë.

Shprehja në fjalë përdoret mjaft dendur pra pikërisht në fushën e ekonomisë për të shprehur treguesit e caktuar të veprimtarisë (afarizmit a veprimësisë), me të cilët nënkuptohet zakonisht shuma e caktuar e tërësishme (totale) që përpjesëtohet me numrin e tërësishëm të njerëzve në organizatën a rajonin e caktuar, për t'u gjetur kështu mesatarja si tregues i sukseshmërisë ose i realitetit etj.

Për të paraqitur një rezultat të tillë, sigurisht nën ndikimin e gjuhës serbokroate ndër ne doli shprehja "**prodhimtaria për kokë banori**" (**proizvodnja po glavi stanovnika**), pra përkthim i fjalëpërfjalëshëm, apo "**prodhimtaria për një banor**", siç e parapëlqen autori i artikullit në fjalë. Por edhe kjo shprehje, me sa di, nuk mund t'i ikën plotësisht ndikimit të shprehjes së mëparshme, pra as ndikimit të trajtave të gjuhës serbokroate.

Ç'është e vërteta, shprehja "po glavi stanovnika" e gjuhës serbokroate, duke pasur parasysh, siç thuhet, natyrën e gjuhës sonë, mbase më drejt do të dilte "prodhimi për frymë të popullsisë", ashtu siç del e rekomandueshme sipas FGJSSH-së (f. 506).

Le të dihet se shprehja terminologjike e gjuhës serbokroate "po glavi (po osob)" në gjuhën frënge ka barasvlerësin "par tête, par personne" (për kokë, për person, përkatësisht për frymë, siç del në FGJSSH) /Shih: Ekonomski rečnik srpskohrvatski - francuski, Beograd 1975, f. 71/.

Është me rëndësi të theksohet lidhur me këtë rast se në gjuhën serbokroate treguesi në fjalë "proizvodnja po glavi stanovnika" mund të dalë

edhe "proizvodnja po stanovniku", ku nënkuptohet shprehja "po glavi", prandaj zakonisht në organizatat tona të punës së bashkuar kemi treguesit, si p.sh.:

- proizvodnja po radniku (po glavi radnika);
- prosek liçnog dohodka po radniku iznosi ..." etj.

që ndër ne zakonisht po përkthehet:

- prodhimi për një punëtor;
- mesatarja e të ardhurave personale për një punëtor kap shumë " ..." etj.

Një fakt të tillë sigurisht e ka pasur parasysh edhe autori i artikullit në fjalë dhe kjo është pozitive nga ana e tij, ngase një zgjidhje të tillë e bën të njohur publikisht, por këtu del kontestues vetëm qëndrimi i tij, pathuajse, kategorik, ngase siç del nga artikulli në fjalë, zgjidhja "për një banor", sipas tij konsiderohet si një zgjidhje e formës së prerë, e padiskutueshme.

Së këtejmi, siç u pa krahas barasvlerësit: proizvodnja po glavi stanovnika - prodhimi për një banor " në gjuhën tonë në vend të shprehjes "po glavi" mund dhe duhet të përdoret shprehja "për frymë", pra, "**prodhimi për frymë të popullsisë**" shprehje kjo që sipas FGJSSH 91980) e kryen plotësisht funksionin në gjuhën tonë për konceptin në fjalë, prandaj shprehjet e mësipërme të gjuhës serbokroate në shqipe dalin edhe kështu:

- prodhimi për frymë (të punëtorëve);
- mesatarja e të ardhurave personale neto për frymë kap shumë " ..." etj.

Zakonisht përcaktori përkatës në shumës "të punëtorëve" të banorëve" etj. del i nënkuptueshëm nga vetë konteksti.

Fjala *frymë* me të cilën në gjuhën tonë kuptohet një "banor, vetë, njeri (zakonisht me një numër)" me funksionin e konceptit, siç po ceket këtu, del, siç u tha, e shënuar edhe në burimet tona normative. (Shih: FGJSSH f. 506, nën 6.) term ky që në gjuhën serbokroate ka këta barasvlerës sinonimikë: "glava (koka, kreu), duša (shpirti), stanovnik (banori) grla /glava krupne stoke d.m.th. kokë bagëtie (Shih FSKSH 1974 f. 212.) çovek (njeriu), osoba (vetë) /Shih: RSHKJ 1, f.484 dhe 811./ e ndonjë rast tjetër ku nënkuptohet fjala e caktuar me këtë kuptim nga vetë konteksti, si në shembujt e mësipërm.

Pra, me sa u tha më sipër, i bëhet me dije opinionit tonë dhe autorit se procesi i konsolidimit rreth shprehjes terminologjike për konceptin në fjalë të ne vazhdon, përkatësisht për këtë nocion konkurrojnë shprehjet "për kokë të..." "për një..." dhe "për frymë".

Pa i përjashtuar variantet e tjera e sidomos togun "për një..." në situata të caktuara, mendoj se ndër ne gjithnjë e më shumë duhet aktivizuar shprehjen "për frymë", sepse ka shtrirje më të gjerë në truallin e shqipes, edhe pse për ndonjë individë të ne shprehja e tillë do të ketë qenë e panjohur për konceptin në shqyrtim.

(1.XI.1986)

22. NDËRKOMBËTARJA "DYQAN" SI TERM-KONCEPT I ZËVENDËSUESHËM NË SHQIPE

Fjala ndërkombëtare **dyqan** me origjinë arabo-turke, e cila del edhe ne trajtën **duqajë** (Shih edhe te Fjalori i H. Bariqit dhe ai S. Dobroshit), kishte përhapje mjaft të gjerë në të kaluarën, ajo ka përdorim edhe aktualisht më tepër në stilin bisedor, ngase, si të themi, zyrtarisht koncepti i saj gjithnjë e më shumë po del i zëvendësuar nga fjalë-terma të tjerë të brumit vendës: *punëtori*, *tregto*, *shitore* etj., por në kohë të vona edhe edhe nga fjalë të huaja, siç janë fjalë-termat (e modës!): *ofiçinë*, *butik* por edhe *market* (minimarket) etj., duke e shtruar nevojën që sadokudo të diskutohet kjo dukuri nga pikëpamja e kuptimësisë leksikore.

Sipas FGJSSH (1954) me fjalën **dyqan** kuptohet një "dhomë përdhese në treg, ku tregtari shet mallin e tij, a ku zejtar i ushtron zejen e vet", ndërsa në FGJSSH (1980) përkufizimi del paksa më i gjerë: 1. ndërtesë a dhomë e veçantë ku tregtohen mallra të ndryshëm; 2. bised. ndërtesë a dhomë ku një zejtar ushtron mjeshtrinë e vet dhe 3. *vjet.* ndërtesa a dhoma ku një zejtar prodhonte vetë e shiste një mall".

Meqenëse te ne është i lejueshëm sadokudo ushtrimi i lirë i zejeve të caktuara dhe në sektorin privat, ajo që është shënuar në Fjalorin e sipërcekur si koncept i vjetëruar nuk qëndron pra, për kushtet tona, megjithatë zyrtarisht nuk e kemi të emërtuar asnjë lokal të tillë si **dyqan**, por me emërtime të tjera të zyrtarëzuara. Kjo ka ndodhur edhe për shkak se edhe në gjuhën serbokroate zyrtarisht nuk del e shënuar asnjë vëndeshërbesë me emërtimin **duqan**, edhe pse edhe në atë gjuhë kjo fjalë ndërkombëtare ka përdorim mjaft të dendur pikërisht për konceptin, siç e pamë në formulimet e mësipërme.

Sipas praktikës së derisotme për konceptin e termit **dyqan** (serb. *duqan*) për lokalet private është aktivizuar fjalë-termi **punëtori** (serb.

radnja, radionica) dhe në lokalet shtetërore zakonisht **shitore** (serb. **prodavnica**).

Dihet se në shqipe përveç termave **punëtori** dhe **shitore** del edhe emërtimi **tregtore**, i cili mjaft mirë mund të zëvendësojë konceptin e fjalës **dyqan**, por edhe të atyre: **butik** e **market**. Prandaj, vërtet nuk ka kurrfarë arsyeje të mos shfrytëzohet një mundësi e tillë, madje ajo duhet favorizuar edhe zyrtarisht. Kjo duhet të bëhet, aq më tepër, për faktin se me një zëvendësim të tillë mund të flaken nga përdorimi fjalët e huaja të panevojshme: dyqan, butik, market etj. dhe se vetë kontrukti fjalëformues i emrit të prejardhur treg+tore, d.m.th. me prapashitesën e specializuar -TORE bën pjesë në modelin e kapshëm fjalëformues të emërimit të vendshërbesave në gjuhën shqipe, ku bën pjesë edhe koncepti i fjalës dyqan si dhe të emërtimeve të tjera të diskutueshme sinonimike.

Në fund po e përmend edhe fjalë-termin "dyqan-shtëpi" të cekur në FGJSSH, koncept ky që te ne del në trajtën "shtëpi e mallrave" (serb. robna kuqa) a do të zëvendësohet edhe kjo me "tregtore mallrash" a do të parapëlqehet njëri nga emërtimet ekzistuese apo do të dalë ndonjë emërtim tjetër, ia vlen të ndiqet me kompetencën e duhur. Për koncepte të caktuara dalin edhe emërtimet "vetëshërbim" (serb. samoposluga), ose nga tradita:"magazinë popullore" a "MAPO" që në serbishte del "narodni magazin a "NAMA".

Sidoqoftë fjala **dyqan**, edhe pse në cilësinë e fjalës ndërkombëtare ka mundësi të zëvendësohet me ndonjë emërtim tjetër, sidomos në stilin zyrtar, ajo si një historizëm, edhe aktualisht del e përdorur në stilin bisedor si lokal ku prodhohen dhe shiten mallra zajtarësh zakonisht.

23. PËR AKTIVIZIMIN E FJALËS HERË/HERA NË VEND TË FJALËS SË HUAJ TURË/TURA

Gjuha jonë në rrjedha të kohës ka marrë mjaft fjalë nga gjuhët e huaja, disa prej të cilave edhe janë përvetësuar duke u bërë pjesë përbërëse të fondit aktiv të leksikut të saj, por disa edhe janë nxjerrë jashtë si të panevojshme. Presione të tilla ka edhe sot. Mjaft fjalë të karakterit ndërkombëtar, sidomos nga fusha e terminologjisë tekniko-shkencore, edhe sot e kësaj dite pranohen dhe përvetësohen, sepse gjuha shkencore e publicistike ka nevojë për to, madje po të bëhej rezistencë e tepruar ndaj tyre do të varfërohej aftësia shprehëse e gjuhës sonë në stile të caktuara, mirëpo ka raste kur ndonjë fjalë me origjinë të huaj, edhe nëse mund të katë pasur jetë, duke zërë vend edhe në ndonjë fjalor, ajo meriton të nxirret jashtë si fjalë e konsumuar ose të zëvendësohet me fjalë e trajta të tjera, të cilat dalin të mjaftueshme për të zëvendësuar atë a konceptin që mbulon ajo, prandaj fjalët e tilla, qoftë si të vjetra t'i flakim jashtë, qoftë të *reja* të shpifura pa nevojë që në zanafillë t'i hetojmë dhe t'i zëvendëojmë me barasvlerës që i rrinë më mire natyrës së gjuhës sonë. Fjalë e tillë e shpifur sipas mendimit tim është edhe fjalë **turë/tura**, e përfshirë në Fjalorin shqip - serbokroatisht, Prishtinë 1981, si barasvlerës i fjalës **tura** të serbokroatishtes.

Ç'është e vërteta, fjala **turë/tura** (serbokr. tura) vjen nga frëngjishtja (le tour), e cila i referohet fjalës latine a neolatine *turnus*, e cila në serbokroatishte ka hyrë me kuptimin "pjesë e ndarë e një veprimi" ose "pjesë e një etape për kryerjen e një pune (veprimi) në raport me pjesët e tjera të ngjashme". (Shih: RSHKJ, N. Sad 1969.) Pothuajse po me këtë kuptim del e regjistruar edhe në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare të gjuhës serbokroate dhe ndoshta kjo është arsyeja që përpiluesit e fjalorit shqip - serbokroatisht e kanë futur këtë konstrukt si fjalë aktive të fondit leksikor të shqipes letrare.

Është e vërtetë se nën ndikimin e gjuhës serbokroate në rrethe të caktuara te ne, sidomos në stilin bisedor, kjo fjalë dëgjohet edhe nga

shqipfolësit në rrethe të caktuara, mirëpo kjo më duket se nuk duhet të jetë fakt aq bindës sa që një trajtë e tillë të zërë vend në fjalorët tanë normativë.

Fjala "tour" e gjuhës frënge (sipas fjalorit "Nouveau petit Larousse", Paris 1972) ka 21 kuptime polisemike, por në gjuhën tonë si dhe në atë serbokroate është përkthyer kryesisht me këta barasvlerës: *rrotullim* (okret, obrt); *rreth* (krug); *shëtitje* (šetnja, *putovanje*); **radhë** (**red**) si dhe me kuptime të tjera, siç është në shqipe edhe fjala *torno* (vegël a përdorëse teknike), por në asnjë rast nuk del e përkthyer në shqipe në trajtën të përvetësuar nga frëngjishtja: *turë/tura*. Kjo dëshmohet si nga fjalorët e V. Kokonës, ashtu edhe nga fjalorët e Murat Bejtës.

Nga sa u tha, mund të themi se fjala **turë/tura** nuk është fjalë e mirëfilltë ndërkombëtare e aq më pak në cilësinë ndërkombëtarizmës, prandaj të gjithë shembujt e dhënë në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981) nuk dalin aq të domosdoshëm.

Për mendimin tim fjala **tura** e serbokroatishtes më mirë do të dilte e përkthyer në shqipe me fjalët **herë**, **radhë**, **rend**, **sërë**, **xhiro**, **rund** e ndonjë tjetër sesa me **turë/tura**, fjalë frëngë kjo, pra, që te ne vjen nga serbishtja(!).

Nëse shtrohet pyetja se cila nga këta barasvlerës të shqipes duhet a është më mirë të favorizohet për këtë nocion, unë pa u hamundur shumë do ta zgjidhja shembullin e parë **herë/hera**. Një parapëlqim të tillë e mbështesh për këto arsye:

E para, kështu e kam dëgjuar edhe në ligjërime të lirë te ne, pastaj fjala **herë/hera** e mbulon plotësisht nocionin e fjalës **tura** të serbishtes, siç u cek më sipër, ngase me emrin **here hera** sipas FGJSSH kuptohet: "**koha kur ndodh diçka**" apo "**një copë kohe e vetme, kur ndodh diçka e njëjtë me ngjarjet e tjera ose pjesë e barabartë me pjesë të tjera dhe e marrë si njësi matjeje për të treguar përsëritjen a radhën e diçkaje**" ose "**rasti, ngjarja a diçka tjetër që përsëritet kohë më kohë ...**"

E dyta, që të gjitha sinonimet e tjera si *radhë*, *sërë*, *xhiro*, *rund* e ndonjë tjetër dalin të zëna apo të specifikuara pakashumë për nocione të tjera, kështu që fjala **herë/hera** pasi që nuk qëndron në kontekste të caktuara vetëm si barasvlerës i fjalëve: *put*, *epoha*, *doba*, *vreme trenutak*, *sluçaj* etj, por rri për ballë si ekuivalent edhe ndaj fjalës *tura*, me pak sforcim mund të specifikohet pikërisht për këtë funksion.

Prandaj për mendimin tim teksti nga Fjalori në fjalë që po diskutohet këtu lidhur me këtë fjalë duhet të modifikohet kështu:

- vetëm një turë - samo jednu turu - **vetëm një herë**;

- mjafton një apo dy tura - dosta je jedana ili dve ture - **mjaftojnë një apo dy hera**;

- u detyruam që të plagosurit t'i bajmë (transportojmë) në tri tura - morali smo da ranjenike prenesti u tri ture - **u detyruam që të plagosurit t'i bartnim me tri hera**.

Më poshtë po i jap edhe nja dy shembuj, si raste të mundshme, ku fjala **tura** e serbokroarushtes del e përdorur, por edhe përkthyer shqip edhe me fjalën **herë/hera** edhe më fjalën *radhë/radha*:

1. Šoferi prve smene prebacuju radnike u dve ture - Shoferët e ndërresës së parë mbartin punëtorët **me dy hera**.
2. Sada je tvoja tura (da platiš) - Tashti është *radha* jote (të paguash).

Lidhur me shëmbullin e dytë, varësisht nga situata dhe stili funksional, edhe në serbokroatishte më natyrshëm del që ne vend të fjalës **tura** të përdoret fjala *red (radhë)*, përkatësisht *runda (rundi)* siç parapëlqehet në Fjalorin e gjuhës letrare të serbokroatishtes.

Po shtoj edhe këtë se në *Fjalorin serbokroatisht-shqip*, Prishtinë 1974 për fjalën *runda* të serbokroatishtes në shqipe jepet trajta *rondë/ronda*, si edhe te Vujaklija, sipas shqiptimit frëng. Krahao angl. *rounda*, gjerm. *Runde*. Siç dihet në shqipe një trajtë e tillë nuk parapëlqehet për të treguar *radhën* në qerasje etj.

Sodoqoftë mendoj se në vend të fjalës **turë/tura** si barsvlerës për fjalën **tura** të serbokroatishtes, madje edhe të frëngjishtes në shqipe është mirë të favorizohet barsvlerësi **herë/hera** e në raste të caktuara edhe ajo **radhë/radha**. Kështu që me një veprim a favorizim të tillë do të mbulohej koncepti dhe njëherazi do të pushonte nevoja për përdorimin e fjalës me prejardhje të huaj *turë/tura*. Po shtoj edhe këtë se në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe, Tiranë 2011, si barsvlerës të fjalës **tura**, si zëvendëse e parë del pikërisht trajta **here hera**.

(Prishtinë, 12.X.1983)

24. RRETH BARASVLERËSIT SKLOP (PODSKLOP) TË SERBOKROATISHTES NË SHQIPE

Në ndërmarrje industriale, konkretisht në Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës në gjuhën serbokrate ka përdorim mjaft të gjerë dhe të domosdoshëm fjalë-termi teknik **podsklop**, përkthimi a gjetja e barasvlerësit të caktuar në shqipe ende nuk del i qartë. Çështje e vërteta, duke pasur parasysh kuptimin e fjalës **sklop (skllop)**, të serbokroatishtes, pasi që **podsklop** nuk del e shënuar, me të cilën kuptohet "*medjusobni raspored ukupnih delova, koji çine celinu*" d.m.th. "*renditje e ndërsjellë a tërësia e pjesëve, të cilat përbëjnë një strukturë*", atëherë kuptohet se koncepti **podsklop** ka të bëjë me një njësi më të vogël se ajo që pasqyrohet me fjalë-termin **sklop**.

Kuadri teknik shqipfolës i ballafaquar me një problem të tillë, d.m.th. të fjalë-termave **sklop podsklop**, i ka përkthyer në trajta të ndryshme si p. sh:

1. **sklop** - uni a unji, ndërlidhje, tërësi, bashkësi (bashkëti e bashkojë), strukturë, përbërje dhe së fundi: **bllok**;

2. **podsklop** - nënuni a nënunji, nëndërlidhje, nëntërësi, nënbashkësi (nënbashkëti a nënbashkojë), nënpërbërje dhe së fundi: **nënbllok**.

Pa hyrë në hollësi mbasi në kontekste të caktuara secila nga trajtat e mësipërme të shqipes, pa e përjashtuar edhe ndonjë tjetër, si barasvlerës i përgjithshëm mund të jetë e qëndrueshme, por kur është fjala për cilësimin e fjalës si term, atëherë patjetër lypset parapëlqyer vetëm njëra. Në FSJKSH 1974 për fjalën **sklop** jepen këta barasvlerës: *mbërthim, ndërlidhje, ndërthurje e strukturë*.

Duke u mbështetur në procesin teknologjik, përkatësisht në realitetin që shprehet me fjalë-termin e tillë konkretisht në këtë ndërmarrje, por që mund të ketë ngjashmëri procesore edhe në ndërmarrje të tjera metalpërpunuese dhe duke e pasur parasysh faktin se në asnjërin nga fjalorët

tanë në përdorim nuk del e qartësuar barasvlerësia e tillë konkrete, më poshtë po i paraqit mendimin pse trajta e fundit **bllok**, **nënblok** del si më i pranueshme.

Së pari, asnjëri nga barasvlerësit e shënuar në FSKSH 1974, nuk përshtat me konceptin që mbulon fjalë-termi **podsklop**, siç u tha më sipër, madje edhe kuptimi i fjalës **strukturë** del shumë i përgjithësuar.

Së dyti, trajta *uni* a **unji** si barasvlerës nuk e ndeshet në asnjë burim përkatës që të mund të arsyetohej si fjalë-term për nocionin në fjalë (sklop podsklop). Po ky konstatim vlen edhe për neologjizmat: bashkëti dhe bashkojë.

Së treti, trajtat **tërësi**, **bashkësi** e **ndërlidhje** po të gjykohej mbi bazë të përkufizimeve që kanë në FGJSSH shprehin a dalin të specifikuar për nënfusha të tjera edhe pse mjaft të përafërta semantike, mirëpo edhe këto si terma për nocionin në fjalë nuk dalin të përpunuara.

Së katërti, fjala ndërkombëtare **bllok**, krahas kuptimeve të tjera del edhe me kuptim të terminologjisë teknike, madje sipas FGJSSH nën 9. përkufizimi i dhënë përputhet me nocionin në shqyrtim. Kjo fjalë si term i fushës tekniko-teknologjike në gjuhën tonë del i përkufizuar si "tërësi e pjesëve të një mekanizmi ose të një pajisjeve, të lidhura së bashku për një punë" dhe për këtë jepen shembujt:

blloku i cilindrave, blloku i motorit, blloku i zërit në televizor".

(Shih FGJSSH f. 158O.)

përkufizim ky pothuajse i ngjashëm me atë **sklop a podsklop** të serbokroatishtes.

Siç dihet fjala **bllok** (nga fr, *bloc*) si ndërkombëtarizëm në gjuhë të ndryshme, siç u cek më sipër, ka marrë edhe kuptime polisemike, ndër të cilat edhe semantikën e termit teknik në fushën e makinerisë a të teknologjisë, qoftë si pjesë teknike: **vrsta dizalica** (lloji i kranash) (Klajq), çaura (bokolla), zheleznički uredjaj (pajisje hekurudhore), veliki komad metala (copë e madhe metali (Aleksi) etj.

Edhe në krahasim me gjuhën frënge dhe atë ruse, fjala sklop (podsklop) e serbishtes del e ndërkëmbyeshme si p.sh.: bloc carter-cylindres, serbokr. blok cilindara ose **sklop cilindara**) shq. **bllok cilindrash**, përkatësisht rusisht: *blok antenoge komutatora*, serbokr. **sklop antenskoqg prekida**, shq. **bllok i komutatorit të antenës** etj.

Kështu pra, fjala **bllok nënblok** edhe në shqipe për konceptin në trajtim mund të qëndrojë si barasvlerës adekuat i fjalës **sklop posklop** të serbokroatishtes.

Sç kçtejmi, në kuadër të *Veçanes* a *nënrepartit të nënbloqeve* (Odeljenje posklopova) bëhen operacione saldimit të gjithë elementeve përbërëse të rezervuarit të amortizatorit të tipit përkatës, duke filluar nga: **fundi i rezervuarit, vëshëza dhe të elementeve të tjera.**

Në fund duke pritur vlerësimin edhe nga kuadro të tjerë po bëj me dije se emërtimi i serbokroatishtes: "**Odeljenje za varivanje i posklopova**" në Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës, në shqipe ka barasvlerësin "**Veçania e saldimit dhe nënbloqeve**". Sa del me vend një barasvlerësi e tillë le ta japin mendimin e vet kuadrot profesionalë edhe nga fakulteti përkatës si dhe institucionet e caktuara që kanë fundja detyrë, me u rrekë me probleme të tilla.

Sidoqoftë, zgjidhjet e shtruara mbase me guxim në dukje duhet të vlerësohen. Me një fjalë, përpjekja për harmonizimin e termave të caktuar teknikë, jo vetëm në Kosovë, por edhe për mbarë truallin shqipfolës nuk duhet të reshtur.

(Prishtinë, 2.VII.1983)

25. RRETH SPECIFIKËS SË PËRDORIMIT TË TERMIT *AFARIZËM* TE NE

Në praktikën gjuhësore ndër ne (në shqipe) për termin **poslovanje** të serbokroatishtes që del nga folja **poslovati** "*vršiti poslove*" / kryej (me krye) punë/ apo *baviti se poslom*" /ushtroj veprimtari/ (Shih: RSHKJ 4 f. 752¹.) dhe që përdoret zakonisht në stilin ekonomik (financiar, tregtar), përkatësisht në "lëmin e veprimtarisë komerciale" / *u domenu komercijalne delatnosti*; (Shih: *Knjigovodstveni leksikon*, Beograd 1965 f. 569.)/dalin përgjegjëset: *veprim, veprimtari, veprimtari ekonomike*; (FTE f. 90.), *punim, të punuarit, të bërit punë, rrjedha e punëve, veprimtari, të vepruarit* ;(FSSH 1974 f. 598.) *punë e veprimtari, veprimtari afariste* ose vetëm **afarizëm**, fjalë kjo që është mjaft e përhapur në realitetin tonë gjuhësor, por që nuk favorizohet në asnjë fjalor ose tekst përkatës normativ.

Ç'është e vërteta, sipas burimeve të caktuara ndër ne, siç do të ceket më poshtë në këtë trajtesë, për **poslovanje** si barasvlerës mbizotërues del fjala veprimtari, mirëpo pasi që kjo fjalë është e zënë si barasvlerës edhe për fjalë-koncepte të tjera e sidomos për fjalën **delatnost** të serbokroatishtes me të cilën ka më tepër përshtatshmëri edhe sa i përket ngjashmërisë ndërtimore fjalëformuese (krahaso: vepër - delo, vepro (me veprue) - delati, veprim - delanje, veprimtar - delatnik, veprimtari - delatnost) edhe sa i përket vetë përkufizimit lidhur me konceptin e caktuar. Kështu që për t'i ikur homonimisë ndër ne për fjalën *poslovanje* u kërkua apo kërkohet ndonjë barasvlerës tjetër.

Ç'është e vërteta, në kuadër të kuptimit leksikor të fjalës *delatnost* (*veprimtari*) del edhe kuptimi i fjalës **poslovanje** (**veprimësi**). Me fjalën **delatnost** kuptohet "osobina onoga koji je delatan" / cilësi e atij që është veprimtar (aktiv) - RSHKJ 1 f. 650./, përkatësisht "kao obeležje

¹ Shkurtime e titujve të literaturës së konsultuar janë sqaruar në fund të këtij punimi.

"zanimanja" ekonomskih jedinica, koje se odredjuju prema vrsti proizvoda ili usluga tih jedinica / *si tipar i "profesioneve" të njësisive ekonomike, të cilat caktohen sipas prodhimeve dhe shërbimeve që kryhen në njësitë e tilla/* (Shih: Ekonomski leksikon, f. 156.) ose "oblast rada onih koji aktivno ili stvaralački obavljaju posao u određenoj oblasti" /fusha e punës së veprimtarëve të caktuar, të cilët aktivisht dhe në mënyrë krijuese kryhen punët në lëmin e caktuar/ (*Priručni rečnik udruženog rada*, f. 98.).

Edhe fjala shqipe **veprimtari** ka pothuajse përkufizim të ngjashëm (identik), me të kuptohet një "punë e gjallë që kryen dikush në një fushë të caktuar të jetës; pjesëmarrja e gjallë në një punë", përkatësisht "degë prodhimi që kryen punë ose shërbime të caktuara" (FGJSSH f. 213), kështu që po në kuadër të kësaj veprimtarie të përgjithshme del edhe kuptimi që ka të bëjë me fjalën **poslovanje**, përkatësisht **afarizëm** që po gjen përdorim te ne.

Fjala **afarizëm** është me origjinë italiane **affarisme**, e cila i referohet latinishtes *affere, affarre* me kuptimin: *sjell, bie* etj. (*Fjalori latinisht - shqip* f. 25), përkatësisht është derivat nga fjala *affare* (e cila është e reflektuar edhe në gjuhë të tjera: gjerm. *Affare*, fr. *affair*, angl. *affair*) etj.

Fjala **affaire** e italishtes, sipas H. Vocit, përveç kuptimeve që shprehen me bararsvlerësit: *punë, çështje*, ka edhe kuptimin "**biznes, veprimtari tregtare ose financiare**" (FISH f. 23) dhe po me kuptimin e fundit po përdoret te ne fjala **afarizëm**, pasi që edhe **poslovanje** ka të bëjë me veprimtari të tillë. Edhe nga përkufizimi që i jepet në frëngjishte fjalës **affairisme** "*tendance à tout subordonner oux affaires d'argent*" /synimi (tendenca) e tërë asaj (veprimtarie) që varet nga çështja e parasë/ (*Nouveau petit Larouse*, f. 18), kuptojmë se kjo fjalë ndërlidhet me veprimtari monetare a financiare, mirëpo duke pasur faktet që do të paraqiten më poshtë dhe sidomos të vërtetën objektive shkencore se fjalët e caktuara mund të marrin ngjyrimë të ndryshme semantike varësisht edhe nga sistemi shoqëror politik e ekonomik (specifik) të vendit të caktuar, atëherë do të dalë me vend dyshimi lidhur me përdorimin padruajtje të kësaj fjale në gjuhën tonë (madje edhe te ne), aq më tepër kur kjo fjalë përfaqësohet a përqafohet me koncept ndërkombëtarizmi.

Edhe në gjuhën serbokroate fjala **affarisme** e italishtes del vetëm me barasvlerësin **afarizam** e jo edhe me fjalën **poslovanje**, madje në *Fjalorin italisht - serbokroatisht* të N. Sjeranit kjo fjalë e italishtes sqarohet me "*nesavesno poslovanje*" /veprimtari me mungesë ndërgjegjeje/. Këtë fakt ne

patjetër duhet ta kemi parasysh, pasi që fjala **afarizëm**, siç u tha, po përdoret si barasvlerës i mirëfilltë për fjalën **poslovanje** të serbokroatishes e jo për *afarizam* "*nesavesno poslovanje*", siç e paska kuptimin kjo fjalë në italishte dhe po me këtë kuptim e paskemi të reflektuar edhe në gjuhën serbokroate e në gjuhë të tjera(!) (Shih: RISH f. 12). Dhe së andejmi edhe në gjuhën tone, te ne, apo jo? Gjithsesi, sido që ta marrësh, kjo çështje del e diskutueshme.

Një dyshim i tillë na shtohet edhe nga barasvlerësia e termit *affarista* (afarist), për të cilin Klaiqi shpjegon : "çovjek koji bez ustezanja ide za dobitkom i çastima, spekulant" /personi i cili pa ngurrim shkon pas gostitjeve e fitimeve/ (VRSR f. 20) ose sipas Larouesse-it: "*affaraiste - speculateur, homme d'affaires peu scrupuleux*" /afarist - spekulator, "biznesmen" me ndërjegje të pakët, i paskrupullt/ (Aty f. 18.) ose sipas FGJSSH "afarist - sipërmarrës i madh privat në vendet kapitaliste që përpiqet të nxjerrë sa më shumë fitime me çfarëdo mjeti" (Aty f. 7). Në Fjalorin doracak të punës së bashkuar (Priručni rečnik... që u cek më sipër f. 12) fjala afarist(a) sqarohet kështu "u poslovnom svetu slično je špekulant" (në botën e biznesit është i ngjashëm me termin spekulator (spekulues)/.

Kështu pra, fjalët **afarizëm afarist** në kontekste të caktuara pikërisht në fushën e veprimtarisë me të holla (me pare), zëvendësohen me fjalët **spekulim, spekulator** e dihet se me fjalën **spekuloj** kuptohet: ai që "nxjerr fitim... në rrugë të parregullta ose përpiqet të nxjerrë përfitime nga mungesa a nga vështirësitë e dikujt, shfrytëzohet mirëbesimi i dikujt a një tipar tjetër të tij për qëllime jo të mira". (FGJSSH f. 1718.), Kështu që botërisht a faqe dheut kurrkush nuk do t'i lejonte vetes "emërtime" të tilla jashtë çdo kriteri humanitar e moralisht të dyshimtë! Kjo nuk mund të jetë e lejueshme në kuadër të çfarëdo sistemi shoqëror, ku mund të veprojë personi i tillë, kur kemi parasysh faktin se çdo sistem a strukturë e veprimtarisë propagandohet si humaniste, qoftë edhe në ligjet formale konkurrencte të ekonomisë së tregut, ngase gjithkund duhet të veprojë a të respektohet, siç thuhet "konkurrenca lojale". (Shih: Ekonomski leksikon, f. 260.)

Vlen të theksohet këtu edhe fakti se për fjalën **delatnost**, përkatësisht **veprimtari** si sinonim në gjuhë të ndryshme del fjala **aktivitet** (aktivnost) që është ndërkombëtarizëm i mirëfilltë, por në të gjitha gjuhët janë krijuar edhe sinonime të tjera përkatëse, siç janë edhe në shqip e serbokroatisht përkatësisht: *veprimtari / delatnost*. Ndërsa për **poslovanje** (që ndër ne po përdoret fjala **afarizëm**) në gjuhë të ndryshme, ndër te tjera, dalin edhe këta barasvlerës:

gjerm. **Geschäftikeit**,
 angl. bussines (bussines operations),
 rus. делјателјностј,
 sp. gestion de negocion,
 fr. gestion (d` affaires),
 it. l` agire (il lavorare) ose **gestion d` affari**.

Të vihet re fakti se as në gjuhët romane, madje as në italishte nuk del qartë barasvlerësi **afarizëm**, ndërsa fjala **gestion** në shqipe përkthehet me fjalët: *qeverisje, administrim*.

Prandaj argumentet e shtruara më sipër dhe sidomos fakti se në letrarishten e sotme shqipe nuk e kemi të "pranuar" fjalën *afarizëm!*, madje edhe në gjuhën serbokroate u përdorka me kuptim tjetër spekulues(!), mendojmë se mjaftojnë këto fakte sa për të vënë në dyshim përshtatshmërinë e kësaj fjale (afarizëm) edhe tek ne, e cila si dihet është duke u përdorur me intensitet të shtuar.

Është e udhës që kjo specifike e përdorimit të kësaj fjale të rishikohet, natyrisht duke e pasur parasysh edhe sistemin e tashëm shoqëror ekonomik, sepse siç u tha më sipër "politika e veprimësisë" duhet të mbështetet edhe në "parimin e moralit ... humanist". (Knjigovodstveni leksikon f. 564.)

Është interesant të theksohet fakti se termi **poslovanje** nga të gjithë hartuesit e teksteve, përkatësisht të fjalorëve dygjuhësh tek ne është përkthyer me fjalë të tjera e jo me fjalën afarizëm. Në FSSH 1974 për fjalën *poslovanje* nuk del fjala afarizëm, por vetëm për fjalën *afarizam* te serbokroatishtes del në shqipe *afarizëm*. (Po aty f.3.) Në FSHS 1976 nuk është përfshirë fjala *poslovanje*. Hajrullah Gorani për fjalën *poslovnost* përdor fjalën *afarizëm* (FTE f.93), kurse në FSHS 1981 si barasvlerës i fjalës *afarizëm* janë shënuar fjalët *poslovnost* dhe **afarizam**, mirëpo po në këtë fjalor për togfjalëshin **veprimtari e tregtisë** që në serbokroatishte kemi **poslovanje trgovine** (është shënuar sinonimi **afarizmi tregtar** (Po aty f. 991.), kështuqë vetëm në këtë "burim zyrtar" për të parën herë në njëfarë dore del identifikimi i fjalës **poslovanje** me **afarizëm**. Ky fakt reflektohet edhe në njërin nga fjalorët më të rinj të prof. H. Goranit, ku për fjalën **afarizëm** në serbokroatishte janë shënuar ekuivalencat: **poslovnost**, **afarizam** dhe **poslovanje** (Shih: FTSHESH f.13), për ndryshe në fjalorin tjetër po ky autor shënon: **poslovanje - veprimtari, veprimtari ekonomike** (FTSHESH f. 183). Edhe prof. Nuri Bashota fjalën *afarizëm* nuk e shënon si

fjalë më vete. Ky parapëlqen fjalën *veprimtari* a *punë* si barasvlerës për *poslovanje* të serbokroatishtes, ashtu si edhe Sokol Dobroshti e A. Alishani etj.

Në doracakun "*Terma dhe shprehje nga LPB*" Prishtinë 1977 për **poslovanje** është shënuar togfjalëshi "*veprimtari ekonomike*", kurse në FTJ (1979) për *poslovanje* janë shënuar si barasvlerës fjalët: *veprimtari*, *punë* (Po aty f.114), por këtu kemi edhe për **delatnost** - *veprimtari*, *aktivitet*, përkatësisht **poslovanje produzeća** kemi **veprimtari e ndërmarrjes** si dhe për **delatnost organizacije** kemi **veprimtari e organizatës** (Po aty f. 32 dhe 114). Së këndejmi, që të dy termat *delatnost* dhe *poslovanje* të serbokroatishtes dalin me barasvlerësin **veprimtari**. Një homonimi e tillë në raste të caktura mbase mund të tolerohet, por në shumicën e rasteve ajo paraqitet si një pengesë a vështirësi që patjetër kërkon zgjidhje. P.sh. **delatnost radne organizacije** dhe **poslovanje radne organizacije** në të njëjtin kontekst patjetër imponojnë barasvlerës të ndryshëm, pasi që zgjidhja **veprimtaria e organizatës punonjëse** nuk vetëmjafton për të dy konceptet. Madje kemi raste si p.sh. **finansijski rezultat poslovanja delatnosti** (Shih: Formulari nr. 3 i datës 25.I.1985 të EKS-së, të dyja fjalët *poslovanje* dhe *delatnost* dalin në të njëjtin togfjalësh. Përkthimi (*rezultati financiar i ushtrimit të veprimtarisë*) gjithsesi është zgjidhje e rastit aty.

Duke qenë kështu nën presionin e nocionit, përkatësisht të kuptimit leksikor të fjalës *poslovanje* te ne dolën barasvlerësit si:

veprimtari ekonomike; veprimtari financiare; veprimtari pune; veprimtari afariste; ushtrimi i veprimtarisë; veprimësi (veprimësim), madje edhe afarizëm.

Gjithashtu nën ndikimin e fjalës *afarizëm*, përkatësisht *poslovanje*, *poslovati* të serbokroatishtes ndër ne pati raste të dalë edhe folja **aferoj** (Rilindja, 28.II.1984 f.7) dhe **afaroj** (TVP, 2.VI.1985, ora 15.00; Rilindja, 16.IV.1986 f.7; 17.IX.1985. f.7 etj.

Gjithsesi trajta **aferoj** nuk qëndron, sepse lidhet prej nga prejardhja me fjalën **afërë**, e cila edhe pse rrjedh nga i njëjti burim etimologjik, por sipas shqiptimit frëng "affaire" (lexo afeer) ka kuptim krejtësisht tjetër, sidomos në gjuhën serbokroate. Me këtë fjalë kuptohet: "një punë e ndytë, e pandershme, rast që zgjon interesimin e opinionit" (Aleksić, RSRI f. 15), pra me atë fjalë kuptohet një "skandal ose një veprim kundërligjor" (PRIR f. 12). Edhe trajta **afaroj** del e panevojshme për realitetin tonë gjuhësor, pasi

që edhe vetë qëndrueshmëria e fjalës afarizëm po kontestohet, kurse trajtat *afar* a *afare* nuk i kemi të pranuar në fjalësin e gjuhës sonë letrare.

Dr. Esat Stavileci lidhur me këtë fjalë-term shkruan: "

... në fjalorin tonë të përditshëm po përdoret, na thotë mendja, gabueshëm, shprehja "afarist, "afarizëm"... Prandaj duhet të gjendet dhe përdoret një shprehje tjetër, ndoshta veprimtari, punë... Sidoqoftë mbetet çështje e hapur". ("Përparimi" nr. 5/85 f. 616.)

Edhe prof. H. Gorani ndër fjalët që ndër ne janë reflektuar jonatyrshëm, por si një "dukuri e çuditshme ose përkthim "me tahmin..." shënon edhe fjalën *afari* (për *poslovanje*). (Shih: Përparimi nr 5/85 f. 116.). Po ky autor në kumtesën "*Çështje të terminologjisë në fushën e ekonomisë*", thekson:

*"Fjalë-termi poslovanje në praktikën jugosllave përdoret për të shprehur aktivitetet e funksioneve jo prodhuese të një ndërmarrjeje ekonomike. Kjo fjalë është e ngjashme me fjalën angleze **business** (business). Me këtë fjalë shprehet **aktiviteti i ndërmarrjes në treg apo në politikën komerciale dhe financiare**". (Aty f. 201.)*

Edhe Haxhi Birinxhiku në punimin: "Disa shmangie në përdorimin e terminologjisë në "Gazetën zyrtare të KSAK", të botuar në përmbledhjen "*Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi*", Prishtinë 1988 f. 148) vëren:

*"termat **afarizëm** dhe **afarist**, serbokroatisht: poslovanje, poslovanje çovek, në gjuhën shqipe po përdoren gabimisht, sepse ata në të vërtetë kanë tjetër kuptim, kanë kuptim keqësues. Një kuptim të tillë këto fjalë e kanë edhe në gjuhën italiane prej nga janë huazuar"..*

Ç'është e vërteta, edhe para këtyre vërejtjeve me vend, në përpëlitje a në "kërkim shtigjesh" rreth gjetjes së një barasvlerësi sa më adekuat për fjalën **poslovanje** doli ndër ne (e lancuar prej nesh) edhe përftimi i fjalës **veprimësi** (a **veprimësim**), fjalë kjo që kërkon favorizim.

Fjalë-termi **veprimësi** nuk lancohet këtu për të parën herë. E hasim edhe në ndonjë punim tjetër si p.sh. te "Përparimi" nr. 3/85, f. 388, pastaj te gazeta "Fjala" nr. 18/85, në gazetën "Rilindja", 15. II. 1986 f. 16 etj.

Sa i përket ndërtimit a mënyrës fjalëformuese mënyra e tillë ka model të qartë: emër prejfoljor më -IM + prapashtesa -(Ë)SI, siç janë shembujt: *vijimësi, vazhdimësi (FGJSSH)*, pastaj: *kuptimësi, njëkuptimësi, burimësi, bashkimësi, pajtimësi, shtjellimësi, ndryshimësi, pambarimësi, shoqërimësi* etj. që është dukuri e gjallë në shkrimet e natyrës studimore ndër ne, dukuri

kjo që zgjon interesim dhe kërkon vlerësim. Madje sa i përket nënfushës semantike fjala **veprimësi** përkon me sishoqet e modelit fjalëndërtues të tipit: *gjuhësi, bujqësi, punësi, drejtësi, shëndetësi*.

Në rastin tonë që kemi në shqyrtim emër-temës **veprim-** i është shtuar prapashtesa -(Ë)SI: veprimësi. Me fjalën veprim kuptohet "kryerja e një pune a një veprimtarie të caktuar..." (FGJSSH f.2130.) Me prapashtesën -(Ë)SI te emri i ri mbartet, si të themi, cilësia e rezultatit, që lidhet me temën prodhuese motivuese duke i mundësuar formëzimit kuptimit të ri që ka të bëjë me "kryerjen e një veprimtarie të caktuar" në fushën e caktuar të ekonomisë lidhur me gjendjen prodhuese - monetare të një ndërmarrjeje (organizate punonjëse) qoftë në sektorin shtetëror, qoftë në sektorin privat apo të përzier, veprimtari kjo motivisht cilësore e cila varet nga shërbimet si: *shitja, furnizimi, financimi, investimi, manipulimi me çmimet* etj.

Kështu për t'u lehtësuar sadopak ngarkesa e madhe e fjalës **veprimtari** dhe njëherësh për t'u bërë i mundshëm mënjanimi i përdorimit të një qëndrueshmërie të dyshimtë qoftë edhe të pjesërishme të fjalës së huaj **afarizëm**, mendojmë se përftimi i fjalës së re **veprimësi** është i drejtë dhe parasegjithash i nevojshëm. Kjo trajtë kështu nëse favorizohet ka mundësi të përthithë plotësisht kuptimin e fjalës **poslovanje**, natyrisht duke pasur parasysh ndonjë veçori dalluese në kontekste të caktuara si p. sh. poslovna godina - viti financiar etj.

Pra kur kemi të bëjmë me pasqyrimin e punëve komerciale dhe të sukseshmërisë ekonomike (financiare) për asociacionet e caktuara përgjithësisht dhe organizatat e caktuara punonjëse (prodhuese) në veçanti, qoftë në sektorin shtetëror, qoftë në sektorin privat a të përzier si zgjidhje del termi **veprimësi**, ndërsa për firma të caktuara me ngjyrim stilistik keqësues, mbase mund të përdoret edhe termi **afarizëm**, por gjithsesi për veprime të tilla në përdorim të përgjithshëm krahas atij **veprimësi** del fjalë-termi i qëndrueshëm libror **biznes**, i cili është i shënuar në FGJSSH. Sidoqoftë, së këtejmi del se edhe përdorimi i emërtimit **afarist** (*afarizëm*) mund të ruhet në përdorim për konotacione stilistike apo të "zbutet" paksa a të zëvendësohet qoftë me fjalën **biznesmen** (biznes), qoftë me sinonime të tjera.

Sigurisht kur kemi të bëjmë me përfaqësuesit e organizatave tona punonjëse mund të përdoren termat togfjalësh si p.sh.: përfaqësuesi ynë tregtar, ekonomisti, komercialisti, pastaj partneri ynë ndaj palës tjetër,

biznesmeni ynë etj., por në anglishte nocionin që po e diskutoj më përshatshëmse të tjerët e mbulon fjalë-termi **manager – menazhues (zyrtar administrate)**.

Gjithsesi përdorimi i sinonimeve si këto që priren të terminizohen jo vetëm do të zbusin por edhe do të mënjanonin keqkuptimet eventuale që mund të dalin nga përdorimi pa vend i fjalëve afarist a afarizëm. Sa për ilustrim po theksoj faktin se në fjalorin e sinonimeve anglisht - serbokroatisht janë dhënë 9 sinonime për fjalë-termin *business* (biznes/afarizëm /veprimësi). (Shih: *Englesko-srpskohrvatski rečnik, sinonimi i antonimi*, Beograd 1981 f. 45.) Ndërkaq në *Fjalorthin e sinonimeve të gjuhës angleze* (Grujiq, Reçnik englesko-srpskohrvatski, Cetine 1984 f. 284) janë dhënë 26 sinonime apo kuptime polisemike (nuanca kuptimore) rreth kësaj fjale. Prandaj, ma merr mendja se fjala **veprimësi**, por edhe prepjesori eventual **veprimësim**, si sinonim i fjalës *veprimtari*, përkatësisht *afarizëm* ose *biznes*, del e arsyeshme dhe jo e panevojshme, siç është edhe përvetësimi nga nevoja nga anglishtja e fjalës **menazhim, menazhues**, fjalë-term ky, i cili nuk është keq të favorizohet pikërisht për fushën semantike, për të cilën po rekomandohet këtu.

Janë të gjitha parakushtet që një fjalë e tillë *menazhim* ose *veprimësi* për konceptin në shqyrtim të gjejë shtrirje në mbarë truallin e shqipës. Fundi i fundit kjo paraqitje ka për qëllim të bëjë me dije opinionin tonë në përgjithësi për dukurinë e shfaqjes së trajtës **veprimësi**, si fjalë-term barasvlerës i fjalës **poslovanje** të serbishtes, përkatësisht i ndërkombëtarizmës **biznes**, përkatësisht **menazhim** dhe si zëvendësim i fjalës ndërkombëtare **afarizëm**, ku fjala *veprimësi* del me konotacion jokeqësues.

Sigurisht me sforcimin e fjalës **veprimësi** me kohë mund të dalë fare natyrshëm edhe folja *veprimësoj/veprimësohet* e derivatet prejfoljore *veprimësim, veprimësues* mbi këtë bazë, me të cilat do të mbulohen ato nënfusha semantike për të cilat sot për sot po përdoret ndonjë fjalë e huaj dhe jemi në kërkim e sipër se si të gjenden zgjidhje në mbështetje të zhvillimit të brendshëm të gjuhës sonë.

Sidoqoftë, lidhur me temën e shtruar këtu mendoj se është me inters të cekim barasvlerësit më të përafërt që janë apo mund të jenë në krahasim me fjalët përkatëse të gjuhës serbokroate, por që mund të qëndrojnë edhe për gjuhë të tjera, si p.sh.

rad - punë,
 raditi – punoj (me punue),
 delo - vepër,
 delovati – veproj (me veprue),
 zaposliti – punësoj (me punësue),
 uposlen - me punë
 bezposlen – pa punë
 zaposlen – i punësuar
 zapošljavanje - punësim,
 posao - punë, veprimsi,
 poslovati - veprimësoj (me veprimësue), menazhim,
 poslovanje - veprimësi (veprimësim),
 poslovan-a-o - veprimësor/e, veprimësues, menazhues etj.
 poslovan човек – veprimësues (biznismen), menazhues etj.

Në fund po ritheksoj se lindja a përftimi i fjalës **veprimësi** nuk duhet cilësuar si një neologjizëm i panevojshëm apo si një kalk i krijuar vetëm nga ndikimi i tërthortë i termit **poslovanje** të serbokroatishtes, por duhet kuptuar e pranuar si një fjalë-term të nevojshëm, i formuar në mënyrë të rregullt, me të cilin mbulohet (emërtohet) koncepti, sadokudo, i ri i imponuar për përkufizimin e nënfushës së caktuar semantike dhe se një fjalë e tillë, kur kemi parasysh mënyrën si dhe gjedhen fjalëformuese, ka të gjitha gjasat të përfshihet dhe të ketë jetë në fondin e përgjithshëm aktiv të fjalësit të gjuhës sonë standarde kombëtare dhe në veçanti në stilin ekonomik (tregtar, financiar).

P ë r f u n d i m

Në burime të caktuara normative të gjuhës shqipe, për fjalë-termin **poslovanje** të serbokroatishtes zakonisht jepet barasvlerësi **veprimtari**, mirëpo meqë kjo fjalë e shqipes përdoret edhe për fjalë-termin **delatnost** të serbokroatishtes, me të cilin është më e lidhur tradicionalisht për nga barasvlerësia si dhe nga pikëpamja formale e ndërtimit, për t'i ikur homonimisë për **poslovanje** doli e nevojshme të kërkohet ndonjë barasvlerës tjetër. Për këtë nga disa përdorues pothuajse arbitrarisht filloi të përdoret fjala e huaj **afarizëm** duke i dhënë kësaj fjale në ligjërimin tonë një

specifikë të veçantë përdorimi, dukuri kjo që del e diskutueshme, pasi në gjuhë të huaja përdoret me ngjyime keqësuese kryesisht.

Meqenëse fjala **afarizëm** (serb. afarizam, huazim nga italishtja (affarisme) në gjuhë të ndryshme, siç u tha ka ose mund të ketë nuanca të ndryshme kuptimore, madje edhe me hijesë të dukshme keqësuese, atëherë me të drejtë vëhet në dyshim përshtatshmëria e përdorimit të kësaj fjale te ne, kur dihet fakti se edhe në italishte, sipas burimeve përkatëse u përdorka me kuptimin "veprimtari (ekonomike) me mungesë ndërgjegjje" (serb. nesavesno poslovanje) që del në sinonimi të përafërt me ndërkombëtarizmën "**spekulim**", atëherë në këtë punim u përkrah neologjizma e përfutur **veprimësi**, e cila i qëndron përballë fjalës **poslovanje** të serbishtes dhe qëndron në sinonimi të plotë me fjalës ndërkombëtare **biznes, menazhim** me origjinë angleze si dhe termave përkatës të gjuhëve të tjera të cilat shprehin konceptin e caktuar që ka të bëjë me "veprimtari lojale ekonomike (financiare) të ndërmarrjes a të asociacionit të caktuar".

Përfutimi i fjalë-termit **veprimësi**, i lindur nga nevoja dhe që nuk bie ndesh me strukturën fjalëformuese të emrave në shqipe, ka të gjitha parakushtet të jetë i pranuar në fondin e përgjithshëm të fjalësit të gjuhës sonë dhe sidomos në stilin e terminologjisë ekonomike. Së ketejmi u shpreh mendimi se kjo fjalë-term lypset favorizuar që të ketë shtrirje përdorimi në mbarë truallin e shqipes sonë standarde për konceptin e caktuar si sinonim i ndërkombëtarizmës **biznes, menazhim**.

Literatura e konsultuar (shkurtime dhe titujt e plotë):

1. Aleksiq, dr. Radomir, RSRI - Reçnik stranih reči i izraza, Beograd 1978.
2. Bashota, Nuri, Fjalor i terminologjisë ekonomike (dispencë), Prishtinë 1971.
3. Gorani, mr. Hajrullah, FTE - Fjalor i terminologjisë ekonomike, Prishtinë 1972.
4. Gorani, dr. Harullah, FTSHESSH - Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike serbokroatisht - shqip, Prishtinë, 1985; FTSHESH, Prishtinë, 1986.
5. Grup autorësh, RSHKJ - Re_nik srpskohrvatskoga knji_evnog jezika (1-6), Novi Sad (fototip) 1981.
6. Grup autorësh, Ekonomski leksikon, Beograd 1975.

7. Grup autorësh, Knjigovodstveni leksikon, Beograd 1975.
8. Grup autorësh, Priručni rečnik udruženog rada, Beograd 1980.
9. Grup autorësh, FSSH - Fjalor serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1974.
10. Grup autorësh, FGJSSH - Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.
11. Grup autorësh, FTJ - Fjalor terminologjik juridik serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1979.
12. Klaić, Bratoljub, VRSR - Veliki rječnik stranih riječi, Zagreb 1978.
13. Ndreca, Mikel, Fjalor shqip -serbokroatisht, Prishtinë 1976.
14. Nouveau petit Larousse, Paris 1969.
15. Sjeran, Reçnik italijanski - srpskohrvatski, Cetinje 1983.
16. Voci, Hysen, Fjalor italisht - shqip, Tiranë 1980.

26. “PËRKTHIMI I AUTOMJETIT”, SIZHARGON I PAQËNDRUESHËM TERMINOLOGJIK

Në gazetën "Bujku" të dt. 17.II.1995, f.16 një firmë, e cila në realitetin tonë nuk është e vetme për veprimtari të tillë, reklamonte se përveç punëve e shërbimeve të tjera bën edhe "përkthimin e sigurimin e automjeteve". Meqenëse sizhargoni "përkthimi i automjetit" ka përdorim mjaft të gjerë te ne, e ndeshim si reklamë edhe në ndërtesën e ish-bankës së Lubjanës - Prishtinë dhe në dy tre vende të tjera jo larg saj, e shoh të arsyeshme ta diskutoj qëndrueshmërinë e tij. E quajta sizhargon kushtëzimisht, ngase shprehja e tillë del e shpifur si pjellë spontane e jo si një krijim i posaqëm, edhe pse ka përdorim të kufizuar në zhargonin e stilit juridik "profesional" te ne.

Duke u nisur nga fakti se në gjuhë asgjë nuk krijohet pa shkak, pa nevojë të brendshme ose pa ndonjë trysni të jashtme, lind pyetja pse te ne filloi dhe vazhdon të përdoret edhe sot e kësaj dite shprehja në fjalë? Pra, vazhdon së përdoruri edhe pse kjo shprehje që në dukje, si togfjalësh i veçuar, del pa mbështetje logjike, ngase siç dihet s'ka se si të bëhet "përkthimi i automjetit", madje shprehja e tillë nuk mund të arsyetohet as metonimisht. Po them metonimisht, d.m.th. në mënyrë të fytyruar, se në fakt nuk kemi të bëjmë as me përkthimin e dokumentacionit eventual që mund të lidhej kuptimisht me automjetin, por është fjala për një proces tjetër që ka të bëjë me ndërrimin e pronësisë ndaj automjetit, d m.th. nga një pronar kalon pronësia te një pronar tjetër. Veprim ky që bëhet në bazë të kontratës së shitblerjes ose të ndonjë dokumentacioni tjetër. Në serbishte, prej nga padyshim është përfutur sizhargoni në fjalë, përdoret fjalë - termi prenos: (*prenos i osiguranje kola*).

Fjala **prenos** në serbishte ka polisemi mjaft të zhvilluar që në shqipe, sipas FSSH 1974, i përgjigjen këta barasvlerës: "*mbartje, transferim, transmetim, të barturit; jur. të kaluarit e një të drejtë*". (Aty f. 621.) Në *Fjalorin terminologjik juridik serbokroatisht - shqip*, Prishtinë 1979,

ndeshim të shënuar barasvlerësit: "prenos prava - kalimi i të drejtës"; "prenos svojine - kalimi i pronësisë" (Aty f.124), kurse në *Fjalorin e termave dhe shprehjeve ekonomike serbokroatisht - shqip* të Dr. Hajrullah Goranit, Prishtinë 1986, ndeshim: "prenos vlasništva - mbartje e pronësisë" (Aty f.197). Së këtejmi del se fjalët **kalim** dhe **mbartje** dalin si fjalë të barasvlershme për **prenos** të serbishtes, mirëpo për **prenos vozila** as njëra as tjetra nuk i përshtaten dot logjikës, pasi që fjala kalim "kalimi i automjetit" ose mbartje "mbartja e automjetit" shprehin koncepte të tjera e jo atë që shprehet në serbishte me "prenos vozila". Atëherë, sigurisht nga nevoja intuitivisht u kërkua ose po kërkohet doemos fjalë tjetër dhe në këtë kuadër do të jetë *përzgjedhur* a imponuar fjala **kthej kthim**. Ç'është e vërteta, fjala **kthej kthim** në gjuhën tonë për konceptin në fjalë del më e pranueshme se dy të parat, ngase me fjalën **kthej** sipas FGJSSH-së mund të shprehet edhe koncepti: marr ose "jap diçka që i kam marrë dikujt a që më ka dhënë dikush". (Aty f.899.) Së këtejmi, si duket asociacionisht edhe nën ndikimin formal ndërtimor të fjalës **prenos** të serbishtes (*pre+nos(iti)* ; nositi- *baj me bajtë*; prenošenje - *mbartje*) në shqipe spontanisht doli parashitesa **për-** , për+kthej – për+kthej(!), e cila do të mund të arsyetohej mbase nga konteksti, edhe pse siç dihet krijon homonimi të vrazhdë me fjalën e mirëfilltë: **përkthej përkthim** d.m.th. "kthej diçka nga një gjuhë në një gjuhë tjetër" (Aty f.1444). Kështu pra, supozoj se mund të jetë përfutur ose shpifur togfjalëshi "përkthim i automjetit" qëndrueshmëria e të cilit po kontestohet këtu me të drejtë, ngase fjala *përkthim* krijon homonimi dhe sjell ngatërresë kuptimore pa nevojë fare.

Për të mos e zgjatur më shumë po përmend mendimin tim se si është dashur të veprohej apo edhe si duhet të veprohet sot e nesër në rastin konkret për të zgjidhur si duhet këtë çështje.

Së pari, mendoj unë, duhen konsultuar apo duhet kërkuar zgjidhje nga burimet kompetente të gjuhës sonë letrare kombëtare, mbase: "**pronësim-shpronësimi i automjetit**", barasvlerësi kjo që do të mjaftonte.

Së dyti, nëse ende nuk kemi zgjidhje të prerë duhet pasur parasysh atë që u tha më sipër që në stile e kontekste të caktuara për konceptet: "prenos vlasništva" ose "prenos svojine" në shqipe duhet të përdoren barasvlerësit: "kalimi i pronësisë (së automjetit)" ose "mbartja e pronësisë (së automjetit)" e kështu me radhë.

Së treti, për **prenos kola** (vozila), pasi që sizhargoni togfjalësh "përkthimi i automjetit" assesi nuk qëndron, duhet kërkuar zgjidhje tjetër më të pranueshme. Meqenëse, siç u tha pak më sipër, fjala **kthej kthim** kuptimisht dilte më e pranueshme për konceptin në fjalë kundrejt barasvlerësve të tjerë, mendoj se mund a duhet të ruhet trajta **kthim**, por e parashoqëruar jo me parashtesën **për-** por me parashtesën **ndër-** dhe se ky zëvendësim bëhet jo vetëm për arsye të thjeshtë që t'i iket homonimisë, siç u cek më sipër, por për arsye se pikërisht parashtesa **ndër-** është ajo e cila del e specializuar për formimin e fjalëve, me të cilat tregohet "diçka që ndodh a vepron "në mes të të tjerave a që "ka marrëdhënie të dyanshme në mes të dy gjërave (FGJSSH f.1207.), koncept ky që përputhet pothuajse plotësisht me kontekstin që u trajtua këtu, ngase me "prenos kola" pra me "**ndërkthim të automjetit**" siç doli si propozim - zgjidhje në këtë punim, kemi të bëjmë me marrëdhënie të të dy palëve , d.m.th. të blerësit dhe shitësit si dhe me palën e tretë, e cila profesionalisht a zyrtarisht mundëson kryerjen e procesit të *pronësim-shpronësim*it në fjalë. Parashtesa **për-** në raste të caktuara del në kundërvënie me prapashtesën **ndër-** pasi që parashtesa *për-* përdoret për nënfusha të tjera semantike, të cilat zakonisht nuk lidhen kuptimisht me "marrëdhënie të dyanshme në mes të dy gjërave", siç u cek më sipër për parashtesën **ndër-**.

Gjithsesi përdorimi i fjalës përkthim "përkthimi i automjetit" nuk qëndron ndërsa "ndërkthimi i automjetit", duke e dalluar trajtën "ndërkthim" si fjalë të re, po të favorizohet për konceptin në shqyrtim si konkurrent lojal për **pronësim-shpronësimin** e automjetit, ma merr mendja se ka gjasa të mund të integrohet në fondin aktiv të fjalësit të gjuhës sonë letrare, sidomos në fushën e terminologjisë juridike, por edhe më gjerë.

Sidoqoftë, togfjalësi terminologjik **prenos kola** ka barasvlerësi me **pronësim-shpronësim automjeti** ose me **ndërkthim automjeti** dhe kurrseksi me *përkthim automjeti*(!!?).

27. FJALORAT E HAJRULLAH GORANIT - KONTRIBUT MADHOR PËR TERMINOLOGJINË EKONOMIKE

Mund të thuhet se qysh para 20 vjetësh Hajrullah Gorani bëri emër në fushën e terminologjisë ekonomike, kur publikoi vepërzen "Fjalorth i termave dhe i shprehjeve kontabile", mirëpo emri i tij u nderua edhe më shumë pesë vjet më vonë me veprën "Fjalor i terminologjisë ekonomike serbokroatisht - shqip (1972), vepër kjo e parë kësodore në gjuhën tonë, e cila pati jehonë dhe luajti rol të rëndësishëm në vendosjen dhe konsolidimin e terminologjisë tekniko-shkencore në lëmin e ekonomisë, sidomos ndër ne. Ndërkohë profesor Hajrullah Gorani botoi edhe ndonjë punim teorik-shkencor po ashtu nga fusha e terminologjisë ekonomike, punime këto që për nga metoda dhe përmbajtja mund të vlerësohen në gjuhën tonë si ndihmesë e konsiderueshme jo vetëm në lëmin e terminologjisë ekonomike, por edhe në terminologjinë teknike - shkencore në përgjithësi.

Nëse veprimtaria e tij e kësaj periudhe në këtë lëmë do të krahasohet me një mozaik arkitektural të një stili të ri, atëherë me botimin e fjalorëve: *Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike shqip - serbokroatisht* (1985) dhe *Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike serbokroatisht - shqip* (1986), që vitin e kaluar u vunë në qarkullim dhe përdorim, autori mbi bazën e veprës së tij mozaike mbindërtoi një godinë vërtet madhore leksikografike, me të cilën nuk nderohet vetëm emri i tij, por nderohet edhe shoqëria që i takon, në të cilën jeton e vepron ai.

Nga lënda e konsultuar në fjalorët e sipërcekur dhe nga parathënia e tyre si dhe nga intervista e tij që u botua në gazetën "Rilindja", më 4.X.1986, f. 12, del se dr. Hajrullah Gorani në këta fjalorë ka përfshirë një lëndë mjaft vëllimore. Vetëm në versionin serbokroatisht - shqip, thekson autori, janë përfshirë "mbi 30 mijë terma e shprehje ekonomike", kurse versioni tjetër, shpjegon ai "është më i pasur", përkatësisht për lëndën e fjalorit "janë formuar 80 mijë skeda në të dy gjuhët", gjë që tregon se autori ka bërë punë me përkushtim. Përveç termave dhe shprehjeve më të përdorshme të të gjitha lëndëve profesionale që përfshihen në programin

mësimor të Fakultetit Ekonomik të Prishtinës, siç thekson ai, në fjalorë janë përfshirë, edhe pse në një masë mjaft të kufizuar, edhe terma e shprehje nga *e drejta, gjeografia ekonomike, demografia, statistika, matematika, bujqësia*", pastaj edhe nga "*elektroekonomia, mjekësia e gjuhësia*", por që termat e shprehjet e caktuara "lidhen në njëfarë mënyre me termat ekonomikë".

Nga sa u tha më sipër del se fjalorët në shqyrtim kanë lëndë më të gjerë sesa ajo që i takon natyrës së ngushtë ekonomike. Edhe pse për ndonjë term periferik mund t'i bëhet vërejtje, qoftë nga pikëpamja e fjalëformimit, qoftë edhe nga ajo e formëzimit, ngase nuk duket se kanë aq lidhje të domosdoshme me çështje ekonomike, por qëndrimi i autorit mund të arsyetohet pasi që ai kishte parasysh mungesën e fjalorëve profesionalë të fushave të tjera të caktuara dhe se në këtë mënyrë, mendon ai, më së miri mund t'u dalë në ndihmë "përdoruesve potencialë" të fjalorëve të tij që në radhë të parë për këtë si "përdorues" përmend studentët e fakultetit ekonomik, pastaj kuadrot që "punojnë në organizatat e punës së bashkuar dhe në institucione të ndryshme", si dhe përkthyesit, të cilët përfaqësojnë një "kategori bukur të gjerë të punonjësve".

Me një fjalë, vepra e tij më e re (dy vesionet) ka karakter praktik dhe njëherësh edhe normativ, ngase siç e cek autori "fjalori pos tjerash do të ndihmojë shumë njëjtësimin, përvetësimin dhe stabilizimin e terminologjisë ekonomike në të gjitha trevat e banuara me shqiptare në Jugosllavi". Gjithsesi vepra në fjalë do të jetë ndihmesë e rëndësishme edhe për mbarë truallin e shqipes.

Për një sukses të tillë premtion edhe vetë orientimi i drejtë i autorit, i cili praktikisht përkrah prirjen aktuale të mënyrave të fjalëformimit të gjuhës sonë, siç janë edhe trajtat":

administrues, montues, analizues, aktivizues etj. kundrejt atyre:

administrator, montator, analizator, aktivizator

duke u dhënë përparësi trajtave të para.

Çështje e vërteta, tërë lënda është shënuar (pothuajse krejtësisht) sipas rregullave drejtshkrimore, madje kontributi i autorit është edhe më i madh kur dihet fakti se ai bëri punën jo vetëm si hartues a sistemues i fjalëve dhe i shprehjeve të gatshme a të vjela nga burimet e caktuara, por njëherazi paraqitet edhe si farkëtues i termave të caktuar, madje edhe si përvetësues i shumë neologjizmave, si p.sh.:

endëtoare, kursimtoare, mishtore, vegëltore,

litartore, pengtoare, tertore etj.

që janë emërtime të lokaleve të veprimësive përkatëse të ndërtuara me prapashtesën speciale -TORE.

Po cekim edhe disa fjalë të reja me kuptim abstrakt me prapashtesën -SI:

veshtimësi (opreznost), qëllimësi (svrsishodnost), ekonomësi (ekonomičnost), rremësi (lažnost), parimësi (načelnost) etj.,

pastaj

qëllimobj (ciljati), mbipaguaj (preplatiti), përshitje (rasprodaja), përzgjedhje (prebiranje, odabiranje), urdhër-udhëtimi (putni nalog) etj.

Zgjon vëmendjen edhe ndonjë shembull karakteristik, ku shihet shkathtësia a gjindshmëria e autorit si p.sh.:

arkëtar (blaganik) dhe arkëtues (inkasant), ofruës (nudilac) dhe ofertues (ponudilac), pastaj shprehjet: **çështje e pazgjidhshme (nerešivo pitanje) dhe çështje e pazgjidhur (nerešeno pitanje)** etj.

Neologjizmat që u cekën më sipër, të cilat autori i ka konsideruar si të domosdoshme në stilin ekonomik, kanë prirje të përhapen në mbarë gjuhën tonë.

Nëse vetëm sillet ndërmend e vërteta se çdo term a shprehje terminologjike që është lëndë e fjalorit është në vetvete njëfarë kontributi, atëherë kuptohet më së miri edhe rëndësia që ka kjo vepër e rrallë dhe unike në gjuhën tonë, mirëpo edhe kjo nuk është krejtësisht e plotë dhe pa të meta, gjë që e pranon edhe vetë autori, kur thotë se "Jam i vetëdijshëm se fjalori nuk është i plotë dhe i përsosur. Ai ka të meta, madje mund të ketë edhe pasaktësi"

Mirëpo është e vërtetë se pesha e të metave që ka vepra është shumë më e vogël në krahasim me anët e mira që ka ajo. Megjithatë mendoj se është me interes të cekem ato të meta, madje më karakteristiket, me qëllim që pas mënjanimit të tyre vepra do të dalë më e përkryer dhe "mozaiku arkitektural i mbindërtuar" i veprës së Goranit do të marrë ngjyrë dhe shkëlqimësi edhe më joshëse.

Në këtë kuadër së pari po cek disa gabime shtypi, të cilat dallohen lehtë, si p.sh.: stabilzoi (stabilizoi), shkakrim (shkarkim), promtraç (promatraç), zenetlija (zanatliu), kretak rok (kratak rok) etj., pastaj bie në sy

edhe ndonjë përsëritje e fjalëve si p.sh.: fjala *elektroteknik* është shënuar dy herë, ashtu si edhe fjala *zëvendës* etj.

Problem më vete paraqesin disa lëshime shtypi a lektorimi, gabime këto që ndonjë përdorues i papërgatur mund t'i pranojë e përvetësojë ashtu duke i konsideruar si trajta të drejta. Ja disa shembuj, ku në kllapa i kam shënuar trajtat e drejta: kalë fuqi (kalë-fuqi), zëvendës i drejtorit (zëvendësdrejtor), shëndetsoj (shëndetësoj), çekiç (çekiç), mjete vetiake (mjete vetjake), preneseljiti (prenaseljiti), pastaj: libri i gjedhjeve (libri i gjedheve), oroçenje (uroçenje), magacionim (magazinim) mbipagoj (mbipaguaj), stenodaktilograf (stenodaktilografist), profesionalist (profesionist), punishte (punishtë), hotelier (hotelist) etj.

Përveç lëshimeve të natyrës së mësipërme kemi edhe ndonjë rast të mospërshtatjes së mbiemrit ndaj emrit edhe sa i përket numrit edhe sa i përket gjinisë etj.

Sidoqoftë, mendoj se mbetet çështje e hapur se si duhet të regjistrohen në fjalor shprehja a emërtim perifrastik d.m.th. në trajtën e shquar apo në atë të pashquar a të dyja?. P.sh.:

- prodhimtaria e kapitalit apo prodhimtari e kapitalit;
- punishtja (punishta) e ndeqjeve " punishte (punishtë)e ndreqjeve;
- prona e madhe " pronë e madhe.

Ndeshet ndonjë rast si te termi "**postupak**", i cili nuk është shënuar si term mbartës, por është vënë në një çerdhe me termin **postrojenje**, pastaj për barasvlerësin **punues** në serbokroatishte është shënuar edhe trajta **radni**, e cila nuk është e shënuar veçan si mbiemër, por është vënë si emër, mbase në vend të trajtës **radnik**. Po ashtu për termin **drejtues** të shqipes në serbokroatishte është dhënë vetëm barasvlerësi si mbiemër e si emër jo.

Në fjalorin përkatës ndeshim ndonjë emërtim të shënuar në trajtë të diskutueshme, p.sh. mëndafshar në vend *mëndafshpunues* a *mëndafshhtar*, dhenar në vend *bari delesh* ose *dhenruajtës* etj.

Disa emërtime profesionale, edhe pse në FGJSSH janë shënuar si fjalë a shprehje të vjetëruara, në fjalorët e Goranit kanë gjetur favorizim, si p.sh. barrëtor, në vend *mbartës* ose *hamall*, arnesar në vend *arnues*, bukatar

në vend *bukëtar* ose *bukëpjekës* a *bukëshitës*, pagator mbase më drejt: *pagues*, dorëzapunues në vend *dorezapunues* etj. - emërtime këto që nuk është nevojë e domosdoshme të ripërtërihen, pasi që trajtat e tjera janë më të parapëlqyeshme, sipas ligjësive të sistemit të tashëm fjalëfomues të letrarishtes së sotme dhe se detyrë e fjalorëve normativë është paraqitja e lëndës aktuale e jo thesari i trajtave të së kaluarës.

Në fjalor si barasvlerës i shprehjes *visoko obrazovanje* del përgjegjësi **arsimi i lartë**, trajtë kjo që del e diskutueshme, pasi që në realitetin tonë gjuhësor kemi opozicionin: **visoko obrazovanje** (arsimim superior a lartësor - me fakultet) dhe **više obrazovanje** (arsimim i lartë, më shkollë të lartë e me shkallën I të fakultetit).

Nuk di sa do të zërë vend neologjizmi **ditimore** për *obdanište*, kur për këtë nocion tashmë kemi termin e njohur **çerdhe e fëmijëve** dhe **kopsht i fëmijve**.

Më duket se barasvlerësi **amortizatorët e makinës** për **amortizeri za vozila** nuk qëndron në stilin zyrtar, pasi që në të vërtetë, ne tashmë kemi amortizatorë për makina të ndryshme, si p.sh. amortizatorë për makina larëse (amortizeri za vešmašine) etj., prandaj barasvlerësi togfjalësh **amortizeri za vozila** në shqipe duhet të përcaktohet me shprehjen: **amortizatorë për automjete** (automobila).

Ç`është e vërteta, për emërtime të veçanta, sidomos nga lëmi tekniko-teknologjik e ndonjë tjetër kemi vërejtje, por këtu nuk do të cekem raste të tjera.

Tash do të përmend një çështje tjetër. Nuk dimë për rrethanat rreth hartimit dhe botimit të versioneve të caktuara të veprës në fjalë, mbase mund të ekzistojë ndonjë arsye bindëse, por konstatojmë se versionet në fjalë nuk janë të harmonizuara dhe kjo praktikë del si e metë jo e vogël e fjalorëve, shikuar nga aspekti praktik. Ç`është e vërteta, barasvlerësit përkatës në versionet përkatëse nuk janë identikë, madje në shembuj të caktuar barasvlerësit paraqiten si të mangët. P. sh. për **duvandjinica** në njërin version del barasvlerësi **duhanore**, kurse në tjerin **duhantore**, për **alatnica** vetëm në njërin version kemi barasvlerësin **vegëltore**, e në tjetrin jo. Po ashtu edhe barasvlerësit: **këshilltar** - **odbornik**, **detyrim** - **obaveza**, **uroçena sredsdtva** - **mjete të afatëzuara** etj. dalin të shënuar vetëm në njërin version të fjalorit.

Me fjalë të tjera, harmonizimi i teksteve paraqitet i domosdodhëm edhe për shkaqe shkencore, përveç arsyeve praktike.

Autori në një rast thekson se në "fjalor nuk mund të regjistrojë të gjitha fjalët apo termat që ekzistojnë, meqenëse ato krijohen përditë", gjë që është plotësisht e vërtetë, ashtu siç është e vërtetë edhe konstatimi tjetër se "nacionet që ekzistojnë dhe që për ditë shfaqen në gjuhët e ndryshme, nxisin nevojën që këto nocione të përdoren edhe në gjuhën tonë, prandaj dhe duhet të bëhet emërtimi i drejtë i tyre". Dhe në vazhdë të këtyre konstatimeve do të propozonim që në fjalorët e tillë të përfshihen edhe termat si më poshtë, me të cilët ngaherë jemi duke u ballafaquar në jetën tonë të përditshme:

- dohodak po glavi stanovnika - të ardhurat për frymë të popullsisë;
- posluga poverenim sredstvima - shërbimi (huapërdorja) me mjetet e kredituara;
- jednokratani ugovor - kontratë e njëhershme;
- domar zgrade (objekta) - mirëmbajtës objekti (ndërtese);
- skladištar - depoist, ndërsa magacioner - magazinier;
- iskazivanje dohodtka - dëshmimi i të ardhurave;
- izvršioc poslova i radnih zadataka - kryerës i punëve dhe detyrave;
 - mala ekonomija - biznes i vogël a ekonomi e vogël etj.

Çështje më vete do të dilte problemi rreth vënies në jetë ndër ne të një sërë termash e shprehjesh që janë më pak të njohura e që për disa kemi trajta të tjera si p. sh.: livroj (liferoj), premi (prim), pastaj aktlindje, aktmartesë, aktvdekje, aktpronësi etj. për nocionin e të cilave po përdoren ndër ne terma perifrastikë të përkthyer nga serbokroatishtja si p. sh. aktlindje: izvod iz matične knjige rodjenih - ekstrakt nga libri amzë (themeltar) i të lindurve etj.

Pra nga sa u tha mbetet detyrë të bëhet njësimi, përkatësisht aplikimi i termave si më sipër, madje njësimi duhet zbatuar pa kurrfarë ngurrimi për të gjithë termat e regjistruar apo të pranuar në gjuhën tonë letrare, përveç atyre që mund të paraqesin ndonjë veçori specifike për shkak të sistemit të ndryshëm shoqëror e ekonomik, apo për shkak të ndryshimit të raporteve shoqërore-ekonomike.

Po përfundoj me konstatimin se për veprat madhore, siç janë konkretisht fjalorët e rinj të dr. Hajrullah Goranit, është mirë që para se të botohen a të ribotohen të organizohen tribuna apo forma të tjera të përshtatshme, ku do të jepeshin vërejtje sugjerime nga personat kompetentë, vërejtje këto që do t'i ndihmonin autorit t'i mënjanojë të metat eventuale. Po kështu duhet vepruar edhe aktualisht lidhur me fjalorët në fjalë, me qëllim që t'u bëhet jehonë termave e shprehjeve më pak të njohura e karakteristike, në mënyrë që të jetësohen sa më shpejtë në të gjitha sferat e jetës në shoqërinë tonë dhe të vihet gishti në ndonjë lëshim që mos të përsëritet më.

Puna e frytshme e H. Goranit le të jetë nxitje dhe inkurajim edhe për kuadro të tjerë, në mënyrë që të përshpejtohet botimi i fjalorëve të tjerë të caktuar të dijës e sidomos nga lëmi i terminologjisë shkencore - teknike-teknologjike.

(Prishtinë, 30. II. 1987)

28. RRETH PRANISË SË EMËRTIMEVE TË HUAZUARA TË MJETEVE TEKNIKE NË BURIMET E SHQIPES LETRARE

Në kuadër të fjalëve të huazuara në gjuhën shqipe bëjnë pjesë, madje në mënyrë të theksuar, edhe fjalët e huazuara të mjeteve teknike. Me termin "mjete teknike" në këtë artikull kuptohen emërtimet e veglave, aparateve, pajisjeve, por edhe të ndonjë përdorëseje, të cilat në gjuhën tonë, qoftë si fjalë të karakterit universal, qoftë të karakterit specifik, kanë hyrë në përdorim të përditshëm dhe tashmë dalin të shënuara edhe në fjalorët tanë normativë përshkrues të gjuhës letrare. Për këtë arsye, me qëllim që të kemi pasqyrë më të qartë rreth emërtimeve në fjalë ne konsultuam lëndën e burimeve normative që nga vitet `50 e këndej, d.m.th. konsultuam lëndën nga "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954), Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), Fjalori shqip-serbokroatisht (1981), dhe Fjalori i shqipes së sotme (1984), por nuk lamë pa prekur edhe lëndë nga ndonjë burim tjetër normativ, siç është Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (1976). Mirëpo para se të kalojmë në analizën e lëndës konkrete që e volëm nga burimet përkatëse të kësaj periudhe e shoh të nevojshme të cek faktin se gjuhësia jonë ka konstatuar që me kohë që disa emërtime veglash (mjetesh teknike) dalin të trashëguara qysh nga epoka parahistorike (indoevropiane) e gjuhës shqipe, siç janë fjalët autoktone: *fyell*, *dry(n)*, *ushtë*, *thikë* si dhe vetë fjala *vegël* (*vegjë*), madje disa dalin si interferenca fjalësh të huazuara që në epokën historike nga gjuhët në kontakt, siç janë ndërferkimet:

- nga *gjuha lashtogreke*: mokën, drapër, gjilpërë, lemsh, dërrasë, pip e ndonjë tjetër,

- nga *gjuha latine*: daltë, baltë, gardh, furkë, tjegull, farkë, parmendë, qerre;

- nga *gjuhët sllave*: kyç, kosë, kovë, lopatë, vedër, saç, sitë, çekan, etj.,

- nga *gjuha turke*: dufek, fitil, tel, gajtan, bajrak etj.

- nga *gjuha italiane* si: këmborë, barkë, timon, vapor, vel, breshanë trumbetë, pushkë /sqyleht /(shish!) etj.

Sigurisht emërtimet e tilla të vjetra të mjeteve teknike që u c ekën më sipër nuk do të konsiderohen si emërtime të huazuara me cilësi barbarizme ose si novitete, sepse ato tashmë si fjalë-terma të fjalësit aktiv të shqipes në ndjenjën e sotme gjuhësore konsiderohen si fjalë të shqipes, jo vetëm pse ndonjëri shembull mund të dalë i diskutueshëm edhe sa i përket autoktonisë (siç janë b.f. disa shembuj nga latinishtja vullgare ose nga helenishtja, të cilat lypsen sqaruar), ngase siç e thotë Prof. Selman Riza, *shqipja nuk është bijë e latinishtes vullgare, por asht motra e madhe e latinishtes së lashtë* (S. Riza, Vepra 1 Prishtinë 1996, f. 29), por edhe për arsye se fjalët e tilla që me kohë janë përvetësuar dhe tashme kanë zënë rrënjë në fondin aktiv të shqipes, duke pësuar ndryshime të mëdha, qoftë në fizionominë e tyre shkrimore e shqiptimore, qoftë në zhvillimin e tyre semantik. Ç`është e vërteta, edhe mjaft fjalë-terma (si fjalë të huazuara) të moshës më të re duke qenë të regjistruara në burimet normative të gjuhës sonë letrare (d.m.th. në fjalorët përshkrues normativë) ato mund të nënkuptohen a të konsiderohen si fjalë të fondit aktiv të fjalësit të gjuhës sonë të përditshme letrare, edhe pse nga kjo sirregull për ndonjë rast mund të shprehet rezervë, siç do të shohim në vazhdim, megjithatë këto huazime të reja të gjuhës teknike do të trajtohen në këtë artikull si fjalë të huazuara. Këtu është fjala për mjaft emërtime veglash moderne, të cilat si ndërkombëtarizma të mirëfilltë janë bërë ose po bëhen pjesë organike e gjuhës (terminologjisë) teknike të të gjitha gjuhëve moderne të botës, siç janë b.f. emërtimet si: kompjuter, helikopter, raketë, televizor etj. etj.

Sidoqoftë, emërtimet e kësaj natyre, edhe pse huazohen sipas mënyrës së ashtuquajtur *transfer*, ato nga fjalorhartuesit që kanë për temë gjuhën standarde duhet të jenë të përqafueshme, kurse termat si emërtime të mjeteve teknike që u takojnë sferave të ngushta profesionale, gjithsesi, mbesin më pak të vërejtura e të përfaqësuar në burimet e tilla, pikërisht në këtë segment shfaqen çështje të diskutueshme. Ç`është e vërteta, në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954) ndeshim të shënuar një numër jo të madh të emërtimeve të mjeteve teknike të tipit në shqyrtim. Përveç mjeteve të transportit siç janë ndërkombëtarizmat:

aeroplan, autobus, automobil, lokomotivë, telefirik
dalin edhe këto emërtime mjetesh teknike si p.sh.:

elektrik, gramofon, makinë, hidroavion, minë, motor, motoçikletë, radio e radioaparati, raketë, vagon,

si dhe emërtime edhe më të specifikuara si b.f.:

reflektor, gjenerator, radiator, shaptilograf, tastjerë, turbinë, trimotor, ventilator, voltmetër, mashinë e mashinkë(!), aerostat, antenë, aerometër, frezë, motovile, helikë, hidroavion.

Shikuar nga kriteret e sotme nuk di arsyen pse në atë burim dalin të shënuar shembujt si b.f.: *hidroavion, mashinkë, voltmetër* e ndonjë tjetër, për të cilët mund të thuhet se për hir të specifikës së përdorimit që kanë nuk ishin aq të domosdoshëm të përfshiheshin në fjalorin përshkrues normativ të tipit të vogël, siç ishte fjalori në fjalë. Pikërisht mbase kjo është arsyeja pse emërtimet e tilla në *Fjalorin* e shqipes së sotme (1984) nuk vazhdojnë të kenë prani. Mirëpo tashti, d.m.th. 30 vjet më vonë, në tekstin e burimit 1984 përveç disa emërtimeve të "reja" që nuk ishin në burimin e mëparshëm si:

cisternë, helikopter, motobarkë, hidroplan, gondolë, eskavator, skreper triçikël si dhe: bllok, balonë, kalandër, detal etj., pastaj: diferencial, furnelë, matricë, magnetofon, manivelë, monometër, monotip, presë, parafango, periskop, neon (llampë), rëntngen, robot, semafor, stabilizator, shabllon, televizor, transistor etj.,

edhe pse për disa nga emërtimet e specifikuara në këtë burim mund të shprehet rezervë, megjithatë nga shembujt e regjistruar fitohet njëfarë ideje se cilat mjete teknike kishin hyrë në përdorim të përgjithshëm ndërkohë në fazën e caktuar deri edhe kur është hartuar fjalori.

Sa për kërshëri po e cek faktin se në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe (1976) i ndeshim edhe këto emërtime të veglave teknike, të cilat nuk u përfshin në FSHS (1984):

autokarro, amplifikator, kompjuter, kalorimetër, kinoapar, radiosondë, raditeleskop, termostat, turbokompresor, markshajder, presë-filtër, hidrovor, elektroskop, radioteleskop, stereoskop, e ndonjë tjetër.

Në FSHSK (1981) jo vetëm se ka më shumë emërtime të sendeve teknike se sa kishte në FGJSH (1954), por ka më shumë edhe në krahasim me lëndën e përfshirë në FGJSSH 1980, e aq më tepër kundrejt lëndës së përfshirë në FSHS (1984) për shkak të sasisë më të vogël të numrit të fjalëve të përfshira në fjalorin e fundit. Kështu, pra në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981) del një numër mjaft i madh i emërtimeve të mjeteve teknike dhe kjo është bërë jo pa qëllim nga vetë hartuesit, ngase siç e theksojnë vetë ata, këtë e kanë bërë për të mbuluar sadopak nevojat praktike, sepse mungonin fjalorët teknikë profesionalë të disiplinave të caktuara teknike- shkencore-

ekonomike etj. Me qëllim po cek faktin se në këtë fjalor janë përfshirë mbi 30 shembuj që kanë siprapashtesën *-metër*, tipi **aerometër (ajrmatës)**; afro 10 me siprapashtesën *-graf*, tipi: **cinkograf**; afro 20 me *-skop*, tipi **aeroskop**; me fundorin *-tor (-or)*, tipi **motor**, mbi 30 shembuj; me *-er* fundor, tipi **frigorifer** mbi 10 shembuj e të tjerë. Lidhur me këtë vlen të theksohet fakti se fjalët (siprapashtesat e huazuara) *-metër*, *-graf*, *-skop* si dhe fundorët *-tor (-ator,-or)* në gjuhën tonë nuk duhen konsideruar si prapashtesa a siprapashtesa vendëse a të përvetësuara, sepse ato janë, në të vërtetë, elemente të transferuara, si pjesë të pandashme nga fjala a rrënja që e passhoqërojnë. Në shqipe dalin siprapashtesa e prapashtesa të tjera, të kalkëzuara ose jo, siç janë barasvlerësit: *-matës*, *-shkrues*, përkatësisht *-ues(e)*, *-or(e)* etj. si dhe prapashtesa të tjera të mirëfillta të shqipes.

Edhe në gjuhë të huaja, por edhe në gjuhën tonë fjalët ndërkombëtare me cilësi ndërkombëtarizmi ose pa të e kanë vendin në fjalorët përkatës të ashtuquajtur "*fjalor të fjalëve ndërkombëtare*". Siç dihet te ne u botuan dy fjalorë të këtij tipi: *Fjalor i fjalëve dhe i shprehjeve të huaja* (nga M. Ndreca) dhe *Fjalor i fjalëve të huaja* (nga Instituti Albanologjik i Prishtinës - grup autorësh).

Nga konsultimi që i bëra lëndës së përfshirë në këta dy fjalorë rezultoi fakti se janë afro 50 emërtime të mjeteve teknike që ndryshojnë, përkatësisht që nuk janë përfshirë në versionin përkatës. Kështu pra nëse hartohet një fjalor i ri unik i këtij tipi në gjuhën tonë duhet të shfrytëzohet lënda nga të dy burimet (versinonet) e fjalorave në fjalë, sepse dalin nja 100 zera të rinj me sqarimet e duhura, ndonëse për mendimin tim sqarimet duhen plotësuar, qoftë me të dhëna të reja, qoftë me formulime më të goditura.

Shfrytëzohet rastin të shpreh një mendim timin si vërejtje qëllimmire. Në të ardhmen fjalorët e tipit të tillë duhen qëruar nga fjalët që janë përfshirë a zhvillime brenda shqipes mbi bazë të fjalë-temës së huazuar, ngase ato (zhvillimet në gjuhën shqipe) s`duhen konsideruar më si fjalë të huaja e aq më tepër ndërkombëtarizma, ngase ato janë fjalë të zhvilluara brenda shqipes. Për këtë do të mjaftohem me sjelljen e një shembulli konkret: fjala **frezë**, si emërtim mjeti teknik është fjalë ndërkombëtare e huazuar, ndërsa zhvillimet si: folja *frezoi*, prejfoljorët: *frezim*, *frezues*, *frezimtari* etj., janë lentime të vetë shqipes, prandaj rrjedhojat e tilla mund të shënohen (si syth) sa për sqarim, por assesi s`duhen konsideruar si fjalë të huaja (të huazuara), aq më tepër të shënohen si zëra më vete në fjalor, siç ka ndodhur jo në pak raste në burimet në fjalë. Madje në fjalorët e tillë duhet vënë kujdesin jo vetëm anës etimologjike të fjalës, por edhe rrugës nga cila gjuhë do të ketë

hyrë në shqipe, ngase fjala e caktuar mund të ketë origjinë latine, greke, arabe, persiane etj., por në gjuhën tonë zakonisht do të ketë hyrë, qoftë nga italishtja, frëngjishtja, anglishtja, osmanishtja, ose nga ndonjë gjuhë sllave, rusishtja, sebishtja, e ku ta di, prandaj faktet e tilla del e nevojshme të shënohen, sqarohen.

Vërejtjet e mësipërme vlejné edhe për fjalorët e profillit të ngushtë tekniko-teknologjik, (sipas degëve përkatëse), burime këto në të cilat emërtimet e mjeteve teknike e kanë vendin të pasqyrohen në mënyrë sa më të plotë, ndonëse në këtë artikull ne veçnam me qëllim vetëm **emërtimet e huazuara të mjeteve teknike** dhe lidhur me këtë përfundojmë, duke tërhiqur vëmendjen në këto pesë pika:

Së pari, të bëhet jo vetëm ndjekja, por edhe regjistrimi i veçantë i mjeteve të huazuara teknike, sipas degëve e profilizimeve të caktuara, duke filluar nga mjetet teknike të punës që konsiderohen si më të thjeshta deri te ato më të ndërlikuarat tekniko-teknologjike që po na i imponon koha. Nga grumbullimi i tillë i materialit mund të hartohet fjalori unik i tipit të veçantë i mjeteve teknike të huazuara në shqipe.

Së dyti, me një veprim të tillë do të jetë më e lehtë edhe përzgjedhja, harmonizimi dhe favorizimi i trajtës së caktuar shkrimore për t'u përfshirë në fjalorët normativë të karakterit të përgjithshëm përshkrues të shqipes, duke i kursyer fjalorët e tillë të këtij tipi nga emërtimet që i takojnë kryesisht ndonjë profili tjetër të ngushtë semantik.

Së treti, duke i pasur si pasqyrë përpara emërtimet e tilla do ta kemi më lehtë përzgjedhjen e sinonimit të caktuar për të njëjtin koncept, si p. sh kaçavidë a shrafçiger; sobë, shporet a stufë (kuzhine), veturë a limuzinë; kaminonetë, kamionçino a furgon etj. etj.

Së katërti, edhe lidhur me zgjidhjen e këtij problemi që sapo shtrohet këtu, lypset punë e organizuar institucionale e kuadrove profesionistë. Natyrisht për ndërmarrje të tillë lypset bashkëpunim i forcave të organizuara intelektuale institucionale të qendrave të caktuara shkencore shtetërore (Tiranë, Prishtinë, Tetovë(Shkup) etj). pa i lënë anash edhe bërthamat shkencore në ndërmarrjet e caktuara të njohura prodhuese ose të fakulteteve a institucioneve gjegjëse.

Së pesti, sigurisht nga lënda e tillë e grumbulluar do ta kemi më lehtë të bëjmë shqipërimin (kalkëzimin) ose zëvendësimin eventual të ndonjë emërtimi të tillë me mjete të shqipes, qoftë në mënyrë të pjesëshme, qoftë në mënyrë të plotë...

Së gjashti, ma thotë mendja se një ndërmarrje të tillë me rëndësi tejet të madhe shoqërore shkencore e pragmatike (praktike) është e mundshme të kryhet fare lehtë në kohën tonë, kur për fat na u hoqën barrierat politike e shtetërore dhe kjo duhet të bëhet pasi të trajtohet, diskutohet, harmonizohet dhe të zgjidhet ose sadokudo edhe të mbarështrahet materiali përkatës sipas profilimeve nga komisionet a ekipet të caktuara të punës në qendrat përkatëse dhe lënda e tillë më në fund duhet t'i besohet një Komisioni unik me autoritete shkencor të truallit shqipfolës që do t'i jepte edhe vulën e fundit.

Gjithsesi një ndërmarrje e tillë me interes të shumanshëm duhet të sponzorohet nga organet e organizmat që e kanë për detyrë, në mënyrë që mos të mbetet vetëm në rrafshin e inicimit ose vetëm si letër-këkesë.

Prishtinë, më 12.IV.1998

Të dhëna bio-bibliografike për autorin



I.

Nuhi (Muharrem) Veselaj u lind në fshatin **Reçan të Therandës** (ish-Suharekë) më 20.08.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948), Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.06.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 03. 09.1959 në Prizren. Shkollën e lartë, përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës – Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.09.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe, më 23. 11. 1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 03. 04. 1980 mori gradën: *magjistër i shkencave filologjike*, ndërsa *tezën e doktoratës e mbrojti* më 24.12.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qendër në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës. Është Anëtar Nderi i SHAK “Elena Gjika Dora d’ Istria, Therandë.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por për moszbulim provash nga ai, u dënua vetëm 2 vjet. Pasi doli nga

burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të ripunësohej në arsim që e kishte ideal veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës (8 herë): Mushtisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejçec (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Zllatar, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur për motive politike iu ndalua puna në arsim e organizata shoqërore-shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në Ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put* të Beogradit – dega në Prishtinë, prej nga kaloi në *Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës*, përkthyes. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai përkundër pengesave e përndjekjeve, me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, arriti të korrë suksese, qoftë në jetën arsimore e shoqërore-politike, qoftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, gjetën strehim e shërim ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij qe objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë eksodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shkojë drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllloboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dekada, pasi, përkundër tentimeve, atij i qe ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë, ky pasi e bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t'i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut, kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyra të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest buroteknik. Ndërkohë kreu me nder çdo angazhim që iu besua, por nuk u ekspozua në parti politike, më tepër u përqendrua në veprimtarinë krijuese.

II.

Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s'ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të

ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashti botoi këto vepra:

1) Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylberta (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;
3. Me buzët në gaz (vjersha për fëmijë), Iliriku, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), Iliriku, Prishtinë) 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), Iliriku, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), Iliriku, Prishtinë 1997;
7. Shfrime nëpër mjegullnajë (reflekse poetike e mendimore), Iliriku, Prishtinë 1997;
8. Mësime nëpër pësime (shfaqje teatrale), Iliriku, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), Rozafa, Prishtinë 1998;
10. Bulëza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), Rilindja, Prishtinë 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), Rilindja, Prishtinë 2000.

2) Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Rilindja 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O – në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002;
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006,
5. Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktrate) MASHT e RK-së, Prishtinë 2014,
6. Rreth identitetit të gjinisë asnjësore në shqipen e sotme, Era, Prishtinë 2015,
7. Shumësi dhe shquarsia e emrave në shqipen standarde, Era, Prishtinë 2015,
8. Drejt standardizimit të gjuhës shqipe, Era, Prishtinë 2015,
9. Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, Era, Prishtinë 2015,
10. Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II, Era, Prishtinë 2015.

Këto të pestat të gatitura për libërtim:

11. Çështje të shqipes standarde rreth 28 temave të diskutueshme, III, Era, Prishtinë,
12. Çështje të shqipes standarde rreth emërtimit të njerëzve sipas veprimtarisë IV, Era, Prishtinë,
13. Çështje të shqipes standarde rreth disa termave nga fusha e teknikës dhe e ekonomisë V, Era, Prishtinë,
14. Çështje të shqipes rreth vendbanimeve, VI, Era, Prishtinë,
15. Fjalor pune (poslovni rečnik) shqip –serbisht, me shtojcën serbokroatisht – shqip, për ndërmarrjet metal-përpunuese – me theks terminologjia tekniko-teknologjike, VII, Era Prishtinë,

Sidoqoftë, edhe pse në moshë të shtyrë (ec në 84-shin) pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha e gjuhësisë, qoftë nga ajo letrare-artistike, për libërtimin e të cilave qëndron në pritje mirëkuptimi nga institucionet dhe organizmat përkatës të qeverisë sonë, por edhe prej sponzorëve eventualë vullnetmirë.

Prishtinë, 2016